6.				<input type="checkbox"/>		<input checked="" type="checkbox"/>					<input checked="" type="checkbox"/>			<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>			<input type="checkbox"/>		
<b>Rishikimi, ndryshimi dhe vlerësimi i punës që është në zhvillim e sipër</b>																									
1.					<input type="checkbox"/>						<input type="checkbox"/>							<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	
2.					<input checked="" type="checkbox"/>						<input type="checkbox"/>			<input type="checkbox"/>				<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	
3.					<input type="checkbox"/>						<input type="checkbox"/>							<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	
4.					<input checked="" type="checkbox"/>						<input type="checkbox"/>							<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input type="checkbox"/>		<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	
<input checked="" type="checkbox"/>																			<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>			<input checked="" type="checkbox"/>	
<input type="checkbox"/>																			<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>			<input checked="" type="checkbox"/>	

## Vrojtimet e mësuesit për fëmijën

### 7. ARSIMI FIZIK

#### Koordinimi motorik

1. Mungesë e qëndrueshmërisë
2. Paaftësi për të mbështetur lëvizjet
3. Baraspeshim të dobët
4. Rrjedhshmëri të dobët gjatë lëvizjeve
5. Ndeshet me gjërat/ përplasjet dhe rrëzohet poshtë
6. I ngathët/ lëvizje të çuditshme kur ece apo vrapon
7. Rrëzohet duke qenë mbështetur në murr, ndonjë aparat apo fëmijë
8. Lëvizje me intervale të ndryshme, si p.sh. shumë forcë/pak forcë
9. Përplasje të shputës së këmbës me forcë gjatë ecjes
10. I ngadaltë gjatë përvetësimit të ndonjë aftësie në krahasim me shokët e tjerë
11. I ngadaltë për tu përgatitur për aktivitetet nga lënda e arsimit fizik
12. Vështirësi me kopsat, zinxhirët dhe lidhëset
13. Ngurrues për të marrë pjesë për shkak të vështirësive të parashikuara
14. Vështirësi me mbajtjen e lëvizjeve nën kontroll
15. Bën Lëvizje të njëpasnjëshme për t'i dhënë vetes stabilitet
16. Aftësi e dobët gjatë kërcimeve
17. Vështirësi me koordinimin e të dy pjesëve të trupit bashkë, si p.sh gjatë notimit
18. Vetëdije e reduktuar për hapësirën
19. Lëvizje konstante/ gjithmonë në nxitim e sipër

#### Vallëzim, gjimnastikë

1. I pavetëdijshëm për pozicionin e vetes në lidhje me tjerët
2. Ndryshim i dobët për ritmin dhe limitin e kohës
3. Vështirësi me ndryshimin e drejtimeve të shpejta
4. Mungesë e rrjedhshmërisë gjatë lëvizjeve
5. I ngathët, lëvizje të çuditshme dhe të ekzagjeruar
6. Përdor shpejtësinë në përpjeke për të tejkaluar kontrollin/balancimin e dobët
7. I paaftë për të kujtuar saktë sekuencën e lëvizjeve
8. I paaftë për ndryshim nga një skemë e lëvizjes tek tjetra
9. Vështirësi me kopjimin apo imitimin e stileve
10. Vështirësi me punë të sinkronizuara
11. Vështirësi me zbatimin e lëvizjeve të sakta dhe të kontrolluara
12. I shqetësuar për fillimet e aktiviteteve
13. Vështirësi me hedhjen dhe kërcimin lartë
14. Probleme me koordinim e këmbëve dhe krahëve bashkë
15. I frikësuar nga pajisjet jo të qëndrueshme/qëndrueshme, si p.sh litarët
16. Vështirësi me krijimin dhe zbatimin e stileve të veta të lëvizjeve
17. Vlerësim të dobët për lartësitë, thellësitë dhe distancën

**Shuma totale e pikave kryesore**

**Shuma totale e pikave dytësore**

Shtyllat bazë	Zhvillimi shqisor					Motorika madhore					Kontrolli i motorikës delikate			Të perceptuarit vizual					Gjuha			Organizimi	Aspektet sociale dhe emocionale		
	Zhvillimi vestibular	Ndeshmëria për prekje	Përpunimi proprioceptiv	Përpunimi dëgjimor	Përpunimi vizual (pamor)	Planifikimi motorik	Stabiliteti i pozitës trupore dhe baraspesha	Veçitëdije hapësinore dhe trupore	Integrimi i dyanshëm	Kalimi i vijës së mesit dhe lateralizimi	Integrimi vizual motorik	Shikimi dhe kontrolli i syve	Shkathësitë e duarve	Diskriminimi vizual	Lidhjet vizuale hapësinore	Pandryshueshmëria vizuale e formës	Figura nga mjedisi	Mbyllja vizuale	Memoria/ memoria vizuale	Vëmendja dhe të dëgjuarit	Gjuha që pranojmë-receptive			Gjuha që shprehim-ekspresive	Memoria dëgjimore
<b>Koordinimi motorik</b>																									
1.	◆	□	◆			□	◆	◆				□													□
2.	□	□	□			◆	◆	◆	◆			□													
3.	◆		◆			□	◆	◆	◆	□			□							□					
4.	◆	□	◆			◆	◆	□	□			□													
5.	◆	□	□		□	◆	◆	◆				□													
6.	◆	□	◆			□	◆	◆	□			□													
7.	◆	□	◆			◆	◆	◆												□					
8.	□	◆	◆			◆	◆	□																□	□
9.	◆	□	◆			◆	◆	◆																□	□
10.	□	□	□			◆	□	◆	◆			◆													
11.		□				◆	□	◆	◆			□								□					
12.		◆				□			◆			◆				□				□					
13.	◆		□	□	□	◆	◆					□													◆
14.	◆		□			□	◆	◆			□		◆	□											◆
15.	◆	□	◆				◆	◆																	
16.	◆	□	◆				◆	◆	□																
17.	□	□	◆			◆		◆	◆	□															◆
18.	□	□	◆					◆				◆			□										◆
19.	◆	◆	◆			□	◆													□					□
<b>Vallëzim, gjimnastikë</b>																									
1.	□	□	◆			□		◆				□			◆										◆
2.	◆	□	◆	◆	□	□			◆											□					
3.	◆		□			◆	◆			□										◆	□				
4.	◆	□	◆			◆	◆	□	□			□													
5.	◆	□	◆			□	◆	◆	□			□													
6.	◆	◆	◆				◆	□												□					□
7.				□	□	◆								□				◆		◆	□		◆		
8.	□	◆	□			◆		◆												□	□			◆	◆
9.		□	◆			◆		□				□								◆	◆				◆
10.		◆	□			◆		◆	◆										□	□					
11.	□	□	◆			◆	◆	◆	□	□															
12.	◆	□	◆				□	◆				◆			□									□	□
13.	□	□	□			◆	◆	◆	◆	□															
14.	□	◆	□			□	□	◆	◆	◆															
15.	◆	◆	◆				◆		□			□													□
16.	◆	□	□			◆	□	◆																	◆
17.	◆	□	□				□	◆				◆			□	◆									
◆																									
□																									



## Vrojtimet e mësuesit për fëmijën

### Lojërat/Atletikë

1. Aftësi të dobëta/sakta me topin
2. Nuk përcjell udhëtimin e topit
3. Paaftësi për të gjuajtur në shënjestër/ apo të hedh në shënjestër
4. Kapje dhe hedhje të pazhvilluara me topin
5. Dridhet kur topi i afrohet atij
6. Pret që topi ta godas përpara se të reagojë
7. Vështirësi me mbajtjen e pajisjeve
8. Paaftësi për të mbajtur pozitën e vet në ekip/ gjithmonë në vendin dhe kohën e gabuar
9. Ngurrues për të marrë pjesë në lojëra
10. I fundit për tu zgjedhur në ekip
11. Gjithmonë dëshiron të jetë kapiteni i ekipit
12. Përgjigje të ngadalta ndaj udhëzimeve në situata ekipore
13. Sjellje jo të përshtatshme në sportet ekipore
14. Vështirësi me gjetjen, mbajtjen dhe zhvendosjen e pozicionit të saktë në fushën gjelbërt sportive
15. Vetëdije të vogël për rëndësinë e roleve në ekip/ punës grupore
16. Dështim për të bashkëvepruar me të tjerët
17. I pavëmendshëm për të dëgjuar udhëzimet/ duhet që udhëzimet të përsëriten
18. Probleme me të kuptuarit e roleve/ taktikave/dhe strategjitë e lojërave në ekip

### Aktivitete që zhvillohen në ambient të jashtëm dhe që përfshin aventurë

1. Vështirësi me orientimin, leximin dhe interpretimin e hartave
2. Aftësi të ulët për zgjedhjen e problemeve
3. I frikësuar nga përvojat e reja
4. I ngadaltë dhe hezitues kur përpiqet të bëjë aktivitete të reja
5. I paaftë për të vlerësuar saktë lartësinë dhe thellësinë
6. I paaftë për të ndryshuar saktësisht peshën
7. I paqëndrueshëm mbi sipërfaqe të palëmuara, rrëzohet në objekte të palëvizshme

**Shuma totale e pikave kryesore**

**Shuma totale e pikave dytësore**

Shtyllat bazë	Zhvillimi shqisor					Motorika madhore					Kontrolli i motorikës delikate			Të perceptuarit vizual					Gjuha							
	Zhvillimi vestibular	Ndjeshmëria për prekje	Përpunimi proprioceptiv	Përpunimi dëgjimor	Përpunimi vizual (pamor)	Planifikimi motorik	Stabiliteti i pozitës trupore dhe baraspesha	Vetëdije hapësinore dhe trupore	Integrimi i dyanshëm	Kalimi i vijës së mesit dhe lateralizimi	Integrimi vizual motorik	Shikimi dhe kontrolli i syve	Shkathësitë e duarve	Diskriminimi vizual	Lidhjet vizuale hapësinore	Pandryshueshmëria vizuale e formës	Figura nga mjedisi	Mbyllja vizuale	Memoria/ memoria vizuale	Vëmendja dhe të dëgjuarit	Gjuha që pranojnë-receptive	Gjuha që shprehim-ekspresive	Memoria dëgjimore	Organizimi	Aspektet sociale dhe emocionale	
<b>Lojërat/Atletikë</b>																										
1.		◆	□				□	◆	□	◆	◆					□										
2.	□				◆		□	□		□	◆					◆										
3.			◆			□	□			□	◆			□		◆										
4.		□	◆			□		◆	◆	◆	□	□														
5.		◆	□			□		◆	□	□	◆		□	◆											◆	
6.	□	□				◆		◆	◆	□	◆														◆	
7.		◆	◆			□			◆	□		◆														
8.	□	□				□		◆							□	◆		◆							◆	
9.	□		□	□		◆	□							◆			□		◆						◆	
10.	◆			□	□	◆		◆			□						□								◆	
11.		□		□	□	◆																			◆	
12.	□			□	□	◆	□	◆											◆	◆					◆	
13.	□	□	□			◆													◆	◆					◆	
14.						◆		□			□					◆		□		◆	◆				□	
15.																				◆					◆	
16.																					□				◆	
17.	□	□	□	◆	□														◆	◆		◆			□	
18.				□	□	◆													◆	◆		◆			□	
<b>Aktivite të zhvillohen në ambient të jashtëm dhe që përfshin aventurë</b>																										
1.						□					□		◆	◆		◆	◆	□								
2.						◆													□	◆		□		□	□	
3.	◆	◆		□	□	◆														□					◆	
4.	◆	□				◆													□	◆	□	□			◆	
5.	◆		□				□	◆			◆			□	◆											
6.	◆	◆	◆			◆	□																			
7.	◆		◆				◆	◆			□			□	□	□										
◆																										
□																										







## Profili i personalizuar për nxënësin (SHEMBULL)

Vrojtimet e mësimdhënësit për nxënësin	1. Zhvillimi shqisor					2. Motorika madhore					3. Kontrolli i motorikës delikate					4. Të perceptuarit vizual					5. Gjuha					6. Organizimi					7. Aspektet sociale dhe emocionale				
	1.1.	1.2.	1.3.	1.4.	1.5.	2.1.	2.2.	2.3.	2.4.	2.5.	3.1.	3.2.	3.3.	4.1.	4.2.	4.3.	4.4.	4.5.	4.6.	5.1.	5.2.	5.3.	5.4.	6.	7.										
Zhvillimi vestibular	<input type="checkbox"/>																																		
Ndësia për prekje	<input type="checkbox"/>	<input checked="" type="checkbox"/>																																	
Përpunimi proprioceptiv			<input checked="" type="checkbox"/>																																
Përpunimi dëgjimor				<input checked="" type="checkbox"/>																															
Përpunimi vizual (panor)					<input checked="" type="checkbox"/>																														
Planifikimi motorik						<input checked="" type="checkbox"/>																													
Stabiliteti i pozitës trupore dhe baraspesha						<input checked="" type="checkbox"/>																													
Veddyje hapësimore dhe trupore							<input checked="" type="checkbox"/>																												
Ingenjri i dyanshëm								<input checked="" type="checkbox"/>																											
Kalimi i vijës së mesit dhe lateralizimi									<input checked="" type="checkbox"/>																										
Ingenjri vizual motorik										<input checked="" type="checkbox"/>																									
Shkrimi dhe kontrolli i syve											<input checked="" type="checkbox"/>																								
Shkathësitë e duarve												<input checked="" type="checkbox"/>																							
Diskriminimi vizual														<input checked="" type="checkbox"/>																					
Lidhjet vizuale hapësimore															<input checked="" type="checkbox"/>																				
Pandryshueshmëria vizuale e formës																<input checked="" type="checkbox"/>																			
Figura nga mjedisi																	<input checked="" type="checkbox"/>																		
Mbyllja vizuale																		<input checked="" type="checkbox"/>																	
Memoria/ memoria vizuale																			<input checked="" type="checkbox"/>																
Vendndja dhe të dëgjuarit																				<input checked="" type="checkbox"/>															
Gjuha që pranojmë-receptive																					<input checked="" type="checkbox"/>														
Gjuha që shprehim-ekspresive																						<input checked="" type="checkbox"/>													
Memoria dëgjimore																							<input checked="" type="checkbox"/>												
Pikat kryesore totale			3	1	2	5	3	4												2	3	1				3									
Pikat dytësore totale	<input type="checkbox"/>	3	4	1	1	1	2	2	3	2	2	2	2	1	1	1	1	1	1	2	1	1	1			3									

## **PJESA II**

# **AFTËSITË BAZË - NDËRTOJMË SHTYLLAT PËR TË MËSUAR**

### **Strategji praktike për përfshirjen e nevojave të veçanta në shkollat fillore**

#### **Hyrje në Aftësitë Bazë**

Aftësitë bazike janë shtyllat kryesore dhe zhvillimore për të mësuarit dhe thelbësore për ndërtimin e një baze të fortë për detyrat e përditshme. Ato u mundësojnë fëmijëve të përvetësojnë aftësi jetësore dhe të funksionojnë në mënyrë të suksesshme. Në thelb, fëmijët i mësojnë këto aftësi:

- Të kujdesen për veten
- Të punojnë në mënyrë efikase në shkollë
- Të luajnë


Ergoterapeutët kanë ekspertizë në vlerësimin e zhvillimit të aftësive dhe identifikimin e lidhjes në mes përvetësimit të aftësive bazike dhe performancave në shkollë. Ato përdorin shumëllojshmëri qasjesh dhe intervenime.

Mirëpo nuk do të thotë se mësueset nuk mundenden të aftësohen dhe të përdorin Qasje “lart poshtë” për të bërë analizë të detyrave, ndryshim dhe përshtatje, që t’i mundësoj fëmijës/nxënësit të arrijë detyra funksionale, që do ta lehtësojnë të mësuarit.

Gjatë viteve të tyre të hershme, fëmijët përjetojnë një varg aktiviteteve që promovojnë zhvillimin e shtyllave ndërtuese individuale. Aftësia bazë e të mësuarit (grafikoni AB 01), paraqet vargun e aftësive të nevojshme në procesin e të mësuarit që janë thelbësore për vendosjen e bazave të forta për detyrat e përditshme. Përderisa të gjitha aftësitë janë të lidhura njëra me tjetrën, vonimi gjatë përvetësimit të njëres aftësi, do të ketë efekt negativ dhe fëmijët, do të hasin vështirësi në aktivitetet nga jeta e përditshme, puna dhe loja.

Aftësitë bazike vazhdojnë të zhvillohen si një proces natyral gjatë të njëjtës kohë kur punohet me fazat bazë dhe programin për fazat kryesore 1 dhe 2. Vitet e shkollimit fillor japin shumë mundësi që këto aftësi bazike të zhvillohen dhe zgjerohen. Fëmijët i përdorin disa nga ato aftësi gjatë ditëve shkollore dhe shume përvoja (ngjarje) ndodhin që ua bëjnë të mundur përdorimin dhe zgjerimin e mëtejshëm të këtyre aftësive si p.sh.:

- Që të përdorin gërshërët në mënyrë të saktë për të prerë përgjatë vijës, fëmijëve ju duhet të zhvillojnë qëndrueshmëri të posturës (pozitës), shkathtësi të duarve, integrim vizual motorik, lidhje vizuale hapësinore, planifikim motorik dhe integrim të dyanshëm.
- Për të kapur topin nxënësi duhet të zhvillojë qëndrueshmëri të posturës (pozitës së trupit) dhe baraspeshës, vetëdije hapësinore dhe trupore, integrim të dyanshëm, kalim të vijës së mesit, integrimi vizual motorik, kontroll motorike vizuale.



Grafikoni AB 01

Gjatë kohës kur nxënësi largohet nga shkolla fillore është shumë e domosdoshme që të gjitha këto aftësi bazë të jenë plotësisht të përforcuara si parapërgatitje për periudhën e tranzicionit, d.m.th. kalimit nga shkolla fillore në shkollën e mesme. Aftësitë bazike janë:

- Zhvillimi shqisor;
- Koordinimi i motorikës së madhe;
- Kontrollimi motorikës delikate;
- Të perceptuarit vizual;
- Gjuha;
- Organizimi,
- Aspektet sociale dhe emocionale.

Aftësitë bazë janë të adaptuara me këto pyetje dhe për çdo pyetje vijon sqarimi saj:

- *Çfarë është?* – përcakton fushën specifike të aftësisë;
- *Pse është e rëndësishme aftësia?* – sqaron pse nxënësi duhet të përvetësojë aftësinë;
- *Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?* - sugjeron çka mund mësimitdhënësi të vërej kur aftësia i mungon nxënësit ose nuk është e zbatueshme nga ana e nxënësit;
- *Strategjitë e mësimitdhënies* – japin këshilla dhe ide mbi punën e mësimitdhënësit;
- *Aktivitetet që përmirësojnë aftësinë* - sugjerojnë aktivitete për punë individuale ose grupe të vogla punuese (Jenkinson, Hyde, & Ahmad, 2008);
- *Shtojcat* - përmbajnë listat përcjellëse, proforma, programe, resurse dhe sisteme që kanë për objektiv të gjitha ato fusha që fëmijët tregojnë mungesë të aftësive. Po ashtu, përmban edhe strategji zbatuese.



## 1. Hyrje në zhvillimin shqisor



### a. Çfarë është zhvillimi shqisor?

“Zhvillimi apo përpunimi shqisor përfshin regjistrimin dhe rregullimin e informatave shqisore si dhe organizimin e brendshëm të të dhënave shqisore, me qëllim që qenia njerëzore mund të zbatoj reagime varësisht nga situata dhe të marrë pjesë në punë nga jeta e përditshme në mënyrë të suksesshme” (Dunn, 1997). Sjelljet e mësuara janë me një qëllim të caktuar dhe i mundësojnë individit t’i tejkalojë sfidat dhe të mësoj aftësi të reja (Prodhomme, Mulligan, Merrill, & Wright, 2007), si p.sh.: kur prek diçka shumë të nxehtë ti e largon dorën; një foshnje sheh diçka që ia tërheq vëmendjen dhe shkon ta kap, kjo e shpien që foshnja të zvarritet dhe të bëjë lëvizje komplekse dhe tregohet e aftë.

### b. Pse është i rëndësishëm zhvillimi shqisor?

Zhvillimi shqisor konsiderohet të jetë proces i brendshëm i sistemit nervor, i cili na ndihmon të pranojmë, organizojmë dhe kuptojmë informata shqisore prej mjedisit të jashtëm (informata nga dëgjimi, informata pamore, si dhe të pranojmë informata për shije dhe erën e ushqimit, etj.). Po ashtu, të pranojmë informata dhe nga brendësia e trupit tonë (prekja, lëvizja dhe receptor të përbashkët). Kjo pastaj na mëson neve si tu përgjigjemi kërkesave nga mjedisi i jashtëm. Zhvillimi shqisor efikas është i nevojshëm që të na mundësojë të marrim pjesë në jetën e përditshme dhe në mënyrë adekuate të angazhohemi në rutinën e përditshme.

Çdo individ iu përgjigjet ndryshe informatave shqisore sepse sistemi nervor i tij ka “prag (portë)” për të reaguuar. Ne mund të reagojmë lehtë ndaj këtyre të dhënave shqisore nëse kemi “**prag të ulët**” dhe kjo ndryshe njihet si “*përgjigje e lartë*” ose neve na duhet një kohë më e gjatë që të reagojmë dhe kemi “**prag të lartë**” e cila njihet si “*përgjigje të ulët*”.

Fëmijët në kategorinë e parë mundohen t’i shmangin situatat, të Cilët i rrisin të hyrat shqisore. Kurse në kategorinë e dytë kërkojnë të kenë të hyra shqisore.

Modeli themelor i përgjigjeve të pragjeve të larta dhe të ulëta ndaj të hyrave, ose pranimeve shqisore është:

- *Kërkimi shqisor*, si p.sh. je në lëvizje që të prekësh gjithçka;
- *Mënjanimi shqisor*, si p.sh. mund tërhiqesh ose nguron të lëvizësh, ose ngjitesh diku dhe mundohesh të shmangësh prekjet e gjërave, ose të bëhesh i pa pastër;
- *Ndjeshmëria shqisore*, si p.sh. shumë i ndjeshëm ndaj tingujve dhe/ose prekjës dhe shumë shpejt i inatosur (Dunn, 1999).

Është e mundshme të kesh një prag të ulët për një të hyrë shqisore dhe një prag të lartë ndaj një të hyre tjetër shqisore. Si p.sh. mund të të hutoj zhurma e madhe, por mund të mos të të hutojë rrëmuja e shumë ngjyrave vizuale. Nivelet e pragjeve dhe aftësia jonë që të pranojmë informata të ndryshme shqisore varen nga shumë faktorë, nga dita në ditë, si dhe përgjatë një dite të vetme.

Ne, mund të jemi vozitës të aftë dhe të vozisim në vende të njohura për ne me radion e kyçur dhe me fëmijë që bisedojnë në veturë, por nëse jemi në një zonë të panjohur për ne dhe fillon të bjerë shumë shi, ne mund të kërkojmë nga fëmijët të ndalin bisedat dhe ta shuajmë radion me qëllim që të na mundësojë neve ta përpunojmë atë informatë shqisore dhe të përqendrohemi që ta realizojmë detyrën tonë.

Vetë rregullimi dhe organizimi është mënyra se si ne e menaxhojmë atë të hyrë shqisore deri te ne, nëpërmjet të aftësisë së arritjes, mbajtjes, dhe ndryshimit të nivele apo vigjilencës në mënyrë të duhur që t'i harmonizojmë kërkesat nga jashtë. Problemet ndodhin kur ka “vështirësi për tu përgjigjur informatave shqisore me sjellje që mund të klasifikohet në varësi të shkallës, natyrës apo intensitetit të informatës shqisore. Përgjigjet mund të jenë në papajtueshmëri me kërkesat e situatës dhe jo fleksibile që t'i përshtaten sfidave shqisore që mund t'i hasim në rutinën e përditshme” (Miller, Anzalone, Lane, Cermak, & Osten, 2007).

Të gjithë ne kemi preferenca shqisore në jetën e përditshme; disa nga ne mund të zgjedhim të vishemi me ngjyra të zjarra dhe të vendosim stoli të mëdha, t'i dekorojmë shtëpitë tona me ngjyra të forta dhe të kemi shumë rrëmujë, kurse disa të tjerë preferojnë ngjyra të buta, të zbehta dhe mos të ketë rrëmujë me qëllim që të ndjehen të qetë. Disa njerëz mund të kënaqen në gjithë ato vegla rrotulluese nëpër parqet e argëtimit, ose sporte të rrezikshme dhe të tjerë mund të preferojnë aktivitete të qeta që realizohen ulur, vetëm në ato raste kur një përgjigje ekstreme mund të ndërhyjë në jetën e përditshme që mund të shkaktoj shqetësim.

### **c. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Parham dhe Mailloux (Parham, 2005), kanë raportuar se problemet me zhvillimin shqisor shpesh lidhen me aftësi të ulëta sociale, aftësi të papjekura për të lozur, vlerësimin e dobët për veten, aftësive të ulëta të motorikës së madhe dhe motorikës delikate (fine-imët), si dhe vështirësi gjatë realizimit të aktiviteteve të përditshme. Mund të ketë edhe shumë arsye tjera që fëmijët të shfaqin këto karakteristika, por nëse vështirësitë e zhvillimit shqisor janë arsyeja, atëherë është e mundur se kërkimi shqisor, mënjanimi shqisor ose ndjeshmëria shqisore mund të shkaktojnë ato sjellje të lartë përmendura.

Në klasë fëmijët/nxënësit me vështirësi në zhvillimin shqisor mund të përballen me:

- Sfida gjatë realizimit të aftësive nga jeta e përditshme:

- vështirësi për veshjen e disa veshmbathjeve të caktuara,
- ngrënës të pa pastër ose me një dietë ushqimi të rreptë,
- vështirësi në organizimin e vetes.
- Aftësi sociale të dobëta:
  - pushtojnë hapësirën personale të tjetrit,
  - duken sikur gjatë dëgjimit nuk u kushtojnë vëmendje të tjerëve,
  - ndërhyjnë pa nevojë në biseda.
- Aftësi loje të pazhvilluara:
  - nuk ju shmangen lojërave të pista,
  - kalim prej një detyre në detyrën tjetër,
  - kanë një zgjidhje të dobët të aktiviteteve.
- Vlerësim apo konceptim të ulët për veten:
  - vetëvlerësim të dobët për vetën,
  - ngurrim për të marrë pjesë në aktivitet në klasë,
  - pritshmëri jo të sakta për vetën dhe detyrën.
- Aftësi të dobëta të motorikës madhore dhe motorikës delikate (fine):
  - shkathtësi të dobëta me lapsin, mbajtje e dobët e lapsit,
  - shpesh përplasje me të tjerët, ose përplasje në mobilet (orenditë-bankat shkollore),
  - gjithmonë në nxitim.

**Zhvillimi shqisor është ndarë në disa pjesë tjera:**

- Zhvillimi vestibular (ndjeshmëria/ndjenja e lëvizjes dhe baraspeshës);
- Ndjeshmëria e prekjës dhe zhvillimi i saj;
- Përpunimi proprioceptiv (zhvillimi/ndjeshmëria e pozicionit trupor);
- Zhvillimi dëgjimor;
- Përpunimi vizual (pamor).

## **1.1. Zhvillimi vestibular (Ndjeshmëria e lëvizjes dhe baraspeshës)**

### **1.1.1. Çfarë është zhvillimi vestibular?**

Ndjeshmëria vestibulare është ndjenja jonë e lëvizjes. Sistemi jonë lëvizës na mundëson neve të qëndrojmë drejtë në këmbë, ta përshtatim pozitën tonë, të kemi një ekuilibër dhe të detektojmë lëvizjen. Përmes lëvizjes ne zbulojmë gjithashtu ndjenjën e orientimit dhe vlerësimin për marrëdhënien tonë me hapësirën. Ndjenja e lëvizjes ndikon në tonin tonë të muskujve kur jemi duke bërë diçka, e cila pastaj mban drejtpeshimin tonë. Ne e përshtatim trupin tonë varësisht fuqisë dhe forcës së lëvizjes. Ky sistem vestibular lidhet me sistemin tonë vizual në atë mënyrë që ne koordinojmë lëvizjen tonë varësisht nga ajo që shohim (Bhreachnach, 1995). Sistemi vestibular aktivizohet nga sistemi i stimulit, që gjatë lëvizjes të përshtatet edhe baraspesha.

### **1.1.2. Pse është i rëndësishëm zhvillimi vestibular?**

Ky sistem është i rëndësishëm për faktin se duhet një posturë trupore dhe një baraspeshë efikase gjatë realizimit të ndonjë aktiviteti. Në rast se duam të arrijmë dhe të mbajmë një gjendje trupore të qete, vigjilente dhe të mirë organizuar, stimulimi i këtij sistemi është i patjetërsueshëm. “Ne i ndiejmë efektet e qeta të stimulimit vestibular të ngadaltë kur jemi të ulur në një karrige dhe po ashtu i ndiejmë efektet më të gjalla të stimulimit vestibular të shpejtë kur rrotullohemi në ato pajisje të shpejta në parqe argëtuese. Ky sistem na ndihmon t’i mbajmë të ekuilibruar edhe nivelet e sistemit tonë nervor” (Ayres J. , 1979).

### **1.1.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

#### **Mënjanimet të ndjeshmërisë**

Fëmijët të cilët janë shumë të ndjeshëm nga të hyrat (informacionet) e këtij sistemi kanë prirje t’i shmangen lëvizjes, ato mund të:

- kanë qëndrim truporë të ngurtë dhe hutohen nga lëvizje të shpejta;
- i shmangin lodrat, siç janë: luhatëset, rrëshqitëset dhe lëkundëset statike me kuaj;
- ju frikësohen lartësive dhe të gjitha atyre aktiviteteve që realizohen në lartësi, edhe atë: ngjitja në mur, ecje nëpër tra ekuilibri, buzë trotuareve dhe mjeteve tjera nga lënda e arsimit fizik;
- nuk i duan shkallët dhe shkallët lëvizëse - mbahen në parrmakë më shumë se sa fëmijët e moshës së njëjtë;
- çorientohen kur përkulen;
- sëmuren shpejtë nga lëvizjet me makinë;
- shmangin lojërat e rënda dhe me rënie;
- nuk parapëlqejnë të rrinë kokëposhtë (përmbysur) si p.sh. të qëndruarit me duar dhe këmbët lartë, ose të qëndruarit me duar dhe këmbët lartë dhe të hapura.

## **Kërkime të ndjeshmërisë**

Fëmijët që e kanë sistemin vestibular më pak të ndjeshëm, kanë një prirje të kërkojnë hyrje vestibulare dhe mundet të:

- mos kenë ndjenjën e kufirit ose kontrollit kur janë në situata potencialisht të rrezikshme, mos tregojnë frikë;
- kërkojnë me çdo kusht lëvizje dhe hapësira për lojë dhe të rrotullohen në gjithë ato pajisje rrotulluese. Janë kërkues të emocioneve dhe nuk ndiejnë marramendje ose të jenë të sëmurë kur fëmijët tjerë mundë të ndjehen;
- kërkojnë lëvizje të vazhdueshme si p.sh. rrotullime, vrapime, të rrinë të balancuar në dy këmbët e karriges dhe janë gjithmonë në lëvizje;
- lëvizje të papritura- shpesh e hedhin veten mbi pajisje, qilim ose dysheme;
- kënaqen të ngjiten lartë dhe nuk i mendojnë pasojat.

### **1.1.4. Strategji arsimore**

#### **➤ Strategji arsimore për rastet kur kemi mënjanim të ndjeshmërisë**

- përgatite fëmijën paraprakisht për ndryshimet në pozicion, ndaje detyrën në hapa të arritshëm;
- rrite aktivitetin ngadalë me qëllim që të rritet edhe toleranca e nxënësit për të lëvizur edhe ai gradualisht;
- lejoje fëmijën të udhëheq me aktivitetin, me ritmin e tij, me qëllim parandalimi reagimeve jo të favorshme.

#### **➤ Strategji arsimore për rastet kur kemi kërkime të ndjeshmërisë**

- ndërfit aktivitete lëvizëse në rutinën e përditshme të nxënësit, si p.sh. kërcime, vrapime, dhe lojën e futbollit;
- jepi nxënësit pushime të rregullta nga lëvizjet përgjatë ditës;
- jepi mundësi nxënësit të ndërrojë më shpesh pozicionin (ulje në dysheme, mbi karrige, të qëndroj në këmbë, të rrijë i shtrirë në dysheme, rrije në gjunjë, etj.) nëse i ndihmon atij/asaj;
- ule fëmijën në ato karrige që lëkunden, jepi një top terapeutikë, etj.

### **1.1.5. Aktivitete që ndihmojnë të zhvilluarit vestibular**

Është me rëndësi që nxënësi në gjithë ato aktivitete vestibulare (lëvizëse), që i realizon, të jetë nën kontroll dhe të ndalojë kur kërkon nga ai/ajo, sepse disa fëmijë janë tepër të ndjeshëm ndaj lëvizjeve dhe mund të kenë marramendje, zbehen ose të sëmuren shumë shpejt. Duhet të merren masa parandalimi me qëllim të ulen të gjithë ato rastet kur nxënësi mund të vendos veten në rrezik. Pas mbarimit të çdo aktiviteti fëmijët shpesh kërkojnë presion të thellë të të hyrës shqisore qetësojnë dhe rimarrin veten.

Aktivitetet e mëposhtme janë të klasifikuara, kështu që të gjitha ato detyra më sfiduese që kërkojnë më shumë lëvizje janë të paraqitura për në fund:

- *Zvarritje*- në pozitë zvarritje (në duar dhe gjunjë) kërko nga nxënësi që të jetë një kalë që qëndron shtirë në barkun e tij dhe kërko zvarritje përgjatë qilimit;
- *Tundje*-shtrije fëmijën mbi një top të madh ose mbi ndonjë fuçi me duar poshtë në dysheme dhe tunde para mbrapa prej duarve deri te gjunjët. Përdor edhe karrige lëkundës ose jastëk lëkundës, siç janë ato për tu ulur;
- *Kërcime*- topa lëkundës, dhe shumë pajisje tjera për të kërcyer;
- *Rrëshqitje*- rrëshqitje në fusha të ndryshme të lojës;
- *Rrokullisje*- nxënësi rrotullon lapsin përgjatë dyshemesë me krahë mbi kokë duke mbajtur në një vijë të drejtë. Mbyllja sytë që të bëj detyrën më të lehtë. Rrite nivelin e vështirësisë duke kërkuar që të mbajë jastëk të madh në duar ose në mes të gjunjëve;
- *Rrotullim*- inkurajoje fëmijën që të bëhet një helikopter. Provo rrotullimin në mënyra të ndryshme, si p.sh. rrotullimi me dy këmbë, në një këmbë, në shpine ose me pajisje tjera rrotulluese që mund të blihen;
- *Lëkundje*-lëkundje në fusha të lojës dhe në shumë pajisje tjera argëtuese për lëkundje në parqe, litarë, goma etj.

## **1.2. Shqisa (ndjenja) e prekjes dhe zhvillimi i saj**

### **1.2.1. Çfarë është ndjenja e prekjes?**

Lëkura ka shumë receptorë të ndryshëm për pranimin e ndjeshmërive të prekjes, presionit, teksturës, nxehtësisë, ftohjes, dhimbjes dhe lëvizjes së qimeve në lëkurë. Edhe pse mund të mos mendojmë shumë për rëndësinë e prekjes në jetën tonë, mirëpo sistemi i prekjes është sistemi më i gjatë shqisor dhe luan një rolë vital në sjelljet njerëzore qofshin fizike apo mendore (Ayres J. , 1979).

### **1.2.2. Pse është e rëndësishme ndjenja e prekjes?**

Ndjenja e prekjes është e rëndësishme se pikërisht përmes këtij sistemi ne pranojmë informacione nga bota. Përderisa gjuha, aftësitë motorike dhe proceset njohëse (kognitive) të zhvillohen, ne varemi shumë nga ndjenja jonë e prekjes. Të pranuarit dhe të prodhuarit e këtij informacioni në mënyrë më efikase na bën të ndjehemi më të sigurt, më të qetë dhe të zhvillohemi në aspektin social dhe emocional. Të prekurit mund të jetë edhe mbrojtës dhe të na mundësojë të bëjmë diferencim dhe t'i japim ndihmë trupit tonë të jetë shumë vigjilent ndaj

rreziqeve të mundshme. Gjithashtu i mundëson atij të dallojë, ku dhe çfarë është prekur (Kranowitz, 1998).

### **1.2.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

#### **➤ Mënjanimi i ndjeshmërisë**

Fëmijët që ndaj prekjes janë të ndjeshëm më shumë se që duhet kanë një sistem (funksionim) mbrojtës aktiv më shumë seç duhet dhe kjo mund të shihet si një prirje (aftësi) të shmangin ndjenjën e prekjes (dhe kështu njihen si mbrojtës ndaj prekjes). Me qëllim që të rrinë të qetë ato mund të:

- Mos të pëlqejnë aktivitete/loja që janë të papastra, si p.sh.: të ngjysin, ngjyrosin, shkruajnë me shkumës, rërë ose të kenë ushqime në duar dhe fytyrë;
- Zmbrapsen (tërhiqen) ose janë të frikësuar/shqetësuar nga prekjet e papritura, prekje të lehta ose të forta;
- Bëhen të shqetësuar kur qëndrojnë afër shokëve në resht dhe/ose i shtynë të tjerët larg ose e izolojnë vetveten;
- Reagojnë më tepër seç duhet ndaj teksturës, prekjes ose dhimbjes, si p.sh.: për një prerje të vogël të gishtit, ai/ajo mund ta godet tjetrin ose ta kafshoj;
- Tregojnë pëlqim ose mospëlqim të dallueshëm ndaj cilësisë së aktivitetit, objekteve, dhe kështu zhvillojnë një repertor të kufizuar;
- Kanë regjim të ashpër ushqimi ose kanë varg të kufizuar të ushqimeve të pranueshme si p.sh.: ushqimi bardhë, bukë me feta, jogurt etj.;
- Hulumtojnë objektet me majat e gishtave dhe rrallë herë me të gjithë dorën - mund të reagojnë si mbrojtës kur prekin gjithçka;
- Nuk pëlqejnë erën, shiun ose dushin dhe pastrimin e dhëmbëve;
- Nuk pëlqejnë veshje të ngushta/kufizuese ose tekstura të caktuara të veshmbathjes, mund të zgjedhin veshje me mëngë të gjata ose pantallona në verë dhe veshje të shkurtëra ose të holla në dimër (Fisher, Murray, & Bundi, 1991).

#### **➤ Kërkimi i ndjeshmërisë (ndjenjës)**

Fëmijët që nuk tregojnë shumë ndjeshmëri ndaj prekjes janë më pak të vëmendshëm kur preken dhe prandaj kanë reagime të zvogëluara mbrojtëse. Ato edhe mund të kërkojnë ndjeshmëri nga prekja me qëllim të bëjnë një diskriminimin (dallim) dhe kështu të mësojnë (Fisher, Murray, & Bundi, 1991).

### Fëmijët reagojnë në këtë mënyrë:

- kërkojnë aktivitete/loja të papastra (çrregullta,) janë të pavëmendshëm ndaj ushqimit ose ngjyrës në duar dhe në fytyrë, këto fëmijë e kanë të vështirë të rrinë të pastër dhe të rregulluar;
- kanë pamje të çrregullt, të rrëmuishme - nuk e dallojnë nëse veshja është e ngrysur ose e veshur mbrapsht;
- tregojnë preferenca për veshmbathje të ngushta dhe veshje që janë shumë të vogla;
- kanë një vetëdije të kufizuar për hapësirën e tyre personale dhe të tjerëve- janë të prirë; të pushtojnë hapësirën personale dhe të tjerëve, prekin sende dhe njerëz, kërkojnë kontakt fizik, ulen shumë afër fëmijëve tjerë gjatë kohës kur kanë aktivitete ku duhet të qëndrojnë poshtë në qilim, ose lozin me flokët e fëmijëve tjerë, ose veshjet;
- kanë mungesë të vetëdijes për dëmtimet (plagosjet) - mund të mos vërejnë prerje ose mavijosje;
- janë të pavëmendshëm ndaj prekjes së tjerëve ose objekteve, vetëm nëse janë intensive. Shpesh lëndojnë fëmijët tjerë kur lozin, si p.sh. mund të qëndrojnë mbi këmbën e ndonjërit pa e vërejtur fare;
- kanë mungesë të shkathtësive, janë të ngathët me bërjen e aktiviteteve;
- preferojnë aroma të forta dhe tekstura të ushqimeve, si p.sh. pikante, të ëmbla, kripura, dhe të tharta;
- vendosin sende në gojë. Mund të mbajnë në gojë sende ose të përtypin mëngë, lapsa, ose ta kafshojnë veten (Fisher, Murray, & Bundi, 1991).

### **1.2.4. Strategji arsimore**

- Shmangu prekjeve të lehta, përdor presion të fortë kur prek fëmijën dhe afrohu prej përpara;
- Rregulloje mjedisin e nxënësit që t'i përshtatet nevojës së tij, si p.sh.: kufizo ose rrite masën e gjërave në hapësirën e punës;
- Vendose fëmijën në fund të vijës;
- Pozicionoje fëmijën në klasë larg rrugëkalimit kryesorë që ai të mos rrezohet ose preket aksidentalisht;
- Lejo kafshim të objektit, siç është fundi i lapsit;
- merr në konsideratë teksturën apo cilësinë e sipërfaqes punuese, pajisjeve/ lodrave, si p.sh.: letra, pajisje matematikore nëse këto janë ato që shkaktojnë ankth për fëmijën. Vendos shirit rreth shkumësit;
- Diskuto rreth veshmbathjeve të fëmijëve me prindërit. Largim i etiketave mund të ndihmojë (Bisell, Fisher, Owens, & Polcyn, 1998).

### **1.2.5. Aktivitete që ndihmojnë me diferencimin apo dallimin e asaj që prekin**

Është e rëndësishme të dihet që për ato fëmijë që shmangin ndjeshmërinë e prekjes (janë mbrojtës ndaj prekjes), disa tekstura dhe prekje mund të jenë shqetësuese. Prandaj është



shumë e rëndësishme të fillojmë me aktivitete me më shumë ndjeshmëri dhe me tekstura më pak sfiduese dhe kështu tu japish mundësi që nxënësi ta kontrollojë nivelin e kontaktit dhe të ndalojë kur ai/ajo donë. Ndërsa për ato fëmijë që janë më pak të vëmendshëm ndaj prekjes, d.m.th. nuk i shmangen asaj, por përkundrazi janë kërkues të prekjes, atëherë është e nevojshme të zhvillojnë aftësi dalluese apo diferenciale (Bisell, Fisher, Owens, & Polcyn, 1998).

- *Loja me ujë*- loja në ujë me temperatura të ndryshme dhe me ose pa flluska. Përdor një varg të ndryshëm lodrash, enë, guaska, enë kuzhine për derdhje dhe matje.
- *Loja me brumë* – bërja e brumit, rrotullimi dhe modelimi- tekstura mund të jetë e mbushur me thjerrëza ose rërë, etj.
- *Vizatimi*- me substanca të ndryshme, si p.sh. me rërë, ngjyrë, oriz, xhelatine të prerë, miell misri, ujë si dhe shkumë për rruajtje.
- *Inkurajo fëmijën të përdor tekstura (materiale) të ndryshme mbi lëkurën e tij*, si p.sh. brusha për ngjyrosjeje, furça më të ashpra, furçe e telit për fërkimin e enëve, veshje të buta, gëzof, sapun të lëngshëm.
- *Vishu* me rroba të ndryshme, si p.sh. mëndafsh, gëzof, kapela, mjekra jo të vërteta, hallka dore dhe kërko nga ai që të identifikojë ato.
- *Luajë me objekte* të teksturave të ndryshme dhe pyet fëmijën të identifikoj karakteristikë të ndryshme, si p.sh. e fortë/butë, ngrohët/ftohët/ e ashpër/e lëmuar.
- *Kuti mbushëse* - fshih objekte në oriz/rërë/ makarona/ pjesë plastike dhe kërko nga nxënësi që ta gjejë atë.
- *Çantë mbushëse* – vendo disa objekte në çantë dhe kërko nga nxënësi që të ndjej atë që prek dhe ta tregoj para se ta nxjerr. Kërko nga nxënësi që ta gjejë një send specifik, nëse ka dy të ngjashme që mund ta shoh dhe t'i krahasojë.
- *Vizato*- letra, forma në dorë ose shpinën e nxënësit dhe pyet atë që ta identifikojë (Bisell, Fisher, Owens, & Polcyn, 1998).

### **1.3. Përpunimi proprioceptiv (shqisa për ndjeshmërinë e pozicionit trupor)**

#### **1.3.1. Çfarë është përpunimi proprioceptiv?**

Është ndjeshmëria jonë e lindur për “pozicion”. Ne pranojmë informacion prej muskujve tona dhe nyjeve përmes kontraktionit/aktivizimit muskullor, i cili na ndihmon të dimë si lëviz trupi jonë dhe çka mund të bëj trupi jonë kur neve na nevojitet. Kjo ndjeshmëri na mundëson të dimë pozicionin e trupit tonë, pa mos shikuar. Nëse i mbyllim sytë ne e dimë se shputat tona janë në dysheme, ose jemi të gatshëm të lëvizim krahun prapa nesh. Na mundëson të dimë saktë pozicion tonë trupor në hapësirë dhe po ashtu ta klasifikojmë shpejtësinë dhe forcën e lëvizjes sonë (Jenkinson, Hyde, & Ahmad, 2008). Ky sistem është përkrahur edhe si

sistemi jonë i brendshëm pamor. Ky sistem është i lidhur ngushtë me shqisat tjera, sidomos ajo e prekjës, lëvizjes dhe është shumë i domosdoshëm për baraspeshën, qëndrimin trupor, planifikimin tonë motorik dhe koordinimin (Bhreathnach, 1995).

### **1.3.2. Pse është i rëndësishëm përpunimi propioceptiv?**

Ndjenja e pozicionit na ndihmon të lëvizim. Me zhvillim të dobët të këtij sistemi, lëvizjet e trupit tonë do të jenë më të ngadalta, do të jemi të ngathët dhe do të na duhet më shumë përpjekje. Nëse lëvizja që vjen nga duart tuaja nuk të tregon se çfarë bëjnë ato, atëherë do të jetë shumë e vështirë si p.sh. të mbyllësh kopsat e teshave, nxjerrësh diçka nga xhepi, hapësh kapakun e një kavanozi, ose nga cila anë ta hapësh rubinetin e ujit. Nga ana tjetër, pa trungun e trupit dhe këmbët do ta kesh shumë të vështirë të dalësh nga vetura, të ecësh poshtë shkallëve, ose bësh ndonjë aktivitet sportiv, pavarësisht informatës vizuale që shohësh. Fëmijët me organizim të dobët propioceptiv si zakonisht kanë shumë vështirësi të bëjnë diçka (Ayres J. , 1979).

### **1.3.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Fëmijët me zhvillim të dobët propioceptiv mund:

- të jenë gjithmonë në lëvizje, nuk i zë vendi vend, lëkundin karrigen, apo rrinë të ekuilibruar në dy këmbët e karriges;
- kanë tonifikim të dobët muskolor dhe po ashtu posturë trupore, rrëzohen shumë lehtë dhe lodhen lehtë;
- irritohen shpejtë;
- përplasnin shputat e këmbëve kur ecin, kërcëllojnë dhëmbët dhe flasin me zë të lartë;
- reagojnë më shumë sesa duhet, si p.sh. japin përgjigje emocionale;
- kërkojnë kontakt fizik/përqafime;
- e shtypin fort, ose e shtypin lehtë lapsin kur shkruajnë;
- rrëzojnë gjëra apo hedhin shumë gjatë derdhjes së diçkaje;
- përdor ose shumë forcë gjatë aktiviteteve, zakonisht thyjnë gjëra dhe mund të lëndojnë të tjerët pa qëllim kur lozin;
- ndeshen me të tjerët/orendi/ korniza të dyerve etj. Shpesh herë edhe pengohen gjatë ecjes (Newton Inamura, 1998).

### **1.3.4. Strategjitë e mësimdhënies**

*Punë të rënda muskulore ose aktivitete kundër rezistencës janë çelësi i sigurimit të qetsimit dhe organizimi të koordinuar përmes këtij stimuli propioceptiv.*

- Jep aktivitete kundër bërjes rezistencë, ose përfshi më tepër se zakonisht presion, i cili do t'u mundësojë fëmijëve të vetëdijesohen për pozicionin e trupit të tyre, si p.sh.

përplasje dhe rrotullim me brumë për gatim dhe të qëndruarit në këmbë. Inkurajo fëmijët të ecin në këmbë deri në shkollë me çantë të varur në shpinë;

- Jepu gjithashtu edhe shumë mundësi tjera fëmijëve në shkollë të ecin me çantë shpine ose tabakë gjatë orëve mësimore deri te zyrat e shkollës kur shihni se ato duken të shqetësuar;
- Krijë pushime që kërkojnë lëvizje për fëmijët brenda ditës;
- Uli në karrige që rrotullohen që të rrisin vetëdijen e tyre shqisore dhe përqëndrimin;
- Mësoju fëmijëve strategji vizuale dhe kognitive që ato të planifikojnë dhe realizojnë lëvizje (Tuper & Miesner, 1995).

### **1.3.5. Aktivitete që do të ndihmojnë në lëvizjen trupore**

- *Të veshurit* e teshave të rënda, sidomos kapela, këpucë;
- *Vizatime/ngjyrose* në rrafsh të ndryshme (horizontale, vertikale) dhe në sipërfaqe të teksturave të ndryshme siç janë: kartonët e rrudhëta, letër me rërë, letër me sheqer dhe në lëvore druri;
- *Lojëra që kërkojnë pak rezistencë (qëndrueshmëri)*. Sidomos ato lojëra kur duhet të prishin dhe ndreqin lodrat (lodra me tulla, etj.);
- *Aktivitete nga lënda e arsimit fizik*- ngritje-ulje në karrige, kërcim në ajër, ngritje të këmbëve lart në mur etj;
- *Çdo aktivitet që kërkon shtytje/tërheqje*, si p.sh. tërheqje e litarit;
- *Trampolinat*- pajisje për kërcim lart në ajër;
- *Ecje si të kafshëve*- kërko nga ato që të ecin si ndonjë kafshë, si p.sh. elefanti, gjarpri, lepuri, kanguri, bretkosa, krokodili etj;
- *Rrotullim/mbështillje me forcë të sandviçit* – shëndërroje fëmijën si një ‘hot dog’ ose sandviç duke e rrotulluar nëpër qilim ose qebe dhe pastaj apliko pak presion në disa pjesë të ndryshme të trupit të tij;
- *Kërko nga nxënësi që të ndihmojë në mbajtje*- të çantave (qeseve) për pazar, çantave shkollore, të lëviz karrige, qilima, dhe pajisje të gjimnastikës;
- *Kur ulemi*, kërko nga nxënësi që t’i vendos duart anash karriges me shuplaka të shtira dhe ngre ashtu lartë trupin e tij/saj nga karrigja (Williams & Shellenberger, 1996).

## **1.4. Përpunimi dëgjimor**

### **1.4.1. Çfarë është përpunimi dëgjimor?**

Përpunimi dëgjimor është aftësia të perceptosh dhe kuptosh çfarë është dëgjuar në mjedisin që na rrethon. Kjo përfshin më shumë sesa vet aftësia e dëgjimit. Të kuptosh informata dëgjimore është një proces më i ndërlikur. Kjo d.m.th. të dallosh, shoqërosh apo lidhësh dhe interpretosh tinguj; të mbash mend dhe kuptosh çfarë ke dëgjuar. Gjithashtu të lidhësh fjalët në

një mënyrë të kuptueshme (Bissell, 1988). Është me rëndësi të jesh i aftë të ndalojshë tingujt në sfond (prapavijë) që të kuptosh më mirë tingullin apo zërin specifik që kërkon vëmendje.

#### **1.4.2. Pse është i rëndësishëm përpunimi dëgjimor?**

Përpunimi i mirë dëgjimor është një bazë e rëndësishme për zhvillimin e aftësive gjuhësore dhe luan një rol të rëndësishëm në klasën e nxënësve për të formuar marrëdhënie të mira me bashkëmoshatarët. Nxënësit, që përjetojnë vështirësi në përpunimin e asaj që dëgjojnë, ndonjëherë mund të duken të hutuar ose të pavëmendshëm. Ata mund të nxitojnë rastësisht në detyra duke menduar se e dinë atë, por pastaj mund t'ju duhet shumë kohë për t'ju përgjigjur udhëzimeve dhe për të përfunduar detyrat. Ato mund të reagojnë më shumë se të tjerët ndaj zhurmës garuese në klasë dhe mjedise tjera (Bissell, 1988). Fëmijët mund të hasin në vështirësi të ndjekin disa udhëzime, ose do t'ju duhet përpjekje shtesë. Ato si zakonisht janë nxënës të mirë vizual.

#### **1.4.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

##### **➤ Shmangia e ndjeshmërisë**

Fëmijët që janë tepër të ndjeshëm ndaj zërit kanë prirje të shmangin hyrjen dëgjimore dhe mund të kenë vështirësi me të cilët përballen:

- mos i pëlqejnë zhurmat e papritura siç janë: të zjarrfikëseve, krismave të zhurmshme dhe mund të reagojnë me shqetësim/ankth apo frikë;
- shmangin zhurmat e forta ose tingujt e caktuar, pasi ato mund të ndjehen të dhimbshme për to;
- kërkonin nga fëmijët tjerë dhe të rriturit të rrinë të qetë kur ato flasin;
- nuk pëlqejnë zhurmat që vinë nga sfondi, mjedisi, siç janë: zhurma që vjen nga dërrasa interaktive, projektori, apo bisedimet nga fëmijët tjerë, zhurma që krijohet nga pajisjet ngrohëse, karrige që gërvishtën në dysheme ose ora që troket;
- e kanë të vështirë të përqendrohen në punë kur ka shumë zhurmë;
- nuk pëlqejnë vendet ku ka zhurmë, siç janë: pishinat apo sallat e ngrënies;
- e humbin vëmendjen shpejt dhe kanë përqendrim të dobët;
- i mbyllin veshët apo bërtasin ndaj zhurmave të caktuara.

##### **➤ Kërkimi i ndjeshmërisë**

Fëmijët që janë të pandjeshëm ndaj zërave mund të kërkojnë informata dëgjimore shtesë ose edhe mund të jenë pasiv. Ato mund:

- mos u përgjigjen zërave edhe në mjedise ku nuk ka aspak zhurmë;
- të duken se nuk dëgjojnë;

- të duken si të pavëmendshëm për atë që ndodh rreth tyre;
- duhet të përsëriten udhëzimet;
- me zë të lartë të bisedojnë me vetëveten, bëjnë zhurma me objektet që përdorin;
- të pëlqejnë tejet mase zhurmën me zë të lartë;
- të tregojnë vetëdije të dobët fonologjike dhe vështirësi në shkrim-leximin.

#### **1.4.4. Strategji arsimore**

- Shikoje në sy fëmijën para se të fol;
- Jep nga një udhëzim brenda një kohë;
- Flisni ngadalë dhe qartë, përsëritni udhëzimet për fëmijën dhe sigurohuni se ai e ka kuptuar duke e pyetur të përsërit të njëjtën gjë;
- Sigurohuni që nxënësi nuk do të largohet përderisa udhëzimi që i jepete e ka mbaruar;
- Prisni që nxënësi të përpunojë informacionin dhe të jep përgjigje; mund t'i duhet më tepër kohë sesa bashkëmoshatarëve tjerë;
- Përdor orare vizuale/sistem të punës, fleta për të mbështetur udhëzimet e dhëna, jep edhe sqarime fizike nëse është e nevojshme;
- Përgatitni fëmijën për zhurma të forta të parashikueshme siç është zilja e shkollës;
- Bëji të vetëdijshëm për zhurmat që krijohen në sfond siç është ajo nga projektori, llambat që bëjnë drite dhe nëse duhet shuani ato për një kohë të caktuar;
- Zvogëloni shpërqëndrimin e dëgjimit që mund të krijohet qoftë nga brenda ose jashtë klasës;
- Siguroni kufje/tapa veshësh që nxënësi t'i mbajë kur i duhet të fokusohet në punë, ose në situata veçanërisht të zhurmshme, ose mundësoi nxënësit të punojë në një vend ose në një zonë të qetë;
- Bisedo me fëmijën dhe prindërit për përdorimin e muzikës nëse kjo do ta ndihmojë të përqëndrohet, qoftë muzikë qetësuese në sfond ose muzikë më e zhurmshme në varësi të nevojës (Evamy, 2003).

#### **1.4.5. Aktivitete për të përmirësuar përpunimin dëgjimor**

Nëse nxënësi shpreh një ndjeshmëri të theksuar ndaj zhurmave, rekomandohet një terapist i të folurit dhe gjuhës ose terapist profesional.

- *Lojëra të kujtesës* siç janë: 'Unë shkova në vetëshërbim dhe bleva'....
- *Përsëritje e renditjeve të njohura*: ditët e javës, muajt e vitit, numrat. Ndryshoje këtë renditje duke pyetur cila ndryshoj rregullin;
- *Lojëra me çanta mbushëse* vendo disa objekte në çantë dhe kërko nga nxënësi që të gjejnë një objekt ose diçka të rëndë/butë me gëzof etj.;
- *Jep udhëzime duke përdorur* lokacione nga harta;
- Përpara se të lexoni tregime fëmijëve, kërko nga ai të dëgjoj dhe përqëndrohet tek një fjalë, karakter, apo frazë më specifike në tregim. Pastaj lexoje tregimin krejt dhe në fund kërko nga ai që ta përsërit sërish dhe ta përpunojë pyetjen origjinale;

- *Lojëra madhore motorike*, me sqarime zanore, si p.sh.: “Pata bëni...(ga-ga-ga)”, “Rosa bëni...(mak-mak-mak)”;
- *Lojëra tjera argëtuese*, të cilët përfshin identifikimin e tingujve nga jeta e përditshme, siç janë tik -tak -et e orës, mbyllja e derës, etj. (Jeffries & Jeffries, 2001).

## 1.5. Përpunimi vizual (pamor)

### 1.5.1. Çfarë është përpunimi vizual?

Përpunimi vizual apo pamor është një term i përgjithshëm që ju referohet të gjithë aftësive të nevojshme për të përdorur shqisat e të parit. Aftësitë përfshinë:

- Përvetësimi i informacioneve përmes syve - përfshirë këtu fokusimin, bashkimin e të dy syve, lëvizjen e tyre ose gjurmimin dhe vetëdijen e rrethinës optike;
- Transportimin (bartjen) e informacioneve deri te lëvorja (cortex) optike dhe shpërndarja (ose integrimi) i atij informacioni vizual me sistemet tjera - siç janë: të dëgjuarit, prekja dhe baraspesha;
- Interpretimi i asaj që shohim dhe përdorimi për të promovuar veprime.

### 1.5.2. Pse është i rëndësishëm përpunimi vizual?

Mbi 80% e njohurisë sonë të përvetësuar është vizuale. Përpunimi vizual jo efikas do të ndikojë mbi efikasitetin e bashkëveprimit tonë me mjedisin që na rrethon dhe zhvillimit të memorieve të reja dhe njohurive të botës përreth nesh.

### 1.5.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?

Fëmijët me përpunim të dobët vizual, do të gjejnë rutina më të rënda të jetës së përditshme për t’i përballuar. Do të jenë edhe më pak efikas në një varg fushash tjera, si p.sh.:

- Detyra ku kërkohet koordinimi sy-duar do të jenë të vështira - sidomos në ato sportive;
- Atyre mund t’u duket e vështirë të kujtojnë informata, duke u varur vetëm në aftësi verbale dhe kështu kjo e bën edhe më të vështirë kreativitetin e tyre;
- Në disa raste ekstreme ato mund të bëhen të pasigurt edhe ndaj mjedisit që i rrethon për shkak të lidhjeve të dobëta hapësinore. Kjo mund të ndikojë në vetëbesimin e tyre në shumë mënyra, duke pasur ndikim edhe tek bashkëveprimet e tyre sociale.

#### ➤ **Shmangie të ndjeshmërisë**

Fëmijët që shmangin informatat vizuale mund:

- shpesh t'i fërkojnë sytë;
- hutohen nga shumë stimuj vizual;
- nuk pëlqejnë dritën e llambave apo dritën e fortë të rrezeve diellore;
- preferojnë të punojnë nën ndriçim të errët apo mjedise të errëta;
- nuk janë në gjendje të gjejnë atë që kërkojnë;
- kanë vështirësi të kopjojnë atë që është shkruar në dërrasën e zezë;
- kanë të vështirë të shkruajnë dhe rrinë mbi vijë.

#### ➤ **Kërkime të ndjeshmërisë**

Fëmijët që kërkojnë shumë informata vizuale mund:

- Të pëlqejnë ngjyra të zjarrta ose rreze diellore;
- Pëlqejnë ekspozime të dendura në klasë;
- Pëlqejnë ngjyra të zjarrta;
- Kanë vështirësi të tregojnë dallimin ndërmjet pikturave të ngjajshme apo ngjyrave;
- Humbin vendin kur janë duke lexuar;
- Lodhen shpejtë me aktivitetet shkollorë;
- Harrojnë ndarjen e rreshtave ose kanë një ndarje të dobët kur shkruajnë.

#### **1.5.4. Strategji arsimore**

- Siguro hapësirë pune/dërrasa private në mënyrë që nxënësi të mund të punojë në një zonë pa shpërqëndrime vizuale;
- Mundohuni të shmangni vendosjen e nxënësit nën dritën fluoreshente për punë;
- Sigurohuni që zona e punës të jetë e pastër/rregulluar;
- Punëni në një sipërfaqe pune me kënd, që çdo gjë të mund të kontrollohet;
- Kushto kujdes gjërave që shpërqëndrojnë vëmendjen vizuale, siç janë: ekspozimet në mur, stolitë e mësuesit, dhe tabelat e bardha interaktive;
- Përdor organizatorë/programe vizuale;
- Përdorni pasqyrë për fëmijën për të kontrolluar pamjen e vet;
- Përdorni ngjyra të ndryshme për vija të ndryshme në dërrasën e zezë, apo në dërrasën e bardhë interaktive;
- Përdorni theksues ose stilolaps me ngjyrë të errët për të nënvizuar punën dhe për të theksuar pikat kryesore;
- Sigurohuni që fëmijët vendosin syzat kundër rrezeve të forta diellore.

#### **1.5.5. Aktivitete që të përmirësosh aftësitë vizuale (pamore)**

Në këtë pjesë të aktiviteteve i përdorim të njëjtat aktivitete që përdoren për Kontrollin vizual motorik (shih - 3.2.5. Aktivitetet që rrisin ndjekjen vizuale dhe kontrollin motorik të syve).

## 2. Hyrje në Koordinimin motorik madhor



### a. Çfarë është koordinimi motorik madhor?

Koordinimi i motorikës së madhe është aftësia për të zbatuar lëvizje të mëdha me një rrjedhshmëri, saktësi dhe përpikëri. Me qëllim që të arrijnë koordinim efikas motorik, fëmijët duhet të zhvillojnë dhe integrojnë aftësitë përbërëse. Përpunimi shqisor i informatës i cili pranohet dhe pastaj procesohet përmes receptorëve tek nyjet, lëkura, sytë, veshët dhe goja, duhet të jetë automatike që tu mundësojë niveleve më të larta të aftësive të zhvillohen. Pastaj lëvizjet e mëdha motorike varen nga koordinimi i mirë i aftësive siç janë: planifikimi motorik, qëndrueshmëria e pozitës trupore dhe baraspesha, si dhe vetëdija hapësinore dhe trupore, kalimin e vijës së mesit dhe lateralizimin (Jenkinson, Hyde, & Ahmad, 2008).

### b. Pse është i rëndësishëm koordinimi motorik madhor?

Ky koordinim është i rëndësishëm për faktin se i jep kontrollin e nevojshëm posturës (qëndrimin) së trupit për përvetësimin e aftësive më të pjekura madhore dhe delikate motorike. Është thelbësore për zhvillimin e shkathtësive të duarve, sepse lëvizjet e kontrolluara dhe të koordinuara të motorikës madhore dhe ato delikate duhet të jenë në vend përpara se lëvizjet më të vogla të rafinohen (Chu, 2003).

### c. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?

Fëmijët me probleme të koordinimit motorik madhor mund të kenë vështirësi në:

- Organizimin e lëvizjeve trupore, janë të pavetëdijshëm për hapësirën e tyre personale, ulen në qilim duke shkaktuar shqetësime;
- Veshjen për aktivitetet të lëndës së arsimit fizik dhe marrjen pjesë në mësim, si p.sh.: t'i përdorin aparatet, të bëjnë lëvizje gjatë aktiviteteve muzikore apo dramatike;
- Marrjen pjesë në lojëra të ndryshme në fushën sportive, si p.sh. kërcim, apo lojëra me vrapim;



- Lëvizjen në klasë pa mos u ndeshur me fëmijët e tjerë apo orenditë dhe e kanë të vështirë të presin në rresht;
- Qëndrimin në një vend, apo të jenë të vëmendshëm dhe të përqendruar në mësim ose në aktivitete shkollore;
- Mbajtjen e një pozicioni punues, të punojnë në sipërfaqe vertikale, si p.sh. në dërrasan e zezë ose tabelën interaktive;
- Hapjen e dyerve të rënda apo të bëjnë detyra që kërkojnë një qëndrim më të madh;
- Mbajtjen dhe mbledhjen e objekteve apo pajisjeve mësimore;
- Marrja pjesë në orët praktike, veçanërisht ku kërkohet përdorimi i të dy duarve bashkë;
- Qëndrueshmëri më të madhe kohore sidomos gjatë orëve të shkrimit, kur duhet të prodhojnë një sasi më të madhe të punës me shkrim.

**Brenda kësaj fushe, koordinimi motorik madhor është ndarë në disa pjesë:**

1. Planifikimi motorik;
2. Qëndrueshmëria e posturës dhe baraspeshës;
3. Vetëdija hapësinore dhe trupore;
4. Integrimi i dyanshëm;
5. Kalimi i vijës së mesit dhe lateralizimi.

***Referohu Shtojcës***

Sh. 1 Mosha dhe fazat e zhvillimit.

## **2.1. Planifikimi motorik**

### **2.1.1. Çfarë është planifikimi motorik?**

Planifikimi motorik është hapi i parë në aftësitë e reja më të ndërlikuara, ose të atyre që kërkojnë renditje, sepse përfshin praktikë (planifikim). Është një aftësi e veçantë njerëzore, e cila kërkon një mendim me vetëdije, duke ia mundësuar trurit të konceptojë, organizojë dhe të drejtojë bashkëveprime qëllimore me botën fizike (Ayres, Mailloux, & Wendler, 1987). Ajo përfshin:

- Idetë - të dimë çfarë të bëjmë;
- Planifikim motorik - të dimë si ta bëjmë;
- Zbatimin - të dimë si ta zbatojmë atë në mënyrë të suksesshme.

### **2.1.2. Pse është i rëndësishëm planifikimi motorik?**

Çdo aktivitet i ndërmarrë sado i thjeshtë që duket, kërkon një planifikim motorik, sepse nxënësi duhet të ketë një ide për detyrën, çfarë përfshin ajo detyrë dhe si duhet të realizohet.

Organizimi, planifikimi dhe pastaj zbatimi ose ekzekutimi motorik i detyrave të reja ose të vjetra kërkohet përgjatë ditës së një fëmije. Që të bëhet një planifikim i mirë motorik, trurit i duhen informacione thelbësore prej të gjitha sistemeve shqisore, si dhe një vetëdijesim trupor dhe perceptim të lëvizjes. Pastaj mundet t'i shty në përdorim impulset shqisore të planifikojnë, organizojnë kohën dhe sekuencën e detyrave të panjohura (Kirby & Drew, 2003).

### **2.1.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Fëmijët me probleme në planifikimin motorik mund të kenë vështirësi:

- Në zotërimin e një shkathhtësie të re - mund të stërmundohet dhe të duket si i ngathet ose i çrregulluar;
- Kur fillon një detyrë nuk e kupton çfarë duhet të bëjë;
- Në zbatimin e një detyrë mund të shpejtojë duke prodhuar punë të çrregulluar ose punë pa plan;
- Kur duhet të mbarojë një punë nuk ka strategji përfundimi;
- Me detyrat e shkrimit - nuk ka një organizim të mendimeve në rresht, mund t'i bëjë mendimet të duken të copëtuara dhe të kenë mungesë të një rrjedhshmërie e cila mund të vijë kur nxënësi nuk ka një planifikim të rrjedhshëm të ngjarjeve;
- Në realizimin e punëve praktike/artizanale/ ndërtimore/ dhe tematike;
- Në manipulimin (manovrimin) e mjeteve - si të brushave për ngjyrosje, ngjitësve të lëngshëm, gërsërëve, vizoreve, kompasit dhe këndmatësve;
- Të organizojnë lëvizjet trupore, të jetë i vetëdijshëm për hapësirën e vet personale, të rri ulur pa mos shkaktuar shqetësime apo në lëvizjet nga lënda e arsimit fizik ku duhet si p.sh. të ecë i koordinuar mbi karrige;
- Në detyrat për vetëkujdesje dhe vetëshërbim - si p.sh.: të veshurit, përdorimi i takëmit (mjetet për ushqim) apo mirëmbajtjes së pastërtisë ndaj vetes;
- Në ndërmarrjen e detyrave që kërkojnë një qëndresë të madhe apo tolerancë për qëndrueshmëri.

### **2.1.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Ndihmoji nxënësit që të ndajë në pjesë të ndryshme detyrën, përsërit të gjitha udhëzimet e detyrës disa herë dhe paraqiti në fletë hapat që duhet ti ndërmarrë nxënësi;
- Pyet çka?, ku?, kur?, pse?, si? që ta bësh fëmijën të mendojë rreth detyrës;
- Jep shenja apo orientime vizuale;
- Përfshi edhe veprime verbale gjatë bërjes së detyrës që t'i ndihmojë nxënësit të lëviz edhe fizikisht gjatë veprimit;
- Vendosni objektiva të vogla të arritshme dhe planifikoni metodën e regjistrimit kur detyra të ketë mbaruar;
- Jep nga një udhëzim në kohë, kur një pjesë e detyrës ka përfunduar, jepe tjetrën;
- Minimizoni shpërqëndrimet vizuale, synoni për një mjedis të pa rrëmujshtëm;

- Rishikoni rregullat e lojërave përpara se ta luani atë – shpjegoni edhe me gojë duke e demonstruar lojën;
- Shënoji kufijtë e lojës, - përdor shirita apo ndonjë mjet tjetër kufizues;
- Bëni ushtrime rreth asaj çfarë nxënësi ka mësuar brenda një dite të zakonshme, jep edhe udhëzime me demonstrime;
- Mundësoi nxënësit të planifikoj ndryshime në sekuencë apo rrjedhën e gjërave dhe të kujtojë e të zbatoj çdo ndryshim të bërë, që aftësia të fillojë gradualisht të bëhet rutinë (Levine, 1991).

### **2.1.5. Aktivitete që ndihmojnë në përmirësimin e planifikimit motorik**

- *Shtigje (rrugica) me pengesa* - përdor pozicione të ndryshme (ndër, mbi, përmes) drejtime (si të lëvizjes së akrepave të orës, kthime majtas-djathtas ose para-prapa, anash) të posturës (qëndrimit trupor) (zvarritje, ecja në maje të gishtërinjve), lartësive, apo teksturave (e butë, fortë, e palëmuar);
- *Shkelje e gurëve* – planifikim i rrugës nëpër dhomës;
- *Orientim hapësinor*- lëvizje rreth dhomës apo tek shtegu me pengesa me sy mbyllur duke ndjekur udhëzime;
- *Lojëra në shesh lojërash* – kapërcim, lojëra të ndryshme me kërcitje në ajër apo me top;
- *Vizatime të labirinteve*- aktivitete arti dhe artizanale, kolazhe, modelime të figurave me letër;
- *Lexim i hartës* - nga paraqitjet bazë pikturale të hartat në ato me profesionale operative;
- *Prerje me gërshërë*- pjesëve të ndryshme për të bërë një tërësi;
- *Detyra ndërtimore* – ndjekja e udhëzimeve;
- *Ushtrime lidhjen* - të lidhin kravatën e shkollës, lidhjen e fjongove të përparëseve etj.

## **2.2. Qëndrueshmëria e posturës (pozitës trupore) dhe baraspesha**

### **2.2.1. Çfarë është qëndrueshmëria e pozitës trupore dhe baraspesha?**

Qëndrueshmëria e pozitës trupore është aftësia e mbajtjes dhe ndryshimit të pozicionit të trupit dhe qafës me qëllim që shtylla kurrizore të mundësojë një bazë të qëndrueshme për pozicionimin dhe lëvizjen e gjymtyrëve, përderisa koka të qëndrojë në pozicionin e saj optimal për një funksionim vizual të efektshëm. Kurse baraspesha mund të ndahet në atë statike (mbajtjen e qëndrimit kur rri i qetë) dhe në atë dinamike (kontrollimin e qëndrimit kur je në lëvizje) (Jenkinson, Hyde, & Ahmad, 2008).

### **2.2.2. Pse është e rëndësishme qëndrueshmëria e pozitës trupore dhe baraspesha?**

Qëndrueshmëri e mirë e pozitës trupore është e nevojshme për një kontrollim efikas të lëvizjeve. Të gjitha lëvizjet e mëdha motorike krijohen prej punës së boshtit qëndror. Qëndrueshmëria tek legeni dhe brezi i shpatullave (qëndrueshmëria e boshtit) lejojnë një varg të ndryshëm të lëvizjeve të krahëve dhe duarve. Kontrollimi i krahëve dhe të gjithë shkathtësitë tjera të duarve dhe rezistenca ulen shumë, nëse trunghi i trupit nuk është i qëndrueshëm.

Qëndrueshmëria e posturës trupore mundëson kontrollin e nevojshëm të qëndrimit trupor për përvetësimin e aftësive motorike të mëdha dhe delikate. Është po ashtu thelbësore për zhvillimin shkathtësive delikate të duarve, sepse lëvizjet e mëdha motorike që janë të koordinuara dhe kontrolluara duhet të jenë në vendin e tyre që këto lëvizje më të vogla të përmirësohen (Chu, 2003).

### **2.2.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Fëmijët me qëndrueshmëri të dobët të pozitës trupore dhe baraspeshës mund ti kenë këto vështirësi:

- Kërcimin, hedhjen lartë/ lëvizjet e rrjedhshme/ ndryshimin e pozicionit/ apo marrjes pjesë në fushat e lojës;
- Të ecurit në sipërfaqe jo të rrafsha/ përmes litarit apo në ngjitjen e shkallëve;
- Në lojërat ekipore/ me shkop dhe top/ në shtigjet me pengesa;
- Në aktivitetet e arsimit fizik, të punojnë me pajisje që janë mbi tokë;
- Në uljet në karrige apo dysheme pa mos i zë vendi vend, shtrembërohen ose rëzohen;
- Hapjen e dyerve të rënda;
- Pasaktësi gjatë lojës së ndërtimit me tulla, në lojërat tjera me ndërtime, apo në fiksimin e pajisjeve;
- Në kujdesin ndaj vetes- në veshje, ngrënie, ose kujdesit personal, vendosjen e kutive të ushqimit lartë nëpër raftet apo varjen e palltos;
- Të mbajnë një pozicion punues funksional, të shkruajnë në dërrasën interaktive, apo të kenë durim për detyrën, ose të kenë durim deri në përfundimin e vitit shkollor.

### **2.2.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Përdor shenja vizuale, si p.sh.: qilima me ngjyrë;
- Më shumë përdor karrige, sesa ulje në dysheme ose qëndrim në këmbë gjatë demonstrimeve të aktiviteteve;
- Mëso lëvizje balancuese si p.sh.: bërryla të fiksuara mbi tavolinë, fokusim i syve për të mbajtur baraspeshën;
- Mundëso sipërfaqe këndore për të shkruarit dhe jastëk të madh për tu ulur ose jastëk lëvizës për t'u ulur;

- Sigurohu se nxënësi ka një pamje të pastër të mësuesit dhe dërrasës pa mos pasur nevojë ta lëviz trupin (Levine, 1991).

### **2.2.5. Aktivitete për të përmirësuar qëndrueshmërinë e pozitës trupore dhe shkathtësi për mbajtjen e baraspeshës**

- *Qëndrimi me një këmbë* mbi një kuti të ulët për këndim/duartrokitje, për të luajtur/kap lodra ose objekte nga dyshemeja;
- *Puna në sipërfaqe jo të rrafshta* - si p.sh.: qëndro mbi dërrasa që lëkundet ose mbi topin e futbollit që të sfidohesh bashkë me fëmijët. Përsëriti aktivitetet e të qëndruarit me një këmbë;
- *Kërce mbi thembra* - në mes dy litarëve ose përgjatë një vije, para, prapa, anash, mbi dysheme ose përgjatë një dërrase (tavoline);
- *Lojëra me rrotullim*- në një vijë të drejtë, para, pas, anash, balancimin mbi pjesë të ndryshme të trupit, pastaj lojërat me kërcim me thes ose lojërat me shigjetë;
- *Loja si statujë*- qëndro si statujë kur japësh ndonjë shenjë ose qëndro ashtu kur partneri vinë të të prekë;
- *Aktivitetet që përfshijn qëndrimin mbi bark* – zgjatja e krahëve dhe këmbëve, hapja e tyre dhe ngritje nga lartë;
- *Aktivitetet që përfshijn qëndrimin mbi shpinë* - qëndrim i shtrirë në shpinë dhe me duar i tërheqë gjunjët kah vetja (kraharori), ose rrotullohen;
- *Të japësh urdhër për zvarritje apo imitim të kafshëve* – ecje si gaforre, apo kërcime si lepur;
- *Ecje* – në shkallë prej druri, ngjitje nëpër pajisje të ndryshme në fushat e lojës;
- *Shtigje me pengesa* - për këtë aktivitet përfshi pajisje të ndryshme, tekstura, lartësi, drejtime dhe orientime.

## **2.3. Vetëdija hapësinore dhe trupore**

### **2.3.1. Çfarë është vetëdija hapësinore dhe trupore?**

Vetëdija hapësinore është aftësia të interpretosh informata nga hapësira (mjedisi) dhe t'i vësh në përdorim të njëjtat në një mënyrë të organizuar, sistematike për të planifikuar lëvizje. Vetëdija hapësinore dhe trupore na jep neve informata për mjedisin që na rrethon dhe lidhjen e trupit tonë me hapësirën e jashtme.

Vetëdija trupore është nënvetëdija jonë e dijes se ku gjendet çdo pjesë e trupit dhe si po lëviz trupi jonë pa mos u mbështetur tek shikimi. Ky informacion interpretohet përmes muskujve, njejeve dhe receptorëve të lëkurës, pas së cilës informacioni vizual mund të

integrohet. Ajo mbështetet në përpunimin e mirë propioceptiv, vestibular dhe ndjeshmërinë e prekjes (Jenkinson, Hyde, & Ahmad, 2008).

### **2.3.2. Pse është e rëndësishme vetëdija hapësinore dhe trupore?**

Përderisa foshnjat zhvillojnë vetëdijen për aftësinë e tyre për t'i kontrolluar lëvizjet e tyre dhe për të vepruar në mjedisin që i rrethon, ata mësojnë të perceptojnë distancën dhe drejtimin midis objekteve dhe pjesëve të trupit të tyre. Gjykimet e hershme hapësinore bëhen duke përdorur veten si referencë (hapësirë brendapersonale). Fëmijët gradualisht zhvillojnë vetëdijen e tyre për objektet dhe hapësirën e jashtme si të ndara nga vetja dhe ata e zbatojnë informacionin e mësuar në lidhje me trupin e tyre ndaj objekteve në hapësirën jashtëpersonale (Levine, 1991).

Fëmijët zhvillohen në fazat e mëposhtme duke përdorur eksplorimin fizik dhe lëvizjen:

- Marrëdhëniet hapësinore të pjesëve të trupit;
- Gjykimi për madhësinë, formën dhe distancën ndërmjet pjesëve të trupit dhe objekteve;
- Marrëdhëniet ndërmjet një objekti dhe objekteve tjera në hapësirë.

Fëmijët me vetëdije të dobët hapësinore dhe trupore mbështeten më shumë në informacionet vizuale sepse kanë një vetëdije të paqartë për pozicionin e tyre në hapësirë. Ata mund të mos jenë në gjendje të lëvizin rrjedhshëm nëse nuk i shohin krahët dhe këmbët e tyre. Ata gjithashtu mund të kenë edhe probleme me vëmendjen vizuale, lateralitetin, dallimin e anëve majtas/djathtas, kalimin e vijës së mesit të trupit dhe konceptet hapësinore të trupit (lartë/poshtë, përpara-anësh-mbrapa) (Chu, 2003).

### **2.3.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Fëmijët me probleme të vetëdijes hapësinore dhe trupore mund të kenë vështirësi me:

- Identifikimin, gjetjen dhe mbajtjen mend të pjesëve të trupit tek vetja dhe tek të tjerët;
- Njohjen e anëve të djathta/të majta të trupit të tyre dhe përdorimi i vetëdijes djathtas/majtas në lidhje me njerëzit tjerë, objektet dhe gjatë dorëshkrimit;
- Lëvizjen në hapësirë - pa mos u ndeshur me njerëz, objekte apo të marrin pjesë në aktivitete të ndryshme nga arsimi fizik, vrapimin në drejtimin e duhur, vallëzim apo në improvizimet dramatike, lëvizjen e këmbëve në notim, etj.;
- Kujdesin ndaj vetes–veshjen e teshave në mënyrë korrekte, mbërthimin e kopsave në linjë, veshjen e këpucëve në këmbët e duhura, krehjen e flokëve, pastrimin e dhëmbëve, përdorimin e takëmit për ngrënie (lugë, pirun, thikë), vendosjen e gjalpmit mbi bukë, apo të derdhin diçka në gotë;
- Organizimin e vetvetes apo gjërave që ju përkasin;
- Qëndrimin mbrenda kufijve të tyre personale pa pushtuar hapësirën e tjetrit, kalimin e sigurt të rrugës, gjykimi/vlerësimi i trafikut në lëvizje;

- Ndjekja e udhëzimeve të Cilët përfshijnë konceptet hapësinore (vertikale, horizontale) të kuptojnë gjeometrinë, simetrinë dhe vendosjen e gjërave;
- Dorëshkrimin - të dallojnë madhësitë, format, dhe ndarjen e fjalëve në rreshta, të shkruajnë mbi vijë (në rresht) dhe të vendosin punën e shkruar në nj faqe;
- Aktivitet me laps dhe fletë- të kopjojnë fotografi, vizatojnë plane (skica), klasifikimin e diagrameve, ndjekjen e labirinteve;
- Kompletimin e lojërave puzzle, ndërtimin e gjërave tredimensionale duke shfrytëzuar modele po ashtu tredimensionale (3D-3D) ose të fotografive dydimensionale në ato tredimensionale (2D-3D);

#### **2.3.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Mundëso përforsim verbal të pozicionit dhe drejtimit;
- Mësoni nxënësit se si të hedhin sy (skanojnë) informatave nga e majta në të djathtë, nga lartë poshtë;
- Përdorni kartat sugjeruese për ta ndihmuar nxënësin të flasë gjatë një aktiviteti;
- Përdorni kodimin e ngjyrave që do t'i ndihmojë nxënësit ta organizojë punën dhe hapësirën;
- Përqendrohuni në aktivitetet lëvizëse për ta motivuar nxënësin;
- Përdorni qilima në formë të katrorit për të përcaktuar vendin e uljes;
- Përdorni tapetin e mausit ose ndonjë shtresë për tavolinë për të përcaktuar zonën e punës.

#### **2.3.5. Aktivitete për të përmirësuar vetëdijen hapësinore dhe trupore**

*Është thelbësore që nxënësit të lëvizin përreth dhe të përjetojnë pozitën e trupit të tyre në hapësirë në vend që fillimisht të përpiqen mësojë duke plotësuar enigma (puzzles) apo me aktivitete që realizohen duke ndenjtur ulur.*

- *Emërtoni dhe prekni pjesë të ndryshme të trupit me syhapur dhe pastaj symbyllur, riprodhoni lëvizje trupore që nxënësi të kopjojë të rriturin, pastaj riprodhoni lëvizje trupore që nxënësi ti kopjojë si të pasqyruara;*
- *Mundje trupore duke përdorur reagime të prekshme, si p.sh.: ulje me shpina të ngjitura me njëra tjetrën dhe të ulur në gjunjë dhe me bërryla të lidhura duke u munduar të shtrëngojnë partnerin anash në dysheme në drejtimin e zgjedhur;*
- *Ndriço me pishtar (fener) mbi pjesë të ndryshme të trupit të nxënësit dhe bëji që të identifikojnë në Cilët pjesë ndriçon;*
- *Vizatoni përreth nxënësit dhe bëni një kolazh, përdor ngjitëse për ti etiketuar dhe referuar kur ato e vizatojnë pikturën e tyre;*
- *Përdorni enigma (puzzles) të trupit apo fytyrës- përfundo një pikturë të një personi të vizatur, apo kopjo piktura të personazheve të ndryshëm;*

- *Rrotullim në sipërfaqe të ndryshme dhe tekstura* – qilima, drurë, barë, aktivitete me mbajtje të peshave - mbajnë pesha të rënda, bëjnë gjurmë të duarve mbi mur/ dysheme apo bëjnë presion për poshtë;
- *Shtyrje/tërhiqje përmbi karrige*, zvarritje përmes tunelit, kërcim mbi trampolinë, aktivitete qarkore ose për sigurinë rrugore;
- *Shtigje me pengesa* që përfshin lëvizje brenda në, jashtë, mbi, ndër, në mes dhe përreth objekteve;
- *Aktivitete me shënjestër (objektiv)* me topa, thasë, duke e zvogëluar gradualisht madhësinë e objektivave dhe duke e rritur distancën për gjuajtje/goditje.

## **2.4. Integrimi i dyanshëm**

### **2.4.1. Çfarë është integrimi i dyanshëm?**

Integrimi i dyanshëm është aftësia për të koordinuar bashkë të dy anët e trupit në një mënyrë efikase për të kryer një aktivitet, duke bërë të mundur që lëvizjet e anëve të djathta dhe të majta, si dhe lart dhe poshtë të koordinohen në mënyrë të shkathët. Këto lëvizje mund të jenë:

- Simetrike (lëvizje të njëjta të dy pjesë të trupit), si p.sh.: kërcime në formë të yllit;
- Alternuara/anasjelltas (lëvizje e njëjtë e realizuar fillimisht nga njëra pjesë e trupit pastaj nga pjesa tjetër), si p.sh.: zvarritja;
- Realizimi i veprimeve të ndryshme (njëra anë e trupit bënë një lëvizje, kurse pjesa tjetër diçka krejtësisht të ndryshme) si p.sh.: lidhja e lidhëseve të këpucëve.

### **2.4.2. Pse është i rëndësishëm integrimi i dyanshëm?**

Integrimi i dyanshëm, formon “bazën për zhvillimin e koordinimit midis anëve të djathta dhe të majta të trupit, forcon zotërimin e duarve dhe koordinimin efektiv të dy duarve. Ai gjithashtu kontribuon në mes komunikimit midis anëve të djathtë dhe të majtë të trurit për të zhvilluar funksionet e të perceptuarit (kuptuarit) dhe funksionet njohëse (kognitive) për të mësuar” (Chu, 2003).

### **2.4.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Nxënësit me probleme në integrimin e dy anëve të trupit mund të kenë vështirësi me:

- Ngjitjen nëpër shkallë duke përdorur njërin këmbë pas tjetrës (veprime reciproke);



- Aktivitetet fizike, mjetet e punës, në zvarritje, kërcime, hedhje në ajër apo në lojën tërheqje të litarit;
- Gjatë notimit, ngasjes së biçikletës, në aventurat në fushën e lojës, apo në ngjitje;
- Në lojërat me top dhe shkop, gjuajtje dhe kapje, goditje me shkelm apo driblime të topit;
- Kujdesin ndaj vetes – mbylljen e kopsave, përdorimin e thikës, pirunit, të lidhin lidhëse ose kravatë, apo të përgatisin një pije;
- Mësimin apo luajtjen në instrumente;
- Përdorimin e gërsërëve, kryerja e aktiviteteve me prerje dhe ngjitje nga arti figurativ apo artizanale të ndryshme;
- Detyra ndërtuese, të krijojnë kuverta, punime me letra kartoni, apo në palosjen e letrës;
- Detyrat praktike - kur përdorin vegla dhe pajisje për balancim, qepje, gatim, punime druri, apo në kopshtari;
- Detyrat me laps dhe letër - stabilizimin e letrës që përdor, përdorimin e shablloëve, vizoreve, këndmatësve, modeleve.

#### **2.4.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Përdorni shenja vizuale për të shënuar pozicionin e fillimit dhe të ndalimit;
- Filloni me aktivitete që janë të njëanshme që zhvillohen vetëm me pjesët e njëjta të trupit, pastaj vazhdoni me ato simetrike (me dy anët e trupit), asimetrike dhe reciproke;
- Ndani çdo detyrë në pjesë të vogla që janë të arritshme dhe praktikisht pjesë individuale;
- Ndhijmoji nxënësit të përdor sinjalizime/nxitje verbale;
- Punoni me nxënësin për të planifikuar paraprakisht detyrën duke përdorur strategji të menduarit si p.sh.: qëllim, planifikim, kontrollim/ndalim, të mendoj dhe pastaj ta realizoj;
- Modifiko/përshtate detyrën, si p.sh.: përdor lidhëse që janë veçse të rrudhëta në vend të atyre që janë standarde që kërkojnë të lidhen;
- Përdorni pajisje/vizore matematikore magnetike (Levine, 1991).

#### **2.4.5. Aktivitete për të përmirësuar qëndrueshmërinë e pozitës trupore dhe aftësi për baraspeshë**

- *Marshim në vend* ose rreth dhomës, me sytë hapur/sytë mbyllur, zvarritje apo marshim mbi shtigje me pengesa;
- *Kërcime me këmbë të bashkuara*- kërcime në formë të yllit- (këmbët njëherë pastaj krahët dhe këmbët), kërcime si të lepurit;
- *Kërcim me litar*- kërcime në dy anët përmbi litar duke e lëkundur dy shokë litarin, kërcime individuale me litar;
- *Lojëra me top* – hedhje/ kapje duke përdorur të dy duart bashkë/ shkelmim dhe driblim;
- *Çiklizëm*, notim, patinazh me rrota, ecje me shkopinj prej druri;
- *Loja në rërë dhe ujë*- mbushje dhe derdhje të shisheve, bërjen e kështjellave nga rëra, flluskave me ujë dhe duartrokitje;

- *Aktivitete nga arti dhe artizanale:*
  - fleta: palosje, rrudhosje, grisje, bërje kolazh, thurje, ngjitje;
  - aktivitete me gërshërë: prerje, bërje dhe montim;
  - ngjyrosje: ngjyrosje me gishta, me shkumë për rruajtje, ngjyrosje të mermerit, prerje të linoleumit, prerje dhe ngjyrosje të patateve;
  - gatim: përzierje, rrotullim, rrahje (tundje), trazim, shpërndarje, prerje, derdhje;
  - qepje dhe zbukurime me rruaza: lidhje të lidhësve, fjongove dhe qëndisje me gjilpërë dhe rruaza;
  - punë në vargje apo fije teli, thurje në dantellë, thurje me shtiza, thurje me grep;
  - pune në dru: matje dhe vendosje të shenjave, sharrim, spërkatje (shtirrje me rërë) dhe goditje me çekan;
  - punë në kopsht: groposje, mbjellje, ujitje, korrje;
- *Aktivitete ndërtuese:* bërje të maketës: lojë me brumë, me baltë, ndërtime me letër dhe ngjitëse që formojnë forma të ndryshme të lakueshme duke përdorur vjeturina, kashta, lidhëse, thurje, pllaka, apo me figura të ndryshme;
- *Ushtrime duke përdorur mjete shkollore:* vizore, kompas, këndmatës, vizore katrore, stilolaps nënvizues;
- *Lojëra komerciale:* Lojë me dru të vegjël për të ndërtuar diçka, lojëra me ‘Labyrinth’, ‘Playstation’;
- Luarja e ndonjë instrumenti muzikor: daulle, instrumenti në formën e trekëndëshit, dridhëset (instrumente të drurit që kur dridhen bëjnë ritme të ndryshme muzikore), dridhëse tjetra nga Rumba, instrumente frymore dhe me tel, si dhe piano.

## **2.5. Kalimi i vijës së mesit dhe lateralizimi**

### **2.5.1. Çfarë është kalimi i vijës së mesit dhe lateralizimi?**

Kalimi i vijës së mesit është aftësia për të lëviz dorën, këmbën dhe sytë përtej qendrës së trupit. Kurse lateralizimi është vetëdija se trupi ka dy pjesë të ndryshme dhe se duhet të krijojnë një zotërim të anës dominante, dallimi djathtas/majtas është forma më e avancuar e lateralizimit.

### **2.5.2. Pse është i rëndësishme kalimi i vijës së mesit dhe lateralizimi?**

Kalimi i vijës së mesit na mundëson kruerjen e aktiviteteve të ndryshme pa mos përdorur shumë energji dhe përpjekje. Nxënësit që nuk mund të kalojnë vijën e mesit (d.m.th lëvizje të duarve, këmbëve) mund të kenë vetëm përdorim të njërës anë të duarve, duke

preferuar që të përdorin dorën e tyre të majtë për aktivitetet në anën e majtë të trupit të tyre dhe dorën e tyre të djathtë për aktivitetet në pjesën e djathtë të trupit të tyre. Kjo vërehet kur nxënësi e transferon shkumësin me ngjyrë në dorën tjetër që ta përfundojë të shkruarit në pjesën tjetër; si rezultat shkathtësia e plotë funksionale nuk mund të zhvillohet në asnjërën dorë (Chu, 2003).

### **2.5.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Nxënësit me probleme të kalimit të vijës së mesit dhe lateralizimit mund të kenë vështirësi me:

- Zgjedhjen e cilës dorë të përdorin gjatë një detyre - mund të bëjnë ndryshime të duarve;
- Mbajtjen e një pozite funksionale për detyrat në tavolinë - mund të lëvizin trupin e tyre që t'i shmangin të shkruarit, vizatimit përgjatë vijës së mesit; në raste më ekstreme ato mund të shkruajnë përmes trupit në një drejtim (vetëm drejtë), në vend që të shkruajnë nga e majta në të djathtë;
- Detyrat ku kërkohen të dy duart - si p.sh.: fiksimin e fletës kur shkruajnë;
- Vizatimin e njerëzve;
- Dorëshkrimin - vizatimin e vijave diagonale, ndryshimi i drejtimit gjatë shkrimit, shkrimi i shkronjave dhe numrave duke dëmtuar rrjedhshmërinë dhe duke i përmbysur shkronjat dhe numrat;
- Të shkruarit nga e majta në të djathtë duke e mbajtur trupin drejtë - mund të shkruajnë me trup të hedhur përpara ose të lëviz nëpër karrige kur shkruajnë një faqe, kështu që mund të bjerë nga karrigia;
- Detyrat praktike - si p.sh.: në mbajtjen dhe rrotullimin e letrës gjatë prerjes me gërshërë;
- Ndjekjen e lojrave që janë në një rrjet koordinues, apo të punojnë në hartë;
- Lojërat me top duke goditur përtej trupit;
- Përdorimin e thikës dhe pirunit.

### **2.5.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Nënvizohet faqen ku është pika filluese dhe përfundimtare e rreshtit, si p.sh.: një pikë të gjelbër në anën e majtë lartë dhe një pikë të kuqe djathtas lartë faqes;
- Përdorni shenja vizuale për të treguar se ku duhet të qëndrojë nxënësi për aktivitete, si p.sh.: në mes të tabelës kur vizaton ylberin;
- Ule nxënësin në pozicion “ulur anësh” (me gjunjët e përkulur dhe këmbët në një anë të trupit) dhe inkurajoje që të mbajë peshë përmes njërit krah, që nxënësi të përdor krahun tjetër përtej trupit;
- Kontrollon nxënësin a është ulur në karrige me lartësinë e duhur ku këmbët mbështeten mirë në dyshemenë, përdorni sipërfaqen e punës me kënd dhe poziciononi saktë fletën që të mos dominojë vetëm njëra dorë dhe fiksoje fletën që të rijë në faqen bazë;
- Vendosni pajisjet dhe lodrat në anën e kundër të trupit të dorës dominuese dhe inkurajoni nxënësin që të shtrij dhe të marrë diçka përtej trupit të tij me dorën dominuese.

### **2.5.5. Aktivitete për të përmirësuar kalimin e vijës së mesit dhe lateralizimin**

*Duhet ta keni parasysh se është tejet thelbësore që nxënësi t'i përdor sytë e tij, duart dhe këmbët në një varg të ndryshëm të lëvizjeve matanë trupit të tij pa mos e rrotulluar atë apo të ndryshojë dorën.*

- *Vizatoni ylber të madh mbi fletë në mur ose dysHEME duke u gjuhëzuar, në këtë pozicion vizato një hark rreth vetës, vizatoni forma të thjeshta në ajër ose në dërasë të zezë duke përdorur të dy duart së bashku;*
- *Lojëra me sy - ndiqni bashkërisht me nxënësit rrezet e dritës që lëshon pishtari, mermerët, topat, objektet e vogla, etj., duke e mbajtur trupin e qetë, por duke ndjekur me sy lëvizjet horizontale, vertikale dhe rrethore;*
- *Lojëra me top- klasifikojnë topat nga kutia në të majtë në atë në të djathtë (duke qenë ulur apo të gjuhëzuar), kalojnë topat përtej trupit apo hedhin (duke i marrë me dorën e majtë që t'i hedhin në kutinë në anën e djathtë), rrotullojnë apo lëkundin topin matanë trupit (duke i mbajtur shputat e këmbës në vend), kap topa të vegjël me letër në formë të konit (duke inkurajuar që të lëvizin përtej vijës së mesit);*
- *Loja me tullumbace/topa të vegjël: loja me tullumbace (e cila kërkon lëvizje të gjymtyrëve në anët djathtë/majtas), loja me topa të vegjël (rrëzimi i formave të ndryshme nga druri ose plastika);*
- *Rrokullisje/kërcime të topit rreth trupit duke i mbajtur këmbët të pa lëvizura;*
- *Lojërat me çekiç që kërkojnë të kalosh vijën mesore;*
- *Zvarritje të kryqëzuara dhe çdo aktivitet për gjimnastike të trurit;*
- *Lojëra të ndryshme komerciale në treg, siç është Twister (lojë me shumë lëvizje fizike të gjithë pjesëve të trupit).*

### 3. Hyrje në kontrollin motorikës delikate/fine



#### a. Çfarë është kontrolli i motorikës delikate/fine<sup>1</sup>?

Kontrolli i motorikës delikate/fine është aftësia për të kryer lëvizje të krahëve dhe duarve me rrjedhshmëri dhe saktësi, duke mos u varur vetëm nga kontrolli i trungut të trupit, shpatullave, krahëve dhe duarve, por edhe nga kontrolli motorik vizual, integrimi vizual motorik, perceptimi vizual dhe zhvillimit njohës (kognitiv). Fillimisht një fëmijë i vogël, do të bëjë lëvizje të mëdha dhe të pasakta përpara se t'i rafinojë ato për të arritur aftësi më të specializuara. “Për të kontrolluar lëvizje delikate, fëmijët duhet të jenë në gjendje të mbajnë disa pjesë të trupit të qëndrueshme (stabilizuara) kur i lëvizin të tjerat” (Levine, 1991). Për zhvillimin e aftësive manipuluese kërkohen të gjitha arritjet e sakta siç janë kapja dhe lëshimi i kontrolluar.

#### b. Pse është i rëndësishëm kontrolli i motorikës delikate/fine?

Kontrolli motorikës delikate lehtëson pjesëmarrjen dhe pavarësinë në të gjitha fushat e jetës së nxënësit përmes lojës, kujdesit për veten dhe të mësuarit.

#### c. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?

Fëmijët me probleme të kontrollit motorik delikat mund të kenë vështirësi me:

- Lojërat kërkimore;
- Prerje me gërshtë, vizatim, shkrim, dhe ngjyrosje (pasi përdorin lëvizjen e të gjithë krahut në vend të rritjes së kontrollit në nryjen e dorës dhe gishtërinjve);
- Mbajtjen dhe përdorimin e veglave, si p.sh.: gërshtët, lapsin, brushën për ngjyrosje, vizoren, kompasin;

---

<sup>1</sup> Fjala **fine**-rrjedh nga gjuha angleze, që do të thotë motorika e sipërme e trupit.

- Detyrat me lapsë dhe fletë, si p.sh.: gjatë ngjyrosjes, vizatimit, dhe dorëshkrimit;
- Përdorimin e mjeteve të shkrimit – kapje e vështirë të mjeteve punuese, manipulim i ngadalshëm, zvogëlim i shpejtësisë së prodhimit të punës;
- Vizatimin në sipërfaqe vertikale - të paaftë që të lëvizin dorën që të bëjnë lëvizje të lëmuara lartë/poshtë;
- Kalimin e faqeve të librit;
- Kujdesin për vete, si p.sh.: gjatë veshjes, përdorimit të takëmit për ushqim (lugë, pirun, thikë), larja e duarve, ose përdorimin e banjos (tualetit);
- Vetëbesimin - të vetëdijshëm për mungesën e aftësisë së tyre në krahasim me shokët/shoqet tjerë në klasë dhe kështu zgjedhin që të mos marrin pjesë në aktivitete;
- Frustrimin - dorëzohen lehtë, nuk marrin pjesë dhe prishin lojën/punën (Erhardt, 1993).

Brenda kësaj fushe, kontrolli motorikës delikate është ndarë në disa pjesë:

- Integrimi vizual motorik
- Shikimi dhe kontrollimi motorik i syve
- Shkathtësi manuale apo të duarve

### ***Referohu shtojcave***

- Sh. 1. Moshë dhe fazat e zhvillimit,

## **3.1. Integrimi vizual motorik**

### **3.1.1. Çfarë është integrimi vizual motorik?**

“Integrimi vizual motorik është shkalla në të cilën të perceptuarit vizual dhe lëvizjet gishta-dorë janë të koordinuara mirë” (Beery, 2004). Nxënësit e përkthejnë atë që shohin në lëvizje motorike. Ata me integrim të dobët vizual motorik e dinë se çfarë duan të bëjnë, por janë të paaftë të përfundojnë detyrën në mënyrë të kënaqshme sepse kanë vështirësi në prodhimin e lëvizjeve të sakta.

### **3.1.2. Pse është i rëndësishëm integrimi vizual motorik?**

Integrimi vizual motorik është një komponent thelbësor për zhvillimin dhe përsosjen e të gjithë shkathtësive praktike, që përfshijnë dorëshkrimin dhe vizatimin. Integrimi efikas vizual motorik është i nevojshëm edhe për kapjen e topit, qëndisjen me gjilpërë, ngjyrosjen brenda kufijve, për përdorimin e udhëzime vizuale për prerje ose shkrim mbi vijë. Është e rëndësishme që integrimi vizual motorik të zhvillohet në mënyrë adekuate dhe të vijë

automatikisht, që vëmendja të përqendrohet në përmbajtjen, jo vetëm në ekzekutimin e detyrës (Jenkinson, Hyde, & Ahmad, 2008).

### **3.1.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Nxënësit me probleme të integritimit vizual motorik, mund të kenë vështirësi me:

- Detyra ndërtuese, si p.sh.: ngjitje, bashkim të figurave të vogla, qëndisje, ndërtimin e maketave, etj.;
- Vetëkujdesin, si p.sh.: veshja dhe përdorimi i takëmit për ngrënie;
- Mbajtja dhe manipulimi me mjetet mësimore, si p.sh.: nënvizimi me vizore, prerja përgjatë vijës me gërshërë;
- Detyrat me laps dhe fletë, si p.sh.: ndjeke përmbi vijë, ngjyrosje brenda vijës, vizatimi, mësimi i formimit të shkronjave, dizajnet që kanë nevojë për ndryshime drejtimi;
- Prezantimin - ndarjen e fjalëve në rresht, të rinë në vija dhe të jenë gjithmonë të njëjtë me madhësinë e shkronjave;
- Kopjimin prej libri në fletë, ose nga dërrasa në fletë;
- Kryerjen e detyrave praktike;
- Kopjimin dhe riprodhimin e formave/dizajneve, veçanërisht kur përfshihen orientimi, vendosja hapsinore drejtimi;
- Aktivitetet fizike, si p.sh.: aftësi me topin, lojërat ekipore, punë me aparate (mjete);
- Motivimin gjatë detyrave me shkrim (Henderson & Pehoski, 1995).

### **3.1.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Ndaje detyrën në vrojtim/planifikim/ekzekutim;
- Përdor lëvizje të gjata për të përforcuar koncepte hapësinore, si p.sh. para pozicionet, drejtimet, dhe orientimet;
- Thjeshtëso aktivitetet vizuale motorike, në të Cilët kërkohet më pak saktësi;
- Mundëso më shumë kohë për përfundimin e detyrës;
- Mundëso sinjalizime dëgjimore, vizuale dhe me anë të prekjes për të ndihmuar në udhëzimin e lëvizjeve, si p.sh. rrite gjerësinë e vijës që duhet prerë dhe hapësirën që duhet ngjyrosur;
- Mundëso informata kthyes verbale kur e shihni se nxënësi lufton gjatë realizimit të një detyre;
- Jepi mundësinë që nxënësi të përqendrohet më tepër te përmbajtja e detyrës kreative, se sa te prezantimi;
- Konsidero metodat alternative të regjistrimit (Miller & Gilpin, 1994).

### **3.1.5. Aktivitete që të përmirësojnë integrimin vizual motorik**

- *Grisje/prerje/ngjitje/palosje* - aktivitete me letër;

- *Aktivitete të niveleve të ndryshme me gërshërë* - fillimisht duke bërë copa të vogla të mostrave, para prerjeve përgjatë vijave dhe rreth formave;
- *Aktivitete sipas modelit paraprak-* ngjyrosje, shabllone të gatshme;
- *Aktivitete në formë të labirintit-* në shkumë për rruajtje ose në rrërë përpara se të paraqiten në fletë;
- *Imitim dhe kopjim* të rreshtave, formave, shkronjave, numrave, duke përdorur materiale të ndryshme, si p.sh.: lojën me brumë, plastelinë, shkopinj;
- *Modele të të shkruarit* nga medime të ndryshme, përpara se të përdorni fleta me vija, identifikoni sa herë qëndron nxënësi mbrenda rreshtit, punë e vetëdijësimit për alfabetin;
- *Aktivitete për qëndisje me pe*, duke filluar me pajisje të mëdha dhe duke kaluar te ato më të voglat;
- *Aktivitet pikë-për-pikë*, modele kopjimi të vizatuara në rrjeta katrore ose rrethore, fjalëkryqe, plotësimin e modeleve simetrike dhe mozaike;
- *Përdorimin e pishtarit në dhomë të errësuar* - nxënësi ndjek vijat sipër skicës së derës, dritares, ose shablloneve të shkronjave të paraqitura në mur ose dërrasë;
- *Aktivitete nga lënda e arsimit fizik-* praktiko kapjen dhe hedhjen duke përdor shalle, tullumbace, topa, etj., lojëra me shënjestër; kërko nga nxënësi të shkojë në vendin e caktuar në sallë dhe të plotësoj një lëvizje me një renditje, duke ecur përgjatë një stoli të ngritur ose vijës/modelit në tokë (Hill & Hill, 2006).

## **3.2. Shikimi dhe kontrolli motorik i syve**

### **3.2.1. Çfarë është shikimi dhe kontrolli motorik i syve?**

Shikimi është akti ose fuqia e ndjeshmërisë me sy. Ai i referohet sistemit të përgjithshëm që na mundëson neve të shohim dhe të përjetojmë objekte dhe imazhe në hapësirë. Një pjesë e vogël e këtij sistemi është syri; pjesa tjetër përfshin të gjitha proceset komplekse neurologjike, të Cilët i shndërrojnë të gjitha impulset e dritës që arrijnë syrin në një imazh mendor kuptimplotë të botës në të cilën ndodhemi (Holland, 1995a). Për të arritur kontrollin vizual motorik, të gjashtë muskujt e secilit sy duhet të koordinohen në mënyrë efikase pa mundim për të marrë një imazh (fotografi) të vetëm të unifikuar dhe të qartë për transmetim përmes nervave optike deri të lëvorja/korteksi (cortex) vizual.



### **3.2.2. Pse është i rëndësishëm shikimi dhe kontrolli motorik i syve?**

Të gjitha përvojat e jetës na ndihmojnë të sigurojmë shikim dhe për arsye se shumica e njohurive tona për botën përreth nesh është fituar nga të pamurit, andaj funksionimi korrekt i këtij sistemi është vendimtarë edhe për funksionimin tonë. Lidhjet në mes sistemit motorik të syve (okular) dhe sistemeve të prekjes dhe propioceptive gjithashtu ofrojnë informata hapësinore të sakta që na bëjnë të mundur qëndrim korrekt dhe efikas të trupit dhe kontrollit motorik. Nxënësit duhet të jenë të aftë që:

- Të mos e lëvizin kokën kur i lëvizin sytë;
- Të mos i lëvizin sytë kur e lëvizin kokën;
- Të lëvizin edhe kokën edhe sytë në mënyrë të pavarur nga njëra tjetra, por në mënyrë të koordinuar duke qenë në qetësi ose lëvizje.

Një kontroll i mirë motorik i syve është një shenjë paralajmëruese për një zhvillim efikas të koordinimit sy-dorë. Nevoja për të përmirësuar ndjekjen vizuale dhe kontrollin vizual motorik shpesh neglizhohet për shkak se përpqemi në përmirësimin e aftësive tjera të motorikës së madhe dhe motorikës delikate, si dhe aftësive të perceptimit.

### **3.2.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Fëmijët me probleme motorike të syve mund të:

- Tregojnë stres vizual (dhimbje koke, lodhje të syve), shqetësim, shmangie të punës në afërsi. Ndonjëherë ndodh që fëmijët më të vegjël preferojnë të shmangin detyrën, në vend që të përjetojnë dhimbje koke dhe kjo si një simptomë shpesh nuk do të raportohet;
- Tregojnë lodhje, humbje të përqendrimit, apo shpërqendrohen kur punojnë, fëmijët e vegjël si zakonisht tregojnë edhe humbje të vetëdijes dhe sjelle shpërqendruese, të Cilët ndonjëherë edhe keqkuptohen se janë hiperaktiv;
- Mbajnë sytë gjysmë të mbyllura, i picërrojnë sytë ose i mbyllin, apo mbulojnë i kur janë duke punuar. Fëmijët e vegjël që duken shumë të ndjeshëm ndaj dritës së fortë, mund të vuajnë edhe nga probleme pamore të të dy syve dhe duhet gjithmonë të kontrollohen për këtë nga një optometrist;
- Kenë një qëndrim (pozitë trupore) jo normale kur lexojnë, shkruajnë, shpesh duke u zgjatur drejt fletës me një distancë shumë të afërt pune;
- Kenë vështirësi me mbajtjen e vendit/rreshtit ku lexojnë, përveçse kur përdorin ndonjë nënvizues. Fëmijët e vegjël do të dorëzohen menjëherë nëse mbajtja e vendit/rreshtit është një problem dhe mund të insistojnë në refuzimin e leximit, ose ndonjë pune tjetër që realizohet nga shumë afër;
- Hasin vështirësi me kopjimin nga libri në fletë, ose nga dërrasa e zezë në fletë;
- Kenë vështirësi kur vizatojnë - vështirësi me orientimin dhe ndarjen e figurave në fletë;
- Shfaqin edhe probleme të dorëshkrimit - ndarje të dobët të rreshtave, përdorim të parregullt të rreshtave, të humbin vendin ku ishin duke kopjuar, shpesh duke harruar edhe fjalë, ose duke shkruar lartë ose tatëpjetë fletës si dhe lodhen shpejtë;

- Tregojnë koordinim të dobët dhe baraspeshë në aktivitetet e arsimit fizik, në aktivitetet me top, ose në lojërat ekipore/kontrollim të papjekur me topin dhe tregohen të ngathët në ndjekjen e topit, rrëzohen ose ndeshen me gjërat përreth.

#### **3.2.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- *Pushimet vizuale janë thelbësore* dhe duhet që të planifikohen çdo pesë minutë për disa fëmijë që të zvogëlojnë lodhjen;
- Të zvogëlohet koha e kaluar në punë që realizohet nga shumë afër, planifikoni edhe punë praktike si ndryshim;
- Planifiko disa momente që t'i mbyllin dhe ti relaksojnë sytë, midis detyrave në klasë;
- Ndrysho aktivitetet nga dërrasa e zezë me detyra që kërkojnë më pak aktivitete vizuale;
- Mbaje dërrasën e pastër, vetëm me informatat e fundit, rretho ose thekso fjalët që duhet kopjuar nga nxënësit;
- Kufizoi pengesat anësore – konsidero punë nga kënde të vogla pune;
- Kontrolloni pozicionin e librit/fletës për të gjetur distancën optimale të punës (d.m.th. e cila është e barabartë me distancën nga bërryli deri në kyqin e dorës);
- Uli nxënësit përballë dërrasës së zezë për të eliminuar nevojën që ato të kthejnë trupin;
- Siguroni sa më shumë ndriçim natyral;
- Jep edhe fleta kopjimi të informatave që gjenden në dërrasë;
- Zmadhoni fletët punuese për të lehtësuar kërkesat për fokusim;
- Provoni të përdorni ndjekës për rreshtat ose ndonjë mjet tjetër që të ruajnë vendin në tekst;
- Përforconi punën nga e majta në të djathtë, nga lartë poshtë, dhe përdor margjinat (vijat kufizuese) të fletës si pikë referimi, përdorni vizore/udhëzues letre/stiker;
- Eksperimentoni me mbulesa me ngjyra të ndryshme për të minimizuar stresin vizual;
- Përdorni lodra të zhurmshme ose që ndriçojnë që të mbash vëmendjen vizuale dhe përqendrimin e nxënësve.

#### **3.2.5. Aktivitetet që rrisin ndjekjen vizuale dhe kontrollin motorik të syve**

*Fillimisht fillo me aktivitetet e motorikës së madhe duke qenë nxënësit e shtrirë poshtë, përpara se të kaloni në ulje me shpinë të mbështetur, pastaj kaloni në ulje pa shpina të mbështetura, më pas të qëndrojnë afër murit me shpinë dhe më në fund të mund të jenë të aftë të qëndrojnë midis një hapësire të madhe.*

- *Shikojnë lartë, poshtë, majtas, djathtas* vetëm me sy, ndërsa kokën nuk e lëvizin - mundësisht duke shikuar katër skajet e dhomës (dhjetë herë përpara fillimit të mësimt dhe kjo do të mundësojë stimulim të thjeshtë të ndjekjes me sy);
- *Të qëndrojnë poshtë ndër një top që rri varur* që nxënësi të mund të jetë në gjendje të kap topin dhe prekë atë. Topi duhet të jetë drejtpërdrejt mbi gjoksin e nxënësit kur është i pa lëvizshëm. Pastaj të mundohen të ndalojnë topin që lëkundet me një dorë dhe butësisht të godasin që të fillojë të lëviz, pastaj të kapin apo të godasin atë fortë me një

dorë. Kurse në fund të përdorin një shkop të vogël dhe të aftësohen të godasin me shkop topin pandërprerë;

- *Ndjekin lëvizjet e objekteve* (si p.sh.: fenerit, gjatë hedhjes së unazave të hekurta, litarëve ose gomave, po ashtu lëvizjet e veturave, tullumbaceve) qofshin horizontalisht, vertikalisht, apo në lëvizjet diagonale dhe në drejtime rrethore. Luajnë lojën ‘ndjekje’ me një fenerë dhe lëvizin dhe mundohen të ndjekin të gjithë gurët e mermertë të vendosur mbi një tabaka që të mos bien;
- Luajnë lojën ‘*lëkundje e topit*’ ku ushtrojnë të hedhin poshtë-lartë topin, të hedhin edhe thasë në fuçi rrotulluese, të hedhin apo kapin thasë/top apo edhe të ndalojnë topin që lëvizë poshtë/lartë;
- *Shënoni një sekuencë shkronjash, numrash ose figurash* të vendosura në rreshta horizontalisht nëpër faqe dhe kërkoni nga fëmija që t’ju hedh një sy nga e majta në të djathtë, rresht pas rreshti, duke lexuar ose rrethuar shkronja/numra/figura të caktuara;
- *Vizato numra sipas një renditje të rastësishme* mbi dërrasën e zezë/bardhë dhe kërkoni nga nxënësi që ti lidh ato me një vijë të pandërprerë, duke u përpjekur që ti shmangë lëvizjet me kokë;
- *Bëji që të lexojnë fjalët e para dhe të fundit* të çdo rreshti të faqes së tekstit, ose shkronjat e para të çdo fjale, që të zhvillojnë lëvizje të menjëhershme të dy syve për të lexuar;
- *Inkurajo kopjim të modeleve (shabllojeve)* duke përdorur forma gjithnjë e më komplekse për të zhvilluar aftësi analizuese vizuale, kërkime të fjalëve në fjalëkryqe, apo në lojërat të quajtura: tangrame;
- *Inkurajo vizualizimin*, si p.sh.: ëndërr ditore dhe pastaj të mundohen ta përshkruajnë ëndrrën me sa më shumë detaje shqisore që mundën.

### 3.3. Shkathtësitë manuale apo të duarve

#### 3.3.1. Çfarë është shkathtësia e duarve?

Shkathtësia e duarve është aftësia për të shfaqur lëvizje të ndërlikuara dhe të sakta të duarve me një rrjedhshmëri, saktësi, dhe shpejtësi, konform zhvillimit të moshës. Shkathtësitë më delikate të duarve zhvillohen sipas një shablloni të njohur zhvillimor. Aftësitë bazike të nevojshme për veprime më të pjekura të duarve konsiderohen të arrin zhvillimin e tyre në kohën kur nxënësi hyn në shkollë (Erhardt, 1993).

Aftësitë e duarve zhvillohen si më poshtë dhe atë një pas një:

- Izolimi i gishtit tregues për të theksuar;
- Pickim apo shtrëngim i vogël;
- Shtrëngim tregishtash;
- Balancim i kundërt i dy anëve të dorës- fiksime me gishtin e unazës dhe atë të vogël, ndërsa aftësohen që ta lëvizin gishtin e madh të dorës atë tregues dhe të mesit;

- Manipulimi brenda në dorë- të lëvizim objekte përbrenda dorës.

### **3.3.2. Pse është e rëndësishme?**

Pjekuria e funksionimit efikas të duarve varret nga lëvizjet e sakta, të përpikta dhe të rrjedhshme të duarve. Kjo do t'i mundësojë nxënësit që të mësojë aftësi të reja dhe të zbatoj detyra në mënyrë efikase pa mos u munduar shumë.

### **3.3.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Fëmijët me probleme të shkathtësive të duarve mund të kenë vështirësi me:

- Detyrat ndërtuese që kërkojnë ngjitje si p.sh.: loja me tullat e ndërtimit ose maketave dhe bërja e brumërave;
- Mbylljen e kopsave, zinxhirëve, lidhëse ose përdorimin e thikës, pirunit, si dhe hapjen e kutive për ushqim dhe në përdorimin e shishes që nxjerr sapun;
- Shtrëngimin, lëshimin, pickimin dhe manipulimin e objekteve me gishtërinjtë;
- Kthimin e objekteve me një dorë me gishta, si p.sh.: përdorimin e dy duarve kur duhet të rrotullojnë lapsin për të gdhendur;
- Kapje (shtrëngime) - në mënyrë të vazhdueshme ndryshojnë pozicionin e lapsit, mbajtje e vështirë e gërshërëve;
- Në detyrat me laps dhe fletë - ngjyrosje, vizatim, ndjekje të shablloneve, apo edhe në të zhvilluarit e kontrollit të lapsit kur duhet të formojnë shkronjat me një mjeshtëri, rrjedhshmëri dhe shpejtësi;
- Manipulimin e objekteve - përdorin shtrëngimin e gjithë dorës, madje në disa raste përdorin edhe të dy duart, në vend që të përdorin lëvizje dhe shtrëngim vetëm të gishtërinjve;
- Mbajtjen e pajisjeve praktike- erashkën me numra, hallkat plastika (për lojë), pajisjet fonetike, miun e kompjuterit, vizoren, kompasin dhe vizoret tjera në formë katrore;
- Detyra delikate motorike që kërkojnë shumë saktësi dhe përpikëri, detyrimet (obligimet) në qytet dhe eksperimente shkencore dhe në detyra nga arti dhe artizanale;
- Manipulimin brenda në dorë - ngritjen e disa enëve një nga një brenda një kohe dhe mbajtjen e tyre në të njëjtën dorë më gjatë.

### **3.3.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Mundësoi nxënësit që të shkruajë në dërrasën e zezë, fleta me rreshta të gjatë, etj.;
- Mundësoi nxënësit të përdor pozicione të ndryshme gjatë të shkruarit (si p.sh.: duke qëndruar mbi stomak apo mbështetur mbi bërryla);
- Kujdesi për veten – përshtatja e disa veshje të fëmijëve me ngjitëse, gjithashtu veshja e pantallonave elastike, fanella me krahë më të shkurt, kravatë me shirit elastik, apo të përdorin lugë, pirun dhe thikë me vende më të mëdha për t'i mbajtur;


- Ki parasysh edhe përdorimin e gërshërëve, vizoreve me vende më të mëdha për t'i kapur dhe mbajtur në duar;
- Përmirëso qëndrueshmërinë deri sa janë duke punuar ndonjë detyrë, duke përdorur qilima jo rrëshqitës, shirita magnetik mbi vegla dhe ngjitëse tjera që të mbajnë fletën;
- Siguro përdorimin e lapsave dhe stilolapsave që kërkojnë më pak mundim, si p.sh.: stilolapsat me mbushje, me zhele, ose lapsa të butë si dhe mjete tjera për shkuarje;
- Mundëso pjesë që fokusohen veçmas për mbajtjen e lapsit, mundësoju kohë shtese edhe për detyrat me shkrim dhe leximin të qartë;
- Mundëso përkrahje të ndonjë më të rrituri ose shoku kur detyra fillon të bëhet frustruese;
- Modifiko detyrat, përshtate punën.

### **3.3.5. Aktivitetet që të përmirësojnë shkathtësinë e duarve**

Aktivitetet duhet të vlerësohen (klasifikohen) në atë mënyrë që të reflektojnë aftësitë zhvilluese të nxënësit. Fillo me objekte të mëdha që kërkojnë pak shtytje, shtypje ose shtrëngim dhe pastaj gradualisht zvogëlo madhësinë e objekteve dhe e rrite rezistencën për të fituar fuqi (Addy, 2006). Këto aktivitete të mëposhtme mund të realizohen ose në bazë individuale ose grupore:

- Vazhdo me aktivitetet që zakonisht kanë për qëllim konsolidimin dhe përforcimin e zhvillimit motorikës delikate;
- Lojëra që zhvillojnë të veshurit: vish lodra ose rregullo tabela ose skena ku kërkohet të mbërthesh (shtrëngosh) ose fiksosh, si dhe lidhësh;
- Lodra ndëruese dhe lojëra tjera që kërkojnë fuqi dhe shkathtësi;
- Projekte të artit dhe artizanale, që përfshijn; grisje, të bërrit lëmsh, të tërheqin, të shpojnë, të shtyjnë, si dhe të qëndisin me pe mbi materiale të ndryshme;
- Bërja e formave të ndryshme me brumëra, plastelina, balt apo argjil si p.sh.: i shtrëngojnë, i formësojnë, i rrotullojnë, i fusin nëpër shablone, duke përdorur gishtërinjtë apo vegla të drurit;
- Bërja e maketave dhe palosje të fletëve;
- Ushtrime prerje me gërshërë;
- Ushtrimi i mbajtjes së mjeteve mësimore si p.sh.: vizore, kompas, këndmatës, nëpërmjet projekteve artistike dhe lojërave;
- Aktivitete me kapje të objekteve të vogla: fillojmë me gishtin e madh dhe gishtin tregues duke i mbajtur objektet, pastaj vazhdojmë me gishtërinjtë tjerë të dorës, duke vazhduar të mbledhin sa më shumë objekte. Shohim sa objekte mund të mbajnë në dorë. Pastaj i vendosin ato në një enë një nga një.

## 4. Hyrje mbi të perceptuarit



Secila prej shqisave tona na hap një aspekt të ndryshëm të botës për ne. Aftësitë që zhvillohen përmes përdorimit efikas të shqisave tona quhen aftësi perceptuese. Këto bëhen edhe shtyllat tona për një zhvillim të shëndoshë dhe themeli për aftësitë njohëse (kognitive) dhe të gjykimit (arsyetimit).

### a. Perceptimi vizual

Aftësitë vizuale perceptuese zhvillohen që nga javët e para të jetës së nxënësit, deri në adoleshencë, kohë në të cilën gama e plotë e aftësive bazë duhet të konsolidohet. Modelet normale të rritjes zhvillimore të fëmijërisë së hershme vendosin konceptet thelbësore përmes përvojave të boshteve (kahjeve) horizontale dhe vertikale, thellësisë, shpejtësisë dhe gjykime të drejtimit, si në qetësi ashtu edhe në lëvizje. Mbi këtë bazë, zhvillohen aftësitë në perceptimin dydimensionale (2D) dhe tredimensionale (3D). Aftësitë dydimensionale mund të vlerësohen formalisht në kategori siç janë: diskriminimi vizual, memoria vizuale, lidhjet vizuale hapësinore, pandryshueshmëria vizuale për formën, diskriminimi vizual për figurën nga mjedisi dhe mbyllja vizuale. Perceptimi tredimensional gjithashtu mund të vlerësohet formalisht nga detyrat të tilla si ndërtimi i blloqeve, por vështirësitë mund të vërehen në aftësitë funksionale si siguria në rrugë (kalimi i rrugës me kujdes), lëvizja pa probleme në një mjedis të ngarkuar, ose paketimi i sendeve të ndryshme në një çantë shkollore (Jenkinson, Hyde, & Ahmad, 2008).

### b. Perceptimi i prekjes

Është shumë e lehtë të nënvlerësohet rëndësia e sistemit tonë të prekjes dhe problemet që mund ti shkaktojnë perceptimet joadekuate ose të shtrembëruara. Stimujt e jashtë siç janë: nxehtësia ose të ftohtit, presioni i lehtë ose i rëndë, tekstura dhe dhimbja duhet të klasifikohen dhe të përvetësohen. Mbi këtë bazë, zhvillohet diskriminimi (dallimi) i formës, madhësisë, peshës dhe dendësisë. Kur nxënësi fillon të kërkojë informacione me anë të prekjes, frenimi i

stimulimit të padëshiruar ndijor duhet gjithashtu të ndodhë nëse nuk duam që nxënësi të hutohet dhe shpërqëndrohet nga mbingarkesa shqisore. Si për shembull, vetëdija prekëse e veshjes gjatë veshjes i lejon atij që t'i vesh teshat në mënyrë të rehatshme, por frenimi (moslejimi) ndijor më pas i lejon atij të vazhdojë me aktivitete tjera i pa u shpërqëndruar nga ana e zgjimit ndijor prej veshjeve të tij.

*Proprioceptimi* është një zonë shtesë dhe e ndërlidhur e perceptimit të prekjes, e cila lidhet me vetëdijen e trupit në hapësirë. Informatat merren nga muskujt, ligamentet, nyjet, tërheqje gravitacionale dhe receptorët e baraspeshës. Aftësitë vestibulare lidhen në mënyrë specifike me mekanizmat e qëndrimit tonë trupor dhe baraspeshës. Vetëdija jonë e trupit në lëvizje është ndjehet jonë kinestetike dhe përsëritja e lëvizjeve të planifikuara krijon memorien tonë motorike. Aktiviteti vizual motorik duhet të integrohet në ekuilibrin e qëndrimit tonë trupor dhe rrjedhshmërinë e lëvizjeve.

Stabiliteti dhe kontrolli që kemi mbi qëndrimin dhe lëvizjen e trupit, si dhe kontrolli që ne jemi në gjendje ta praktikojmë për tu përshtatur mjedisit ku jetojmë, kanë një rëndësi të madhe në aftësinë tonë për të mësuar.

### **c. Perceptimi dëgjimor**

Ashtu si me shqisat e tjera, një gamë e gjerë aftësish thelbësore zhvillohen përmes integritimit efikas të stimulimit dëgjimor. Aftësitë për figurë nga mjedisi na mundësojnë të dëgjojmë një tingull/zë të caktuar nga zhurma në sfond. Memoria afatshkurte dhe afatgjate është thelbësore për të mësuarit. Tingujt, ritmet, dhe intonacioni duhet të dallohen, kurse distanca dhe drejtimi duhet të interpretohen. Renditja e saktë gjithashtu mbështet komunikimin efektiv (Jenkinson, Hyde, & Ahmad, 2002).

### **d. Si të menaxhojmë kur kemi mungesë të perceptimit?**

Përfitimi i një vlerësimi të mirë të zhvillimit të perceptimit është se ai mundëson identifikimin e zonave specifike të vështirësisë në mënyrë që terapia ose programet edukativo-arsimore të mund të vendosin objektivat e tyre më saktësisht.

Meqenëse aftësitë perceptuese vizuale arrijnë kulmin e tyre gjatë periudhës së pubertetit, rehabilitimi është më efektiv gjatë viteve të shkollimit fillor. Mësimdhënia duhet të bëhet përmes qasjes shumëshqisore, me anë të së cilës nxënësit inkurajohen të shprehin në mënyrë verbale (gojore) atë çka e bëjnë, të shikojnë me kujdes gjatë kryerjes së detyrës dhe të përpiqen të ndiejnë se çfarë po bën trupi i tyre. Kjo jep mundësi për reagime dëgjimore, vizuale, të prekjes, kinestetike, të Cilët nga ana e tyre përforcojnë performancën më efikase.

Brenda kësaj pjese, perceptimi vizual është ndarë në disa pjesë:

- Diskriminimi (dallimi) vizual
- Lidhja vizuale hapësinore
- Pandryshueshmëria vizuale për formën
- Diskriminimin vizual për figurë nga mjedisi
- Mbylla vizuale
- Memoria vizuale

## ***Referohu Shtojcës***

- Sh. 1. Mosha dhe fazat e zhvillimit,

### **4.1. Diskriminimi vizual**

#### **4.1.1. Çfarë është diskriminimi (dallimi) vizual?**

Diskriminimi vizual është aftësia për të identifikuar ngjashmëritë ose dallimet e një forme ose objekti të caktuar. Është aftësia e parë perceptuese që zhvillohet dhe si rrjedhojë e zhvillimit, fëmijët fillojnë të lidhin dhe klasifikojnë objektet sipas madhësisë, formës, ngjyrës, pozicionit, numrit dhe detajeve.

#### **4.1.2. Pse është i rëndësishëm diskriminimi vizual?**

Fëmijëve ju nevojitet kjo aftësi sepse ju mundëson një bazë për zhvillimin e të gjitha perceptimeve vizuale. Pa këtë aftësi nxënësit nuk janë në gjendje të identifikojnë objektet sipas karakteristikave të tyre dhe për këtë arsye nuk mund të bëjnë interpretime të informacioneve vizuale në mënyrë të shpejt, saktë dhe të rafinuar. Ata mund në vazhdimësi të kenë vështirësi në njohjen e numrave dhe shkronjave, të Cilët pastaj mund të ndikojnë në aftësinë e tyre për të lexuar dhe shkruar, sepse elementi kryesor i diskriminimit vizual është aftësia për të regjistruar ndryshimin.

#### **4.1.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Fëmijët me probleme të diskriminimit vizual, mund të kenë vështirësi me:

- Ndarjen dhe klasifikimin e lodrave, objekteve;
- Njohjen e variacioneve në madhësinë e lodrave, pjesëve të enigmës, objekteve;
- Gjetjen e objekteve të ngjashme, pavarësisht nga madhësia;
- Dallimin e ngjashmërive/ndryshimeve;
- Përfundimin e detyrave praktike, si p.sh.: në lojën e bashkimit të figurave të vogla (puzzles), ngulitjen e lodrave ose me lodrat ndërtuese;
- Përputhja ose njohja dallimeve në numra, shkronja, forma, fjalë ose objekte;
- Shkrimi mund të ketë përmbysje ose të ketë ndryshim vendesh kur nxënësi shkruan numra ose shkronja (duke kaluar moshën e fëmijës kur kjo gjë është normale);
- Përdorimin e shkronjave të mëdha në mënyrë të duhur;



- Përqendrimin, shpesh shfaqet i pavëmendshëm dhe i çorganizuar;
- Veshjen për aktivitetet në lëndën e arsimit fizik, ata mund të jenë më të ngadaltë se bashkëmoshatarët e tyre.

#### **4.1.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Mësojuni strategji për të mësuar orientimin e shkronjave, përmes qasjeve fonetike të mësojnë shkrim-leximin, drejtshkrimin e shkronjave dhe alfabetin;
- Shtyp mbi shkronjat duke përdorur shenja të drejtimit kur bën sqarimin e shkronjave;
- Përdor shenja (sinjalizime) vizuale, si p.sh.: duke bërë me duar formën e shkronjave: b, d, l, etj.;
- Inkurajoni verbalizimin gjatë kryerjes së detyrave;
- Siguroni fleta pune të qarta dhe koncize;
- Sigurohuni se ekzistojnë shembuj konkret kur kërkohen sqarime shtesë (Chu, 1999).

#### **4.1.5. Aktivitete për të përmirësuar diskriminimin vizual**

- *Loja që nuk ka palë*- nëpërmjet kësaj loje gjejnë dallimet;
- *Aktivitete për gjetje dhe klasifikim* - kështu mësojnë kategorizimin e sendeve që janë komplet, me ngjyra të ndryshme dhe forma;
- *Gjetjen e formave* - në dhomë ose fotografi- kështu kapin të gjithë objektet katrore, rrethore dhe në formë të drejtkëndëshit;
- *Lojëra me ngjijtje* - lodra ndërtimore, etj.;
- *Bërjen e formave* - me tela që janë tufa–tufa, shkop, kashta, identifikimin e formave që vizatohen mbi shpinën e fëmijëve dhe pastaj kopjimin e tyre në fletë;
- *Loja me objekte të njohura* - kërko nga nxënësit që të tregojnë me gisht objektet që mund të hahen, objektet që përdoren për pastrimin e shtëpisë, që përdoren në kopsht, etj., bëjnë një lojë të ngjashme si hetuese për ide të ngjashme;
- *Lojërat që ndjehen* - dallojnë format, objektet, lodrat duke i ndjerë me sytë e mbyllur dhe të përshkruajnë ato në detaje (a janë rrethore, katrore, të gjata, shkurta, të rënda, të buta, të holla, të trasha, të mëdha, të vogla, lartë, a janë në mes, anash, etj.);
- *Gjetjen e shkronjës së njëjtë apo formës* - duke rrethuar shkronjën/fjalën e caktuar që mbaron me (a, e, i, u) në tregime; përdor gazeta dhe kështu nxënësit rrethojnë ose nënvizojnë të gjitha shkronjat ‘t’ ose shkronjat tjera të caktuara, gjejnë ndonjë fjalë të caktuar si ‘dhe’, fjalën e parë në çdo fjali, ose të fundit në çdo fjali, si dhe shkronjat dyshe në fjalë të ndryshme;
- *Aktivitete duke përdorur format* - të ngjyrosura mbi dysheme, ose fushën e lojës, - duke lëvizur (vrapuar, ecur, apo kërcyer) brenda dhe jashtë formave të emërtuara (Levine, 1991).

## **4.2. Marrëdhëniet vizuale hapësinore**

### **4.2.1. Çfarë është marrëdhënia vizuale hapësinore?**

Perceptimi vizual hapësinor na pajis me informata për mjedisin dhe marrëdhënien e trupit tonë me hapësirën e jashtme. Fillon me njohjen e koncepteve hapësinore dhe ku është një objekt në raport me veten. Pastaj fëmijët më vonë do të kuptojnë lidhjet e dy ose më shumë objekteve me vetveten e tyre ose me njëra tjetrën. Kjo do të përfshijë nëse një objekt është mbi një tjetër ose nën, para, ose pas, poshtë ose lartë, brenda ose jashtë, etj. “Vizioni duhet të kombinohet me interpretimin e mjedisit fizik për të fituar kuptim nga ajo që e shohim” (Chu, 1999). Gjatë viteve të para të jetës, ashtu si mëson fëmija të ulet, zvarritet, qëndroj dhe ecë, ashtu zhvillon edhe një vetëdije për rrafshet vertikale, horizontale dhe diagonale, e cila formon bazat për gjykimin dhe vlerësimin e madhësisë, distancës dhe drejtimit midis objekteve dhe vetëvetes.

### **4.2.2. Pse është e rëndësishme marrëdhënia vizuale hapësinore?**

Disa fëmijë përjetojnë vështirësi në vlerësimin dhe përpunimin e informacionit hapësinor nga mjedisi i tyre, i cili mund të ketë ndikim mbi aftësitë e tyre të motorikës së madhe dhe performancën në klasë. Kur hynë në shkollë, nxënësi mund të ndeshet me njerëz apo orendi, shpesh duke e hasur si të vështirë gjetjen e një vendi të përshtatshëm për ulje. Në vitet e mëvonshme mund të ketë probleme me përvetësimin e gjykimeve për hapësire dhe interpretimin e tyre.

### **4.2.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Fëmijët që kanë probleme me lidhjet vizuale hapësinore mund të përjetojnë vështirësi:

- Të dinë se ku gjendet trupi i tyre në hapësirë, shpesh godasin mbi gjërat pa ndonjë arsye të veçantë;
- Të lëvizin rreth e rrotull klasës apo fushës sportive pa mos u penguar me gjërat, njerëzit, vështirësi me ngjitjen e shkallëve;
- Vetëdije për hapësirën e tyre personale, që shtynë në probleme me rreshtimin e tyre ose uljen poshtë mbi qilim;
- Në aktivitetet nga arsimit fizik, të ngasin biçikletë, të shtynë trotinetin, apo gjatë kalimit të rrugës;
- Të vishen - i veshin teshat mbrapsht;
- Të mësojnë anët majtas/djathtas, poshtë/lartë, apo rrafshin vertikal/horizontal;
- Në dorëshkrim në krahasim me shokët tjerë - orientimin (koordinimin) e shkronjave, numrave, madhësitë, ndarjen e shkronjave në rreshta, vendosjen e tyre mbi vijë, etj.;

- Radhitjen e punës në fletë, zhvillimin e aftësive më të avancuara për vizatim, kopjimin e fotografive, vizatimin e diagrameve, si dhe me ndjekjen dhe rruajtjen e vendit ku punojnë në fletë, dërrasë, ose libër. Gjithashtu kopjimin nga rrafshi vertikal në atë horizontal;
- Të lozin me loja të konstruksionit (ndërtimit), ndërtimin e maketave, shablloneve tredimensionale, duke përdorur si shembuj përsëri shabllone tredimensionale, si dhe ndërtimin e maketave apo shablloneve tredimensionale duke përdorur si shembuj forma dydimensionale. Vizatimin e diagramit prej një mostre tredimensionale, në atë dydimensionale etj.;
- Klasifikimin dhe organizimin e objekteve personale dhe mbajtjen përbrenda kufijve personal.

#### **4.2.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Përdor lëvizje të mëdha për të përforcuar vetëdije trupore dhe konceptet hapësinore, si p.sh. pjesët e trupit, para pozicionet, drejtimet dhe orientimet;
- Inkurajo fëmijët që t'i përjetojnë vetë lëvizjet përpara se të përparojnë në zhvillimin dhe të kuptuarit e pozicionit, hapësirës, dhe vendosjes së objekteve;
- Puno me objekte 3D-3D përpara se të provoni 2D-3D;
- Bëj ndjekje (përcjellje) të labirintit ose fletëve punuese me gisht, përpara përdorimit të mjeteve për shkrim;
- Përdor vija të ngjyrosura dhe sinjalizime vizuale për të qartësuar madhësitë, format, pozicionin dhe vendosjen e shkronjave mbi rreshta;
- Vendos pika të gjelbra lartë faqes në anën e majtë, për të treguar margjinat dhe ku të fillojnë, kurse vendos pika të kuqe në anën e djathtë të faqes për të treguar ku të ndalojnë.

#### **4.2.5. Aktivitetet që të ndihmojnë lidhjet vizuale hapësinore**

- *Përdorimi i pajisjeve për lojëra jashtë*, loja me kërcim, apo ajo e shtigjeve me pengesa në/ndër/ jashtë/ përmes/ përreth/, si dhe loja e ecjes mbi gurë, aktivitete me rrethe plastike për të kërcyer brenda/jashtë, pastaj përdorimin e qilimave katrorë ose përsëri këtyre rretheve për të lëvizur përreth, etj.;
- *Aftësitë me top* – gjuajtje dhe kapje, lojërat me shigjetë, apo gjuajtjen e topit në gol, hedhjen e qeseve me fasule në kuti të lartësi të ndryshme dhe loja me tullumbace;
- *Lojërat me sy mbyllur* - ku ndjekin instruksione verbale–ecin para, ndalojnë, kërcëjnë djathtas, ndalojnë, kërcëjnë majtas, ndalojnë, kërcëjnë pas;
- *Aktivitete me orientim*- interpretojnë referenca që janë në një rrjet koordinues, leximin e hartës ose planit;
- *Loja ndërtuese* – bëjnë maketa duke u bazuar në objekt apo figura tjera (3D-3D) dhe (2D-3D);
- *Aktivitete me libër*- ngjyrosje, gjetje e rrugëve (drejtimeve) të sakta nëpër labirinte, lojën pikë-për pike, përfundojnë vizatimin, gjejnë dallimet, si dhe kopjojnë një vizatim;

- *Aktivitete shumë-shqisore* – aktivitet para përgatitore për shkrim: ngjyrosje me shkumë për ruajtje, rërë, si dhe miell misri;
- *Aktivitete artizanale*- prerje, ngitje, palosje të fletëve, qëndisje me pe, thurje, dhe qepje.

### **4.3. Pandryshueshmëria vizuale për formën**

#### **4.3.1. Çfarë është pandryshueshmëria vizuale për formën?**

Pandryshueshmëria vizuale për formën është aftësia për të dalluar se forma ose objekti ngelët i njëjtë, pavarësisht ndryshimeve në madhësi, pozitë, drejtim, orientim dhe distance, si p.sh.; një objekt është përsëri i njëjtë edhe nëse shihet nga lartë, anash, ose poshtë.

Memoria vizuale, aftësi vizuale për figure nga mjedisi, si dhe aftësitë tjera dalluese mund të kontribuojnë në vendosjen e pandryshueshmërisë për formën. Kjo zhvillohet edhe nga vitet e hershme, kurse piqet dhe përmirësohet në format më komplekse në bashkëpunim me mbylljen vizuale, si p.sh. zhvillimi kompleks dhe i vazhdueshëm prej formave dydimensionale në ato tredimensionale. Konsiderohet se ekziston një lidhje të forte në mes pandryshueshmërisë vizuale për formën dhe diferencimit vizual për figure nga mjedisi, prandaj është e këshillueshme që të punohet në dy fushat në të njëjtën kohë. Pandryshueshmëria vizuale për formën zhvillohet gjatë moshës shtatëvjeçare dhe bëhet relativisht më e pjekur gjatë moshës njëmbëdhjetë vjeçare (Chu, 1999).

#### **4.3.2. Pse është e rëndësishme pandryshueshmëria vizuale për formën?**

Ajo i mundëson nxënësit që të sqarojë apo interpretojë mjedisin në mënyrë të vazhdueshme dhe të saktë, pavarësisht shfaqjes së ndryshimeve. Kur bëhet fjalë për pandryshueshmërinë e formës, nxënësi dallon se të dy format, edhe ato dydimensionale dhe tredimensionale i takojnë një kategorie të caktuar formash, pavarësisht madhësisë së tyre, teksturës, ngjyrës, mjeteve të paraqitjes, ose këndit nga i cili shihen, si p.sh.: kubi është kub nga cila anë të shihet.

#### **4.3.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Fëmijët me probleme për pandryshueshmërinë e formës, mund të përjetojnë vështirësi me:

- Zbatimin e aktiviteteve ditore për moshën e tyre përkatëse, si p.sh.: veshjen;
- Lojërat imagjinare dhe në role, kalimin e rrugës, ngasjen e biçikletës apo trotinetit, përdorimin e pajisjeve të këndit të lojrave aventureske;

- Dallimin dhe përputhjen e objekteve, formave dhe materialeve kur orientimi dhe madhësia ndryshon;
- Dallimin e karakteristikave të formave dhe të jenë në gjendje të përgjithësojë;
- Në përvetësimin e të vizatuarit të hershëm dhe aftësive për të shkruar, përdorimin e shkronjave të vogla dhe të mëdha dhe bërjen e ndryshimeve dhe orientimin e shkronjave saktë;
- Leximin e materialit të shkruar me fonte (madhësi të ndryshme të shkronjave) si p.sh. *Italic* etj
- Ndryshimin e stilit të shkronjave prej atyre të shtypit në ato të shkrimit;
- Kopjimin nga libri ose dërrasa që janë në rrafshin vertikal në fletë që është e drejtuar horizontalisht;
- Me vlerësimin e lartësisë, gjerësisë, thellësisë, madhësisë, distancës, drejtimit të një objekti dhe në detyrat tjera që kërkojnë vlerësim;
- Me lëndët praktike dhe konceptet zhvilluese, si p.sh.: matematikë, shkencë, dizajn, teknologjia, art, puna tematike dhe arsimit fizik.

#### **4.3.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Përdor gjuhë të përshtatshme për të përshkruar orientimin dhe pozitën e një objekti ose objekteve;
- Tregoju në mënyrë verbale dhe shpjego vetitë dhe orientimin e objekteve për t'i ndihmuar nxënësit të formojë koncept;
- Demonstrato se si materiali i paraqitur horizontalisht duket kur paraqitet vertikalisht;
- Shko përmbi shkronjat edhe njëherë në pëllëmbën e dorës ose mbi tavolinë;
- Praktikoni bashkërisht shkronjat e mëdha dhe të vogla në lidhje me pozicionim e tyre mbi vijë, si p.sh.: 'J' dhe 'j';
- Ndaje detyrën në hapa praktikë, duke eksploruar fizikisht vetitë e një objekti, si p.sh.: tavoline, kuti (Levine, 1991).

#### **4.3.5. Aktivitete për të përmirësuar pandryshueshmërinë vizuale për formën**

- *Aktivitete praktike*, si p.sh.: Dallimin e objekteve për nga forma, madhësia, tekstura, ngjyra, kategoria ose drejtimi (horizontal, vertikal, i pjerrët në një kënd), mësoju: i njëjtë/ndryshëm, të bëjnë dallimin ndërmjet objekteve, shkronjave të mëdha dhe të vogla dhe formave me dallime të dukshme, duke prezantuar në formë graduale edhe dallimet e tyre më të vogla;
- *Identifikimin e objekteve* të ndryshme në dhomë, të cilët janë të formës së caktuar, si p.sh. çdo gjë që është katrorë;
- *Tregoju fëmijëve një objekt* (kamion, tullë, arushë) dhe bëji që ta qëllonjë çfarë është ajo duke e parë vetëm nga ana e pasme, ose e përparme, apo anash ose nga pjesa e poshtme. Të rradhisin objektet sipas madhësisë, si p.sh. nga më i madhi deri tek më i vogli;

- *Aktivitete me ngjitje, qëndisje me pe*, si p.sh. Ngjitja e pjesëve të vogla enigmatike, krijime të maketave të mëdha, duke hetuar forma në drejtime të ndryshme dhe madhësi;
- *Lidhë objekte 2D që janë në karton me objekte 3D nga kutia, dhe kështu krijojnë maketa (apo shabllone) prej fotografive ose diagrameve 2D në ato 3D;*
- *Lojëra me veshje tek të Cilët nxënësi duhet të identifikojë veshmbathjen kur pamja e saj ndryshon, si p.sh.: një këpucë me kokë posht, një helmetë;*
- *Shtigje me pengesa* duke përdorur formën e njëjtë në madhësi të ndryshme, ose drejtime dhe si rrjedhojë ky aktivitet do t'u ndihmojë fëmijëve të kuptojnë lartësinë, distancën;
- *Aktivitete arti dhe artizanale*, krijojnë/mbivendosin forma në drejtime të ndryshme- si forma të prerjes të patateve, prerje të linoleumit, gishtërinjtë e ngjyrosur, shkumën për ruajtje, tubat me tel fije-fije, forma e brumërave, kashtë. Pastaj preni formën e njëjtë, mirëpo në madhësi të ndryshme dhe përdori për kolazh;
- *Ushtrime ndjekjen e pikave*, vizatimin dhe ngjyrosjen e formave të ndryshme në drejtime të ndryshme, gjej forma gjeometrike që janë të kthyera mbrapsht ose të rrotulluara dhe lidhi;
- *Shkruaje shkronjën e njëjtë ose fjalë*, mirëpo në disa stile (fonte) të ndryshme, ngjyra, dhe madhësi. Inkurajo fëmijët që të nënvizojnë fjalën e njëjtë, mirëpo të paraqitur në fonte të ndryshme.

## **4.4. Diskriminimi vizual për figurën nga mjedisi**

### **4.4.1. Çfarë është diskriminimi vizual për figurën nga mjedisi?**

Diskriminimi vizual për figurë nga mjedisi është aftësia për të identifikuar dhe dalluar një objekt ose një informatë në lidhje me objektin nga mjedisi që përfshin informata jo të përshtatshme dhe shqetësuese. Fëmijët duhet të jenë në gjendje të përfytyrojnë përpara se të shikojnë dhe kjo shkathtësi e tyre varret nga aftësia e tyre për të krijuar koncept. Ka një lidhje të fortë në mes pandryshueshmërisë vizuale për formë dhe diferencimit vizual për figurë nga mjedisi, prandaj është e këshillueshme që të punohet në të dy fushat në të njëjtën kohë. Fëmijët duke nisur që nga mosha tetë vjeçare deri trembëdhjetë vjeçare përvetësojnë një përsosje të dukshme për aftësinë vizuale për figurë nga mjedisi (Chu, 1999).

### **4.4.2. Pse është i rëndësishëm diskriminimi vizual për figurën nga mjedisi?**

Fëmijët duhet të jenë në gjendje të diskriminojnë objektet nga jeta e përditshme. Kur është në shkollë, nxënësi mund të jetë i paafte që të gjejë gjërat, shoh sende nëpër fotografi, apo të sillet vërdallë dhomës pa mos shkelur mbi sende të ndryshme. Ato mund shpesh të duken edhe të çorganizuar dhe të hutuar. Trajnimi në këtë fushë duhet t'u ndihmojë fëmijëve që ta

ndryshojnë vëmendjen në mënyrë të përshtatshme, duke u përqendruar në stimuj të duhur dhe duke i injoruar stimujt e papërshtatshëm, që të jenë më hetues ndaj sendeve dhe ngjarjeve dhe të kenë një sjellje më të organizuar.

#### **4.4.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Fëmijët me probleme në diskriminimin e figurave që janë në mjedis mund të kenë vështirësi me:

- Përgatitjen dhe thellimin e tyre në detyrë. Pjesëmarrje aktive në detyrë dhe të përqendrohen kur janë të rrethuar nga shumë stimuj ose ndikime vizuale;
- Gjetjen e objekteve mbi tavolinë, dysHEME, te varësja për pallto ose me gjetjen e një pjesë të caktuar për të ndërtuar ndonjë shembull (mostër) nga grumbulli i materialeve të lodrave ndërtuese;
- Zbatimin e detyrave praktike, si p.sh.: bashkimin e pjesëve të vogla enigmatike, ngjitjen e lodrave, ndërtimin e lodrave dhe klasifikimin e tyre;
- Detyra që kërkojnë ngjyrosje dhe ndjekje përmbi vija (apo pika) të caktuara ose gjetjen e objekteve të fshehura;
- Gjetjen e rrugës, vendin e tyre përreth dhomës, ose në fushën e jashtme të lojërave dhe rrugën prej shkolle në shtëpi;
- Vetëorganizimin e tyre dhe të vendit të punës, gjetjen e librit të tyre nga grumbulli i librave të tjerë mbi tavolinë;
- Mbajtjen e rreshtit kur lexojnë, plotësimin e fletës punuese ose kopjimin e detyrave nga libri ose dërrasa, të hedhin një sy në libër që të gjejnë informacionin që kërkojnë (aftësitë për kërkim dhe lexim të shpejtë);
- Gjetjen e detajeve në një fotografi ose gjetjen e ndonjë pjesë të caktuar në fletë të punës, tekst, ose në hartë. Në testet me më shumë se një përgjigje të saktë, në interpretimin dhe klasifikimin e diagrameve (tabelave), vizatimeve, grafikoneve, tabelën e të dhënave;
- Vërejtjen e fjalëve të duhura në fjalitë pyeste, identifikimin e fjalëve kyçe, plotësimin e gjitha pjesëve në detyrat me shkrim.

#### **4.4.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Nxiteni nxënësin që të vizualizoj (përfytyroj) objektin e emërtuar përpara se të kërkojë dhe të fillojë detyrën;
- Ushtroni aftësitë për veshje, jep udhëzime dhe sugjerime për të thjeshtësuar detyrat;
- Jepni mundësi për të përjetuar lëvizjen e sigurtë brenda, mbi ose rreth pajisjeve;
- Mbajeni fushën vizuale jo të rrëmujshe, jepi kuti organizuese (sistemuese) për punët ose detyrat e kryera;
- Sigurohuni që pozita e tavolinës është larg pengesave, përpara klasës dhe afër dërrasës së zezë dhe kufizo sasinë e sendeve mbi të;

- Kufizoni sasinë e informatave në faqe ose dërrasë për ta mbajtur punën pa rrëmuje vizuale;
- Përdorni sinjalizime me anë të prekjes dhe vizuale – duke i errësuar dhe trashur vijat ku duhet të presin, vendo edhe ngjitëse tek margjinat (kornizat) e fletës;
- Përdorni kufizime të ndryshme, si kutia për të izoluar punën dhe mundëso ndjekës së rreshtave kur lexojnë tekst;
- Inkurajoni përdorimin e stilolapsit me ngjyrë për të nënvizuar tekstin, ose pikat e rëndësishme në tekst;
- Zmadhoni fontet kur shkruani në kompjuter, përdorni shkronja të qarta dhe me të zeza, përdorni vija më të gjera dhe hapësirë më të madhe kur shkruani;
- Përdorni kontrast të ngjyrave kur shkruani në dërrasë ose fletore pune.

#### **4.4.5. Aktivitetet për të përmirësuar diskriminimin vizual për figurën në mjedis**

- *Aktivitete që përfshin gjetje dhe klasifikim sipas formës, madhësisë, teksturës, etj.;*
- *Ngjyrosje dhe ndjekje sipër vijave të ndonjë forme të caktuar në fotografi;*
- *Bashkimin e formave të vogla enigmatike, lojëra me ngjitje, ndërtim, si p.sh.: loja ‘çka ka në katror? mozaik, parket, modele komplekse;*
- *Dizajnë me rruaza dhe kapëse, lidhin karta dhe aktivitete me qëndisje me pe;*
- *Aktivitet të artit dhe artizanale, kolazhe, mozaik, piktura me numra;*
- *Gjetjen e shkronjës së njëjtë, formës, rrethimi i shkronjave të caktuara në tregim, (përdor edhe revistat shkollore), udhëzo që nxënësi të rrethoj të gjitha shkronjat ‘t’ ose shkronjat tjera të caktuara, udhëzo të gjej ndonjë fjalë të caktuar si ‘dhe’, udhëzo që nxënësi të gjej fjalën e parë në çdo fjali ose të fundit në çdo fjali, si dhe shkronjat dyshe ‘th, gj, zh,...’ në fjalë të ndryshme;*
- *Aktivitete me librin- gjej të gjithë ‘objektet e fshehta’, gjej të gjithë ... gjej të gjithë palët që nuk përshtaten, gjej dallimet/ nëpërmjet labirinteve etj.;*
- *Eksploroni dhe bisedoni për përmbajtjen e vizatimeve, fotografive;*
- *Lojëra eksploruese/imagjinative, si p.sh.: veshja, loja me shtëpinë e kukullave, lojëra me kënde të fermave me kafshë, lojë me rërë dhe ujë.*

## **4.5. Mbyllja vizuale**

### **4.5.1. Çfarë është mbyllja vizuale?**

Mbyllja vizuale është mundësia që të shohim me ‘syrin e mendjes’ të gjithë pjesën e një objekti, kur një pjesë e tij është e fshehur. Ajo përfshin manipulimin dhe transportimin (zhvendosjen) e informatës vizuale. Ajo na mundëson që të bëjmë gjykime të sakta nga informata të njohura por që janë të pjesshme. “Në zhvillimin e hershëm, fëmija përqendrohet



te 'tërësia', pastaj më vonë në zhvillim fokusohet në pjesët, dhe në veçanti, pjesët që e përbëjnë atë tërësi. Një fëmijë pesëvjeçarë përqendrohet në një aspekt të figurës stimuluese, ndërsa përgjithësisht marrëdhëniet me pjesë të tëra janë të pjekura te nëntëvjeçarët (75%)” (Chu, 1999). Mbyllja vizuale është zakonisht aftësia e fundit vizuale perceptuese që zhvillohet, sepse është ngushtë e lidhur me aftësitë kognitive (njohëse) dhe zhvillimin e koncepteve.

#### **4.5.2. Pse është e rëndësishme mbyllja vizuale?**

Është aftësia bazë për rrjedhshmëri dhe shpejtësi në të lexuarit, drejtshkrimin dhe drejtshqiptimin e fjalëve. Leximi efikas mbështetet tek mbyllja vizuale, sepse me çdo fiksion të syrit vetëm disa nga shkronjat e një fjale ose shprehje perceptohen. Ashtu siç nxënësi bëhet më i aftë në lexim, fiksioni i syrit behet më i vogël dhe ai duhet të mbush memorien me më shumë material.

#### **4.5.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Nxënësit që kanë problem me mbylljen vizuale mund të kenë vështirësi me:

- Identifikimin e një objekti vizual (p.sh.: këpucën) kur vetëm një pjesë e saj është e dukshme. Si rrjedhojë mund të jetë e vështirë për ato të gjejnë atë që janë duke kërkuar;
- Inicimin dhe organizimin e detyrave të panjohura;
- Bashkimin e pjesëve për të formuar një tërësi kur bëhet fjalë te lojërat ndërtuese, pjesët e vogla enigmatike, mozaik apo me aktivitete në libër. Përfundimin e vizatimit duke e lidhur pikë- për- pike atë çfarë mungon;
- Vizualizimin e detyrës së përfunduar (produktin final) duke pasur parasysh pjesët përbërëse, p.sh.: ndjekja e një recete, montimi i një konstrukcioni nga një foto, plotësimin e pjesëve të vogla enigmatike duke kërkuar pjesët e tyre përkatëse;
- Leximin dhe shqiptimin e rrjedhshëm - mund të jetë i ngadalshëm pasi nuk mund të njohë fjalë ose grupe fjalësh pa mos i lexuar të gjitha shkronjat një nga një;
- Përvetësimin e përzierjeve të tingujve dhe modeleve për drejtshqiptim, bashkimin e shkronjave bashkë për të formuar një fjalë, edhe pse ato mund të jenë të aftë të lexojnë secilën shkronjë individualisht;
- Saktësinë e formimit të shkronjave/formave - shkronjat/format shpesh janë jo të mbyllura plotësisht ose të ndara saktësisht;
- Llogaritjet matematikore, zgjedhjet e problemeve matematikore, tabelat e shumëzimit dhe detyrat matematikore logjike;
- Punën që përfshin mozaik, simetri dhe rrotullime të objekteve;
- Planifikimin e një dite të tërë dhe të punojnë brenda detyrimeve kohore, kategorizimin apo klasifikimin e kohës dhe hapësirës dhe identifikimin nëse fleta e punës është plotësuar ose detyra ka mbaruar.

#### 4.5.4. Strategjitë e mësimdhënies

- Përforconi rregullat e formimit të shkronjave për të inkurajuar saktësinë;
- Theksoni nevojën për të punuar prej margjinës së anës së majtë;
- Caktoni limite kohore për disa detyra dhe regjistroni rezultatin që nxënësi të përmirësohet;
- Rritni numrin e pjesëve në lojërat enigmatike (puzzle) ashtu siç rriten edhe aftësitë e tyre;
- Ndhmoni në përfytyrimin e formave/shkronjave/numrave që duhet të vizatohen, duke përdorur udhëzime për madhësinë dhe përshkrime tjera që do t'u ndihmojnë për të krijuar një fotografi vizuale në mendjet e tyre;
- Përdorni shkronja që preken për të shkruar edhe ato shkronjën duke e përforcuar formën e saj.

#### 4.5.5. Aktivitetet për të përmirësuar mbylljen vizuale

- *Aktivitetet pikë- për- pike*, pikturë me numra- pyet fëmijën që ta identifikojë figurën, menjëherë kur imazhi bëhet i dukshëm;
- *Ngjyrosje* shabllone, apo përfundojnë fotografi jo të plota (grua me një dorë që i mungon), duke reduktuar gradualisht kërkesën;
- *Krijimi i maketave*- ndërtimin e modeleve 3D prej kubeve, kopjimin nga fotografia, përfundimin e pjesëve jo të plota enigmatike, përzieni pjesët që duhet të bashkohen dhe kërko nga nxënësi që t'i gjejë ato pjesë dhe t'i bashkojë vetë;
- *Krahasimi* i formave të plota dhe jo të plota, krijimi i modeleve me shkrepse, prerja e figurave dhe ngjitja e tyre sërisht, krijimi i kolazheve;
- *Vizatoni/shkruani* mbi mjete të ndryshme - rërë, miell misri, me shkumë për rruajtje, me ngjyrë, shkumës në dërrasë, përdor brumë, tuba me tela fije-fije, etj., për të theksuar format, drejtimin. Bëje një formë/shkronjë ose numër dhe pastaj bëje edhe një tjetër me një pjesë që i mungon dhe kërko nga nxënësi që ta plotësojë;
- *Transferoni një formë* të projektimit nga një rrjetë në tjetrën, përdor simetri dhe mozaik, për të kompletuar pjesën tjetër të fotografisë ose dizajnit;
- *Fleta punuese* - plotësojnë shkronjat për të krijuar fjalë, ose plotësojnë fjalë për të krijuar fjali;
- *Mbuloni objekte* dhe ngadalë zbuloni ato një nga një. Filloni me objekte të njohura dhe kërkonin nxënësin që t'i qëllojë përpara se objekti të zbulohet i tëri.

### 4.6. Memoria vizuale

#### 4.6.1. Çfarë është memoria vizuale?

Memoria vizuale është aftësia për tu kujtuar çfarë ke parë dhe rikthimi në kujtesë i fotografive vizuale të objekteve, formave, simboleve dhe lëvizjeve edhe individualisht apo një

pas një. Është termi që përdoret për të përshkruar se si aktiviteti i memories përpunon informacionin vizual nga memoria afatshkurte në ruajtjen në memorjen afatgjate. Memoria vizuale efikase kërkon ruajtjen e organizuar të informacionit për të na mundësuar rikujtim të shpejtë. Kjo varet nga përqendrimi dhe vëmendja, motivimi i mirë, vrojtimi i mprehtë dhe shpejtësia.

#### **4.6.2. Pse është e rëndësishme memoria vizuale?**

Është aftësia bazë e të mësuarit e cila është e lidhur ngushtë me format tjera të memories (dëgjimore, të prekjes dhe të lëvizjes) dhe është thelbësore për saktësinë e kopjimit të detyrave. Roli i gjuhës në klasifikimin dhe rregullimin e përvojave vizuale në memorie, së bashku me zhvillimin e fotografisë vizuale dhe përfytyrimin janë themelore për arritjen e kësaj aftësie.

Rradhitja e shkronjave në fjalë dhe fjalëve në fjali është pjesë e procesit të deshifrimit vizual në lexim dhe proces i shifrimit (kodimit) në drejtshqiptim. Nxënësit që kanë vështirësi me leximin dhe drejtshqiptimin mund të kenë probleme me memorien vizuale.

#### **4.6.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Nxënësit që kanë probleme me memorien vizuale me sekuenca mund të përjetojnë vështirësi me:

- Ndërtimin e lodrave kur duhet të ndjekin një model ose fotografi si udhëzues, krijimin e tabelave, lojërat me enigmë;
- Aktivitetet e përditshme, si p.sh.: veshjen, organizimin e vetës për detyrat, të iniciojnë dhe qetësohen për detyrën, të njohin njerëzit, vendet dhe pajisjet;
- Qëndrimin në detyrë dhe përfundimin e saj;
- Mësimi, vizualizimi dhe formimi i shkronjave;
- Përkujtimin e sekuençave vizuale dhe informata që kanë mësuar më herët;
- Rradhitjen e fotografive për të treguar një tregim, renditja e alfabetit nga të vështruarit, lexim dhe drejtshqiptim;
- Orientimin (drejtimin) e shkronjave, numrave, kopjimin e informatave nga dërrasa e zezë ose libri dhe të marrin shënime;
- Matematik - të kujtojnë format bazë, renditjen e numrave, metodave për zgjedhjen e problemeve dhe mësimin e tabelave të shumëzimit;
- Kujtimin e renditjes nga një demonstrim praktik në matematik, shkencë, art, dizajnë apo teknologji;
- Kujtimin dhe riprodhimin e lëvizjeve të njëpasnjëshme në lëndën e arsimit fizik, lojëra, vallëzim, shpesh duke qenë një hap pas në krahasim me shokët tjerë.

#### 4.6.4. Strategjitë e mësimdhënies

- Përdor qasje vizuale për të mësuarit, si p.sh.: shiko, mbulo, shqipto, kontrollo;
- Sigurohuni se memoria vizuale praktikohet dhe jo ajo dëgjimore kur punoni individualisht me nxënësin;
- Përdorni pyetësor që ndihmon në rikthimin e memorieve të caktuara - në këtë rast të ndonjë simboli ose vizatimi të shpejtë;
- Inkurajoni nxënësin që t'i jap vetvetes sinjalizime vizuale kur provon detyrën, si p.sh.: kapëse të mëdha me ngjyra, rruaza të vogla të rrumbullakëta;
- Lejoni nxënësit që të përdor nxitje fizike në momentin e ndjekjes me gisht ose prekjen e sendeve;
- Përdorni skema të ideve, koncepteve për të ndihmuar memorien;
- Përdorni fjali ose poema që do ti ndihmoni nxënësit për të mbajtur mend renditjen/shqiptimin.

#### 4.6.5. Aktivitetet për të përmirësuar memoria vizuale

- *Ushtroni të veshurit* sipas renditjes së saktë, jep nxitje vizuale;
- *Sigurori strategji/orare* vizuale dhe pasqyrim për ditën, inkurajoni nxënësit të vizatojnë vizatime ose të bëjnë skema të ngjarjeve të ditës dhe kërko nga prindërit që të bisedojnë për ngjarjet e ditës. Përdor ditarë shkollë-shtëpi për të siguruar pasqyrimet;
- *Lojëra që do t'u ndihmojnë me kujtesën* - (me objekte, forma të shkronjave, ose numrat). Si p.sh.: “Unë shkova për të bërë pazar dhe bleva....”, lojën “Unë spiunoj”- kërko nga nxënësi që të shoh jashtë nga dritarja dhe të mbaje mend tre gjëra që do të shoh. Përdorni edhe lojën me gjetjen e çifteve të njëjta, loja me bingo, si dhe qasje dëgjimore për sa i përket tabelave të shumëzimit nëpërmjet CD të muzikës;
- *Largo një objekt* nga dhoma apo ndonjë veshmbathje dhe kërko nga nxënësit “Çfarë mungon”, tregoni nxënësit një fotografi të mbingarkuar dhe pyete nxënësin që t'i rëndit detajet, kërko nga nxënësi që të përshkruajë veshjen e nxënësit që është ulur afër tij;
- *Krijoni një shteg me pengesa* dhe pyete nxënësin që të kujtoj dhe përsëris planifikimin, ushtroni renditjen e lëvizjeve pjesë-pjesë;
- *Kopjimin e modeleve* me rruaza, tulla, kapëse, ndryshoni rrjedhën dhe kërkoni nga nxënësi që të rivendos ato në mënyrë korrekte, vizatoni dhe kopjoni një renditje të formave të përsëritura dhe rrjedhës/zhvillim të ngjarjeve;
- *Tregoni shkurtimisht forma abstrakte* dhe kërkoni nga nxënësi që të përsëris strukturën, dizajnin e tyre pasi i keni mbuluar format;
- *Aktivitete me librin* - fjalëkryqe/gjetjen e dallimeve, nënvizimin e fjalës, ose objektit të gjetur;
- *Nënvizoni kombinimet* e shkronjave dhe numrave në një tekst të dhënë;
- *Ushtrime me kohë të caktuar* kopjimi nga dërrasa në fletë.

## 5. Hyrje në gjuhë



Edhe pse ky libër fokusohet në zhvillimin e aftësive motorike, perceptuese dhe njohëse (kognitive) të nevojshme për të mësuarit, sidoqoftë rëndësia e zhvillimit të gjuhës që i mundëson nxënësit qasje në programet shkollore nuk mund të neglizhohet. Te shumë fëmijë një kombinim faktorësh do të kontribuojë në vështirësitë që ato përjetojnë, prandaj një pasqyrim i fushave kryesore të të zhvilluarit të gjuhës është përfshi, që të mundësojë një qasje më të plotë për të përkrahur fëmijën në shkollimin e tyre fillorë.

Fushat që janë përfshi në këtë seksion janë:

- Vëmendja dhe të dëgjuarit;
- Gjuha që pranojmë-receptive;
- Gjuha që shprehim-ekspresive;
- Memoria dëgjimore.

### 5.1. Vëmendja dhe të dëgjuarit

#### 5.1.1. Çfarë është vëmendja dhe të dëgjuarit?

Vëmendja dhe të dëgjuarit është mundësia e përqendrimit në tingullin apo zërin që mbart kuptim.

### **5.1.2. Pse është e rëndësishme vëmendja dhe të dëgjuarit?**

Aftësitë e vëmendjes dhe të dëgjuarit janë kushtet paraprake për të folurit dhe zhvillimin e gjuhës. Aftësitë e vëmendjes dhe të dëgjuarit janë të nevojshme në të gjitha situatat ku nxënësi duhet të dëgjojë dhe të reagojë ndaj fjalëve të folura. Nxënësit që përjetojnë vështirësi me të dëgjuarit nuk do të thotë se kanë dëmtime dëgjimi (Delamain & Spring, 2003).

### **5.1.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Nxënësit që kanë probleme me vëmendjen dhe dëgjimin ka gjasa:

- Të shqetësohen dhe vështirë të rrinë pa lëvizur;
- Të duken ‘çapkan’ apo të pabindur sepse nuk kanë dëgjuar udhëzimet;
- Të përjetojnë vështirësi me ‘dëgjimin’ dhe ‘lëvizjen’ në të njëjtën kohë;
- Shpejtë mund të shpërqendrohen dhe të shpërqendrojnë të tjerët;
- Të duken sikur ëndërrojnë me sy hapur (fantazojnë);
- Ta kenë të vështirë të krijojnë dhe mbajnë kontakt me sytë.

### **5.1.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Thirrni emrin e nxënësit që ta tërhiqni vëmendjen e tij përpara se të bisedosh me të;
- Sigurohuni se nxënësi nuk është duke punuar por është duke të dëgjuar;
- Përdorni sinjale vizuale që t’ia bëni nxënësit me dije t’ju dëgjojë;
- Përdorni materiale vizuale për të përkrahur gjuhën e folur;
- Jepni udhëzime dhe informata në pjesë të vogla dhe të renditura sipas rradhës që duhet zbatuar;
- Ndihmoni nxënësit që të ketë sukses të rrijë i vëmendshëm dhe të dëgjojë, duke bërë detyrat e shkurtra dhe shpërbleni nxënësin për detyrat e kryera;
- Mundohuni që ta ulni nxënësin afër mësuesit dhe larg pengesave të mundshme;
- Njoftoni rregullat e klasës dhe rregullat për dëgjim të mirë dhe bëni me dije se pasojnë shpërblime për ato që respektojnë këtë rregullore (Corbett, 2006a) (Corbett, 2006b).

### **5.1.5. Aktivitete që përmirësojnë vëmendjen dhe të dëgjuarit**

- *Lojëra ku kërkohet të rrinë gjithmonë në gatishmëri* dhe të vëmendshëm, sidomos në aktivitetet e arsimit fizik;
- *Aktivitete muzikore*, si p.sh.: të imitojnë ritme, të qëllojnë cili instrument është ai që bie;
- *Aktivitet për gjetjen e tingullit/zërit*- fshehe një objekt, si p.sh një orë në dhomë dhe kërkoni nga nxënësi që të dëgjojë atë dhe ta lokalizojë se ku gjendet (Mosely, 2005).

## **5.2. Gjuha që pranojmë- receptive**

### **5.2.1. Çfarë është gjuha që pranojmë?**

Gjuha që pranojmë është aftësia jonë që të kuptojmë përmbajtjen dhe strukturën e gjuhës së folur.

### **5.2.2. Pse është e rëndësishme gjuha që pranojmë?**

Nxënësit duhet të zhvillojnë aftësi për të pranuar gjuhën me qëllim që të kenë qasje në planin mësimor dhe të zhvillojnë marrëdhënie me të rritur dhe me moshatarët e tyre. Nxënësit duhet:

- Të kuptojnë një pjesë të fjalorit të përshtatshëm për situata të ndryshme;
- Të jenë të aftë të përpunojnë informatat që janë në formë të fjalive me qëllim që të kuptojnë udhëzimet dhe sqarimet;
- Të jenë të aftë të lidhin informatën e re me atë që kanë mësuar më herët me qëllim që të mësojnë;
- Të kuptojnë se si kuptimi i një shprehje mund të ndryshojë sipas kontekstit dhe mënyrës se si thuhet (Evamy, 2003).

### **5.2.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Nxënësit me vështirësi në gjuhën e pranuar mund:

- Të realizojnë vetë një pjesë të udhëzimit;
- Të kopjojnë veprimet e fëmijëve përreth;
- Të dominojnë në biseda me qëllim që të mos ballafaqohen me pyetje ose tema tjera që nuk i kuptojnë;
- Të tregojnë shmangie ose sjellje sfiduese kur nivelet e gjuhës bëhen me të ndërlikuara;
- Të duken të ‘pabindur’ sepse nuk i kanë kuptuar udhëzimet;
- ‘Çkyqen’- ndalojnë kur informata prezantohet në formë verbale;
- Të zbatojnë udhëzimin e marrë në renditjen e gabuar, sepse nuk kanë kuptuar konceptet siç janë: ‘para’, ‘pas’, ‘nëse’ dhe ‘ku’;
- T’ju përgjigjen pyetjeve me përgjigje të çuditshme;
- Përsërisin fjalët e përdorua në fjalitë pyetëse dhe udhëzimet pa mos i kuptuar ato me të vërtetë (Mosely, 2005).

### **5.2.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Përdorni materiale vizuale për të mbështetur gjuhën e folur;

- Jepni udhëzime dhe informata në pjesë të vogla dhe sipas radhës që duhet realizuar;
- Jepni kohë nxënësit që ta përpunojë në mendjen e tij gjuhën që sapo e pranoi;
- Përdorni gjuhë të qartë, jo me dy kuptime;
- Mësoni paraprakisht fjalor të programit mësimor;
- Përsëritni udhëzimet një nga një ose në situata të vogla.

### **5.3. Gjuha që shprehim- ekspresive**

#### **5.3.1. Çfarë është gjuha që shprehim?**

Gjuha që shprehim është aftësia jonë për të komunikuar duke përdorur fjalë dhe fjali.

#### **5.3.2. Pse është e rëndësishme gjuha që shprehim?**

Nxënësit duhet të zhvillojnë aftësitë për tu shprehur që t’ju mundësojë atyre të:

- Komunikojnë me njerëzit tjerë;
- Shprehin pikëpamjet e tyre;
- Kërkojnë sende për realizimin e nevojave dhe dëshirave të tyre;
- Refuzojnë diçka që nuk e duan ose nuk ju nevojitet.

#### **5.3.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Fëmijët me vështirësi në gjuhën e shprehur mund ti shprehin këto vështirësi:

- Vështirësi të sqarojnë mendimet dhe idetë e tyre;
- Të paaftë të shprehin nevojat dhe dëshirat e tyre;
- Bëjnë gabime gramatikore;
- Përdorin gjuhën me stilin ‘telegramatik’ ose përdorin vetëm fjali të shkurta;
- Vështirësi të mendojnë fjalë specifike; fëmijët mund të përshkruajnë fjalët ose të përdorin fjalë zëvendësuese si: ‘kjo’, ‘ajo’, ‘aty’;
- Frustrohen për pamundësinë e tyre për të komunikuar në mënyrë efektive;
- Vështirë të marrin pjesë në biseda dhe debate;
- Janë të paaftë të ritregojnë një tregim, apo bisedojnë për një ngjarje sipas renditjes së saj të saktë;
- Kanë ngecje në të folurit, përdorin shumë fjalë “um”, “ëë” dhe përdorin më shumë shprehje të mësuara përmendësh;
- Vështirësi me gjuhën e shkruar.



### **5.3.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Përdorni libra shtëpi/shkollë për të mbështetur nxënësin në kohën kur duhet të mësojnë njësi të reja;
- Kërkoni nga stafi i mësimdhënësve që të bëjnë pyetje me qëllim të caktuar dhe përkrahni nxënësin që të jap përgjigjen;
- Praktikoni përdorimin e fjalorit të rëndësishëm të planit mësimor nëpër fjalitë;
- Më shumë përdorni modelin e gjuhës së saktë, se sa të korrigjoni nxënësin;
- Jepni kohë nxënësit që të formulojë përgjigjen e tij pa mos pasur frikë se mund të ndërpritet;
- Përdorni fotografi, korniza për tregime, diagrame në formë të merimangës dhe faqe nga interneti për të prodhuar ide për shkrime krijuese dhe aktivitete praktike;
- Mundësoni më shumë zgjedhje nëse nxënësi përjeton vështirësi për të kujtuar një fjalë.

## **5.4. Memoria dëgjimore**

### **5.4.1. Çfarë është memoria dëgjimore?**

Memoria dëgjimore është aftësia për të mbajtur mend informata të pranuar në formën e një tingulli.

### **5.4.2. Pse është e rëndësishme memoria dëgjimore?**

Memoria dëgjimore është aftësia thelbësore e të mbajturit mend një listë të sendeve, udhëzimeve, informatave të Cilët janë të paraqitura në mënyrë verbale, jo në mënyrën vizuale.

Fëmijët me mungesë të memories dëgjimore mund të bëjnë gabime që mund të shpien në informata jo të sakta në memorien e gjatë që do të përdorin në të ardhmen.

### **5.4.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Nxënësit me vështirësi me memorien dëgjimore mund:

- Të jenë të paaftë të mbajnë mend një listë të udhëzimeve të pranuar në formë verbale;
- Të kenë vështirësi të mbajnë mend fjalorin e ri;

- Të kenë të vështirë të mësojnë përmendsh informacione, përfshirë vjersha dhe këngë;
- Të paaftë të ritregojnë një tregim ose parafrazojnë një informacion që kanë pranuar në formë verbale;
- Përjetojnë vështirësi me të kuptuarit e një fjalie të gjatë; nxënësit mund të harrojnë informata që kanë pranuar në fillim të fjalisë, të Cilët do të duhet të ju referohen përsëri në fund të fjalisë;
- E kanë të vështirë përdorimin e aftësive parashikuese në tregime për shkak të kujtesës së dobët të detajeve nga tregimet e mëparshme (Beales, 1996).

#### **5.4.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Përdorni materiale vizuale për ti përkrahur informatat e prezantuara në formë verbale;
- Mësoni nxënësve strategji, siç janë përdorimi i gishtërinjve për të paraqitur sendet në një listë;
- Jepni udhëzime dhe informata në pjesë të vogla, sipas renditjes që duhet realizuar;
- Përsëritni udhëzimet dhe kërko nga nxënësi që të përsëris çfarë kërkohet prej tij të bëjë;
- Jepni nxënësit një fjalëkalim për ta mbajtur mend dhe ta përdor të njëjtin kur duhet të ketë qasje në një aktivitet;
- Siç rriten aftësitë e nxënësve, ashtu rritni edhe numrin e udhëzimeve (Edwards, 1998).

#### **5.4.5. Aktivitete për të përmirësuar memorien dëgjimore**

- Loja: “Unë shkova në dyqan dhe bleva...”;
- *Bartjen e porosive* përreth shkollës;
- *Mbajtjen mend e renditjes së udhëzimeve* në aktivitetet e arsimit fizik, muzikë dhe renditjen e hapave në vallëzim;
- *Mbajtjen mend të numrave të telefonit*;
- *Të mësuarit përmendsh të këngëve dhe vjershave*;
- *Jepni nxënësit një fjalëkalim që ta mbajë mend* kur duhet të ketë qasje në një aktivitet. Rritni sasinë e kohës për ta mbajtur mend fjalën (Warren, 2004).

## 6. Organizimi



### 6.1. Çfarë është organizimi?

Komponentët thelbësor të organizimit janë: planifikimi, vetëdija trupore dhe koha. Çdo detyrë e re përfshin një planifikim motorik kur truri duhet të mendojë, organizoj dhe zbatoj një rrjedhshmëri të veprimeve të panjohura (Stein & Chowdhury, 2006).

### 6.2. Pse është i rëndësishëm organizimi?

Aftësitë organizative i mundësojnë nxënësit të funksionojë në mënyrë efektive në aktivitetet e përditshme ditore dhe në aktivitetet mësimore.

### 6.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?

Nxënësit me probleme organizative mund të kenë vështirësi me:

- Të qenurit të vetëdijshëm për hapësirën e tyre personale kur ju bashkëngjiten aktiviteteve të mëdha motorike;
- Manovrimin e vetes së tyre përreth klasës, pjesmarrje si një lojtar ekipe dhe izolimin (të mbyllur) brenda një hapësire;
- Punën pranë nxënësve tjerë ose të marrin pjesë në aktivitete grupore;
- Veshjen për aktivitetet nga arsimi fizik dhe të mbajnë një paraqitje të pastër, si p.sh.: të fusin brenda veshjen pasi të dalin nga tualeti;
- Përgatitjen për mësim dhe të fillojnë punën me përpikëri, të mbledhin gjërat e tyre personale që ju përkasin në fund të ditës, vendosjen e librave nëpër çanta, etj.;
- Marjen mjetit të duhur për detyra të caktuara, të organizojnë pjesën ku punojnë, shpesh duke kaluar kufijtë tek tjerët dhe vendet e tyre të punës;

- Ndjekjen e udhëzimeve vizuale apo dëgjuese për një detyrë të caktuar, sidomos nëse rrjedha e udhëzimit është dhënë;
- Planifikimin dhe organizimin e punës shkollore;
- Memorimizimin të detyrave dhe përfundimin e tyre;
- Zbatimin e detyrave praktike;
- Përdorimin e teknologjisë së informimit dhe komunikimit;
- Llogaritjen e kohës dhe gjithmonë janë harra q dhe shpesh gjenden në vendin dhe kohën e gabuar;
- Si dhe kanë vetëvlerësim të dobët dhe janë të prekshëm ndaj testeve (Nagleri & Pickering, 2003) (Stein & Chowdhury, 2006).

#### **6.4. Strategjitë e mësimdhënies**

- Përforconi emrat e pjesëve specifike të trupit përderisa nxënësi i lëviz ato, për të ndihmuar zhvillimin e pozicionimit të pjesëve trupore;
- Përdorni peshë në dorë/kyçe/ lidhni ose mbani objekte të renda për mëvetësinë e pjesëve të rënuara të trupit;
- Vendosni të dhëna vizuale/dëgjimore (fjongo, zile) në pjesë të trupit për të krijuar reagim ndijor;
- Inkurajoni nxënësin t'i mbyllë sytë dhe të eliminoj të dhënat vizuale dhe të zhvilloj përqendrimin;
- Filloni me pjesët me të mëdha trupore (koka, këmba) dhe vazhdoni tek ato më të voglat (dora, gishtat e këmbës, sytë, veshët) (Dunn, 2007);
- Mësoja rregullat e hapësirës personale. Puno me programin për vetëdijesimin trupor dhe hapësinor. Siguro mundësi më të shpeshta për aktivitete të qëndrueshme dhe të klasifikuara për të ndihmuar në zhvillimin e vetëdijesimit trupor të nxënësit. Përfshije nxënësin dhe prindin në rrënie dakord të strategjive;
- Bisedoni me pjesën tjetër të grupit dhe shpjego arsyet e vështirësive që ka nxënësi;
- Inkurajo nxënësin për një zonë punuese të pastër, shëno zonën punuese me një shirit ngjites. Përforco pastrimin e mjeteve punuese dhe vendosjen e tyre në vendin përkatës pas mbarimit të punës;
- Inkurajo nxënësin t'i përsërisë instruksionet e dhëna për tu siguruar që e ka kuptuar detyrën;
- Ndihmo dhe inkurajo nxënësin të planifikoj paraprakisht detyrën, kërko nga nxënësi të bëjë një listë të mjeteve të nevojshme gjatë punës;
- Sigurohu që mjetet e punës janë lehtë të arritshme për të;
- Siguro çeklista përcjellësevizuale/karta sugjerimi me listën e mjeteve të nevojshme për çdo detyrë;
- Siguroni nxënësin me një set mjeteve dhe angazho atë të krijojë listën me secilin mjet, duke shkruar dhe arsyen e përdorimit të tij;
- Përdor trajtimin e analizave aktive për të zbërthyer detyrën në faza.
- Siguroni instruksione hap-pas-hapi të shkruara, ose vizuale, gjithashtu edhe instruksione gojore;
- Përdor orar vizual për ta informuar nxënësin, për ndryshimet e parashikuara;

- Zbatoni sistem të përberë për përgatitjen e nxënësit për ndryshimet para se ato të ndodhin, siç është paralajmërimi gojor pesëminutësh, përdorimi i kohëmatësit;
- Mbështetu sa më shumë në vendosjen e rutinës dhe kur nuk do të jetë e mundshme, lejo me shumë kohë për përgatitje dhe përsërit ndryshimet e ndërmarra;
- Inkurajoni nxënësin ti para-përgatisë ndryshimet dhe t'i përforcojë duke i përsëritur (Wallace, 2001);
- Konsidero pozicionin e uljes së nxënësit: sigurohu që fëmija është në pozicion të stabilizuar para fillimit të veshjes, ose zhveshjes. Fëmijët më të vegjël preferojnë të ulen në skaj të dyshemesë duke mbështetur shpinën dhe shpatullat, përderisa fëmijët me të mëdhenj preferojnë uljen në një karrige më të ulët, duke vendosur këmbët mbi dysheme.
- Siguro orar vizual. Kjo, mund t'i ndihmojë nxënësit, duke i dhënë një pasqyrë të fazave të renditura gjatë veshjes;
- Konsidero alternative tjetër gjatë mbërthimit të rrobave: disa nxënës e kanë më të vështirë menaxhimin e mbërthimit të rrobave, siç janë butonat, lidhja e lidhëseve të këpucëve, mbërthimi i sustave, kështu që punoni në zhvillimin e aftësive manipuluese dhe shkathtësinë e duarve për përmirësimin e aftësive gjatë menaxhimit të mbërthimit të rrobave. Mund të jetë e nevojshme të merret në konsideratë adaptimi i mbërthimit të butonave më të mëdhenj/sustave dhe lidhëse elastike/të dredhura;
- Adapto stilin e veshjes, p.sh.: veshje të liruara/gjera, veshje me numër më të madh dhe veshje me bel elastik, për tu menaxhuar me lehtë. Gjatë përmirësimit të aftësive për veshje, provo veshjet më të ngushta dhe veshjet me mbërthim standard;
- Përdor veshje specifike, që janë adaptuar t'i përmbushin nevojat speciale të nxënësit. Për shembull, nxënësit që përdorin karrocë mund të përdorin veshje të çelur nga shpina, ose me mbërthim nga të dy anët (Ball, 2002).

## 6.5. Aktivitete për të përmirësuar aftësitë organizuese

- *Këngët dhe meloditë duke përfshirë:*
  - Kokën, shpatullat, gjunjët dhe gishtat;
  - Këngë të lidhura me mënyrën se si e lajmë fytyrën, krehim flokët, pastrojmë dhëmbët;
  - Lojërat lidhur me veshjen, zakonisht në lidhje me veshjen e rrobave më komplekse, kapelat, këpucët, dorashkat dhe qaforet;
  - Ngjyrosja e fytyrës-lejoni nxënësit të ngjyrosin fytyrën e tyre dhe të dikujt tjetër. Sigurohuni që kanë ngjyrosur të dy anët e fytyrës të majtën dhe të djathtën. Ushtroni edhe ngjyrosjen e trupit;
  - Simoni thotë-kjo lojë mund të përdoret me sytë hapur ose mbyllur. Demonstroni veprimet nëse nxënësi ka vështirësi gjatë orientimit verbal:
    - Prek dorën e djathtë deri tek veshi i majtë;
    - Prek këpucët, shpatullat dhe gjunjët;
    - Vendos duart tek kyçet e këmbëve, këllkut dhe gjunjët;
    - Lëkundni duart;
- Tregoni me gishta: Veshjen e kukullave të ndryshme, arushave;

- Ushqimi - bëni se bashku njeriun prej bukës së xhenxhefilit, fytyra akulli nga biskotat, bëni sanduiçë duke përdorur prerëse me forma njeriu;
- Arti dhe mjeshtria - përdor lloje të ndryshme të mjeteve:
  - Ngjyrosni njerëz duke përdorur ngjyrën me gisht;
  - Beni shenjat e duarve dhe këmbëve;
  - Ngjyrosni fëmijë të rumbullakët dhe krijoni një kolazh;
  - Krijoni modele të njerëzve duke përdorur plastelina ose argjil;
  - Vizatoni njerëzit duke përdorur shkumë rroje, miell misri, ngjyrë të trashë, rrërë;
- Lojëra top hedhës, sfungjerë, fjongo, furçë dhembesh:
  - Prek pjesë të ndryshme të trupit me sfungjer/furçë-dhe pyet se si ndihen?;
  - Vendosni fjongon mbi dorën tuaj të majtë;
  - Vendosni topin mbi gishtin e këmbës;
  - Krijoni një sanduiç me top të butë ose sfungjerë duke e vendosur ndërmjet bërrylit dhe gjurit (Schmutz Boyd, Schmutz Law, & Schmutz, 2003);
- Krijoni forma me trupin:
  - Vizatoni të gjithë trupin në formë rrethi ose katrori;
  - Me cilët pjesë të trupit mund të prekesh dyshemenë? -gjunjët, stomakun;
  - Vizatoni trupin e një kafsheje (bretkose, peshk, krimb), eksploro se si lëvizin ato;
  - Vizatoni trupin sa më të vogël që mundesh/sa më të madh që mundesh;
- Exploro se si lëviz trupi:
  - Lëviz përpara, anash, prapa si kafshët;
  - Lëvizni shpejt, ngadalë, në heshtje, me zhurmë;
  - Bëni lëvizje simetrike - ngre të dy duart, këmbët;
  - Bëni lëvizje të alternuara - ngrejë këmbën e majtë mandej këmbën e djathtë;
  - Dy lëvizje të ndryshme - ngrejë një këmbë dhe një dorë;
  - Lëvizni nëpër dhomë duke nxjerrë para pjesë të ndryshme të trupit;
- Ndërgjegjësimi i pjesëve specifike të trupit:
  - Kalo nëpërmjet pjesëve të tendosura të trupit dhe mandej 'lirohu';
  - Ndërgjegjësohu për pjesët specifike të trupit pa i lëvizur ato;
  - Teknika relaksuese - shtrëngo/relakso pjesë të ndryshme të trupit (Addy, 2006).

## 7. Aspekti social dhe emocional



### 7.1. Çfarë janë aspekti social dhe emocional?

“Aspektet sociale dhe emocionale të të mësuarit” janë disa nga termet e shumta përdorura brenda ambientit shkollor për të sqaruar konceptin e gjendjes emocionale dhe mirëqenies sociale. Ndërkaq termet tjera të përdorura përfshijnë kompetencat sociale, emocionale, shkrimi dhe leximi emocional, inteligjenca emocionale dhe sociale, si dhe aftësitë emocionale dhe të sjelljes (Department for Education and Skills, 2004).

Një sërë aftësi sociale, emocionale dhe të sjelljes, përbëjnë shtyllat bazë të gjendjes emocionale dhe mirëqenies, përfshirë:

- Krijimin dhe mbajtjen e shoqërisë;
- Bashkëpunimin gjatë punës dhe lojës;
- Zgjedhjen e konflikteve me drejtësi;
- Kuptimin, vlerësimin dhe respektimin e dallimeve në mes njerëzve;
- Gadishmëri për të zgjedhur problemet personale dhe me të tjerë;
- Të qenurit nxënës të suksesshëm dhe efikas;
- Kotrollimin e ndjenjave, siç janë: ankthi, irritimi dhe zemërimi.

### 7.2. Pse janë të rëndësishme aspektet sociale dhe emocionale?

Gjendja emocionale dhe mirëqenia sociale e nxënësve konsiderohet si forca dhe kapaciteti i nxënësve për tu rritur dhe për t'i zhvilluar me shumë besim ato aftësi që ju mundësojnë të marrin pjesë në aktivitetet nga përditshmëria dhe të njohin talentet e tyre personale. Ajo përbëhet edhe nga kapaciteti i të mësuarit nga përvoja dhe tejkalimi i vështirësive (Weare, 2000).

Aspekti social, emocional dhe aftësitë për sjellje të mirë, konsiderohen të përforcojnë çdo aspekt të jetës në shtëpi, shkollë dhe në komunitet, si dhe janë aspektet kyçe për të mësuarit. Është i njohur fakti se shkollat kanë një ndikim të drejtpërdrejtë mbi gjendjen emocionale të nxënësve dhe kjo pastaj ka ndikimin e saj mbi arritjet akademike dhe arritjet tjera shkollore (Weare & Gray, 2003).

Aspekti social, emocional dhe i sjelljes përdoret për:

- Menaxhimin e një sërë ndjenjash që pengojnë të mësuarit, siç janë: irritimi, mërzia, zhgënjimi dhe ankthi;
- Promovimin e një gjendje të mendjes që mundëson zbatimin efikas të detyrave;
- Menaxhimin e komponentëve sociale dhe emocionale që e shoqërojnë një aktivitet.

Përvojat e kaluara tregojnë se duke nxitur aftësitë sociale, emocionale dhe të sjelljes së mire të nxënësi, pikat e mëposhtme kanë ndikim pozitiv:

- Suksesi arsimor dhe i punës;
- Përmirësime të sjelljes;
- Përfshirje më e madhe;
- Kohezion më i madh social;
- Gjendje mentale.

Faktori kryesor për të krijuar dhe mbajtur një mirëqenie të mirë sociale, emocionale dhe mendore është respekti për veten. Nxënësit me një respekt të shëndoshë për veten mund të ballafaqojnë ankthin, dhimbjen dhe hidhërimin në mënyrë më pozitive dhe konstruktive (Plummer, 2007).

Është e vërtetuar se të gjithë ato nxënës që kanë vonesë dhe çrregullim në zhvillimin e shtyllave bazike, si p.sh.: koordinimin motorikës së madhe, kontrollin motorikës delikate kanë vështirësi në zbatimin e aktiviteteve shkollore. Në të njëjtën mënyrë ato mund të kenë vështirësi në krijimin e aftësive sociale, emocionale dhe të sjelljes, të cilët ndikojnë mbi zhvillimin e shtyllave bazike dhe realizimin e aktiviteteve shkollore (Lougher, 2001).

Nxënësit me çrregullim të koordinimit zhvillimor, mungesë të vëmendjes dhe çrregullim të hiperaktivitetit, çrregullim të spektrit autik, ose ata me aftësi të kufizuara fizike dhe me dëmtime shqisore janë veçanërisht të ndjeshëm ndaj problemeve të lidhura në aspektin social, emocional dhe të sjelljes (Departament for Education and Skills, 2005a).

### **7.3. Cilët janë vështirësitë që përballen nxënësit?**

Nxënësit të cilët zhvillimi emocional, social dhe i sjelljes paraqet një shqetësim mund të kenë vështirësi me:

- Përgatitjen dhe thellimin në detyrë;
- Ruajtjen e përqendrimit gjatë gjithë detyrës - tregojnë një lodhje të tepruar, duken sikur ëndërrojnë me sy hapur dhe të shqetësuar;



- Aftësitë organizative - mbajtjen mend të mjeteve dhe informatave të nevojshme për një detyrë, sillen vërdallë klasës në forma penguese dhe përçarëse për të tjerët;
- Aftësitë e të dëgjuarit - mbajtjen mend të udhëzimeve, marrjen pjesë në informacione apo në aktivitete që i kanë pëlqyer më parë, tërhiqen nga aktivitetet;
- Aftësitë sociale- krijimin e shoqërive, mbajtjen e marrëdhënieve shoqërore me bashkëmoshatarët, ose të punojnë në mënyrë efektive në punët grupore;
- Bashkëpunimin me të rriturit dhe bashkëmoshatarët/hyjnë në konflikte me bashkëmoshatarët ose të rriturit;
- Punën e pavarur, shpesh duke kërkuar vëmendjen dhe bashkëveprimin e të rriturve;
- Ballafaqimin dhe zgjidhjen e konflikteve, rregullimin emocional, përloten shpejt, kanë zemërim dhe shpërthim të çastit;
- Menaxhimin e një sërë ndjenjash, bëhen shpejtë nervoz dhe tregojnë frustrimin e tyre;
- Ndjekjen e rregullt të shkollës, shpesh refuzojnë të shkojnë në shkollë.

Nxënësit shpesh përdorin sjelljen e tyre për të treguar se si ndjehen dhe për të komunikuar nevojat e tyre themelore emocionale (Colby-Trott, 2002).

#### **7.4. Aktivitete për të promovuar aftësi sociale, emocionale dhe të sjelljes së mirë**

Shkollat promovojnë zhvillimin e nxënësve përmes iniciativave siç janë: qasjet për vetëvlerësim, programet për përkrahje nga shokët, skemat për mentorim dhe programe komerciale për zhvillimin e aftësive emocionale, sociale, dhe të sjellës, siç janë Aspektet e të mësuarit social dhe emocional (Departament for Education and Skills, 2005a).

Në shumë e raste, përmirësimet në sjelljen e nxënësit do të jenë të dukshme nëpërmjet:

- *Pjesëmarrjes në iniciativa* që synojnë zhvillimin e vetëvlerësimit dhe mirëqenies emocionale;
- *Zhvillimin e shtyllave bazike*, si p.sh.: vetëdijes hapësinore dhe trupore, gjuhës së shprehur, e cila ka treguar se ka një ndikim mbi mirëqenien apo gjendjen sociale, emocionale të nxënësit;
- *Puna në bashkëpunim* me prindër dhe familjarë tjerë.

#### **➤ Kërkimin e këshillave shtesë dhe përkrahjes**

Nëse ndjenjat dhe sjelljet që shkaktojnë shqetësime vazhdojnë me muaj të tërë, deri në atë pikë që pengojnë në përditshmërinë, atëherë mund të nevojitet mbështetje shtesë.

Prindërit, stafi edukativo-arsimor dhe kujdestarët mund të kenë nevojë të kërkojnë këshilla dhe mbështetje shtesë nga profile tjera, siç janë: infermiere, mjekë, psikolog, nëpunës për mirëqenien sociale, mjeki i përgjithshëm, nëpunës i gjendjes mendore-psikike dhe nga shërbime tjera sociale.

Ekzistojnë një sërë shërbimesh që ofrojnë ndihmë për nxënësit. Mbështetja shtesë do ti mundësojë nxënësit, familjes dhe shkollës të gjejë mënyra për të ndihmuar në kuptimin dhe përballimin e ndenjave që shkaktojnë sjelljet e tyre (Cooper & Tikhaz, 2007).

Shqetësimet që tregojnë nevojën për ndihmë të mëtejshme përfshinë:

- Lohje e tepërt;
- Përkeqësime në pamje, i pa rregullt;
- Shpesh të lagur, ndotur, të papërshtatshëm për moshën e tyre;
- Veçim, mbyllje në vetvete;
- Refuzim për shkollën;
- Depresion;
- Probleme me të ngrënit;
- Ankthe;
- Rritje të intensitetit dhe ashpërsi të sjelljeve agresive;
- Emocionalisht të ndryshueshëm;
- Vendosjen e vetvetes në rrezik.

Nëse shqetësimet vazhdojnë dhe ka ndikim të mëtejshëm në aftësinë e nxënësit për t'u përfshirë në jetën e përditshme ose ka një përkeqësim të papritur në pamjen e një nxënësi, atëherë mund të kërkohet këshilla të mëtejshme nga shërbime të specialistëve, siç janë shërbimet për gjendjen psikike të fëmijëve dhe adoleshentëve. Specialistët në fjalë sigurojnë një sërë intervenime për fëmijët kur shohin probleme emocionale, të sjelljes së tyre, probleme me marrëdhëniet apo nëse kanë shqetësime të gjendjes psikike (Rae, 2003).

## Shtojca 1

### Moshat dhe fazat e zhvillimit

Pasi që secili fëmijë rritet dhe zhvillohet në mënyrë të veçantë është e pamundur të thuhet se kur dhe si do të arrijnë përvetësimin e aftësive të duhura. Këto faza zhvilluese mund t'ju japin një mendim të përgjithshëm për ndryshimet e pritura gjatë rritjes së fëmijës. Mos u alarmoni nëse zhvillimi i tyre nuk merr kahen e duhur. Gjëja më e rëndësishme është të jeni në vetëdije se ky është një progres i qëndrueshëm i fitimit të aftësive (Chapman, Drew, Jenkinson, & Woollard, 2007).

### Fazat zhvillimore 3-4 vjeçar

#### ➤ Lëvizjet

- Mban baraspeshën në një këmbë për 2-3 sekonda;
- Kërçen në shënjestër me të dy këmbët bashkë;
- Vrapon pa pengesa, i aftë të ndalet për të shmangur përplasjen;
- I aftë të vrapojë dhe të shkelmojë topin që qëndron në vend;
- Shkelmon topin me drejtim;
- Demonstron qëndrim të mirë gjatë qëndrimit ose uljes (në bankë/tavolinë, në karrige, në rresht);
- I aftë të kërcejë për afërsisht 30 cm lart në ajër;
- I aftë të kërcejë për afërsisht 30 cm largësi;
- Mundohet të ngjitet, mund të menaxhoj dy ose tre shkallë me këmbën dominuese;
- Ec lartë dhe poshtë shkalleve, alternon këmbët;
- Vrapon në mënyrë të koordinuar;
- Qëndron në majët e gishtërinjve dhe ec 3 m;
- Ec me shputë dhe thembër në një linjë të shkurtë;
- I aftë të ec dhe vrapojë para-prapa me shkathësi;
- E nget biçikletën me tre rrota;
- Përkulet lehtë pa u rrezuar;
- Kap topin e madh nga 1.5 m, mundësisht kundrejt trupit;
- Hedh topin e vogël me dore në drejtimin e duhur;
- Ngjitet mirë lartë dhe poshtë mobileve/mjete ushtruese për fëmijë.

#### ➤ Aftësitë e dorës dhe gishtërinjve

- Dora e preferuar vërehet dukshëm;
- Formon shkronja, numra dhe forma themelore që janë të sakta dhe të lexueshme;
- Kopjon O, V, H, T, +;
- Thur rruaza;

- Ndërton një kullë me më shumë se gjashtë kube, ose kopjon tre hapa me gjashtë kube;
- Vizaton njeriun me një ose dy pjesë të trupit;
- Ben vija vertikale, horizontale dhe rrethore me laps ose ngjyrë dylli;
- Mban lapsin në pozicion shkrimi (mund të mos e përdor kapjen korrekte);
- Hap dhe mbyll kapakët e kavanozit, vidhave të ndryshëm;
- Hap dorezat që rrotullohen.

#### ➤ **Gjuha**

- Kupton ndërlidhjen e pozicionit (mbi, në, nën, lartë, poshtë, para, prapa);
- Ndjek urdhër të përberë nga dy ose tre etapa;
- I njeh dhe i identifikon gati të gjitha objektet e zakonshme dhe fotografitë;
- I kupton shumicën e fjalive;
- Përdor fjali me katër ose pesë fjalë;
- Mund ta tregon emrin, moshën dhe gjininë;
- Përdor përemrat (unë, ti, e imja, në, ato) dhe disa fjalë në shumës (veturat, qentë, macet).
- Të tjerët mund t'i ja kuptojnë shumicën e fjalëve.

#### ➤ **Të njohurit**

- Tregon dhe i përsërit fjalët për duart, këmbët, hundën, sytë, gojën, këpucët;
- Mund t'i lëvizë lojërat mekanike;
- Përputh objektin që e ka në dore ose e gjenë në dhomë me foton në libër;
- Luan lojëra “sikur të ishte” me kukullat, kafshët dhe njerëzit;
- I ndan objektet sipas formës dhe ngjyrës;
- Kompletion enigmën (puzzle) me tre ose katër pjesë.

#### ➤ **Socializimi**

- Imiton të rriturit dhe shokët e lojës;
- Në mënyrë spontane shfaq dashuri ndaj shokëve të njohur;
- Mund të luaj me radhë në lojë;
- Kupton domethënien e “e imja”, dhe “e atij/asaj”.

#### ➤ **Zvillimi emocional**

- Shfaq hapur ndjenjat;
- Shfaq një varg të gjerë emocionesh;
- Nga moshë tre vjeçare, ndahet lehtë nga prindërit;
- Kundërshton ndryshimet e mëdha gjatë rutinës.

#### **Duhet të shqetësohesh nëse fëmija shfaq këto në vijim**

- Rrezohet shpesh dhe ka vështirësi me shkallët;
- Vazhdimisht nxjerr jargë dhe nuk flet qartë;
- I paaftë të ndërtojë kështjellë me më shumë se katër kube;
- Ka vështirësi në manipulimin e objekteve të vogla;

- I paaftë të kopjoje rrethin deri në moshën trevjeçare;
- I paaftë të komunikojë në fraza të shkurta;
- Nuk përfshihet në lojën “sikur të ishte”;
- Dështon në kuptimin e instruksioneve të thjeshta;
- Ka interes të dobët për fëmijët tjerë;
- Ka vështirësi të madhe gjatë ndarjes nga nëna.

## **Faza e zhvillimit 4-5 vjeçare**

### ➤ **Lëvizjet**

- Përdor sheshin e lojërave/mjetet e edukatës fizike (ngjitja në kornizë me shkallë rrëshqitëse, ekuilibër të dobët tek trau i ekuilibrit, lëkundet-mund të mos jetë i aftë të fillojë lëkundjen vet) i pavarur;
- Kërcen mbi/përmes objekteve të ulëta në sheshin e lojërave (blloqe, pengesave të ulëta, litarit ,etj.);
- Qëndron mbi një këmbë për pesë sekonda ose më shumë;
- Kërcen me një këmbë për pese ose më shumë herë;
- Kërcen prej një rës këmbë në tjetrën për katër herë ose me shumë;
- Vrapon drejt pengesave dhe merr kthesat me shkathtësi. Ngjitet lartë e poshtë shkalleve pa mbështetje dhe me një rën këmbë në çdo hap;
- Gjuan topin para në drejtim të mirë;
- Hedh topin me duar me saktësi;
- Kërcen dhe kap topin e futbollit vetë;
- Shumicën e rasteve kap topin në kërcim me duar- nuk ka nevojë të përdorë kapjen trupore;
- Lëviz para prapa dhe anash me shkathtësi;
- Ec përgjatë një linje me shputë dhe thembër dhe kthehet prapa me gjashtë ose me më shumë hapa;
- Ec anash traut të ekuilibrit për 10 cm pa u rrëzuar fare.

### ➤ **Aftësitë e dorës dhe gishtërinjve**

- Kopjon katrorët;
- Vizaton njerëzit me dy ose katër pjesë të trupit, duke përfshire kokën, këmbët, trupin dhe zakonisht krahët dhe gishtërinjtë;
- Mban mjetet me shtypje dhe kapje adekuate (gërshërë, laps, stilolaps, furçë ngjyrosjeje);
- Hap fletët e librit një nga një,
- Dorëzon fletë individuale nga një grumbull fletësh;
- Përdor gërshërët;
- I pavarur vizaton rrathë dhe forma të thjeshta;
- Fillon të kopjojë disa shkronja të mëdha;
- Përpiqet të përdor butonat dhe mbërthime të tjera tek lodrat ose vetja;

- I aftë të hapë dhe mbyll sende të ndryshme.
- **Gjuha**
- E kupton domethënien e “e njëjtë” dhe “ndryshe”;
  - Ka përvetësuar disa nga rregullat kryesore gramatikore;
  - Flet me fjali të përbëra nga pesë ose gjashtë fjalë;
  - Flet mjaft qartë sa që të tjerët mund ta kuptojnë;
  - Rrëfen (tregon) tregime.
- **Të njohurit**
- Në mënyrë korrekte emërton disa ngjyra;
  - Kupton domethënien e numërimit dhe mund të njohë disa numra;
  - Trajton problemet nga një pikëpamje;
  - Fillon të ketë ndjesi të qartë të kohës;
  - Ndjek urdhrin e përbërë nga tre pjesë;
  - I rikujtohen pjesët e tregimit;
  - E kupton domethënien e njëjtë/ndryshe;
  - Ndërhyn në lojërat imagjinare.
- **Socializimi**
- I pavarur veshë dhe zhveshë pjesë të rrobave (këmishë, fanellë, çorape);
  - Tregon aftësi në mirëmbajtjen e higjienës personale (lan duart, krehë flokët);
  - Tregon interes në përvojat e reja;
  - Bashkëpunon me fëmijët tjerë;
  - Luan lojat “mami” ose “babi”;
  - Rrit shpikjen gjatë lojërave imagjinare;
  - Negocion zgjidhjen gjatë konfliktit;
  - Është më i pavarur.
- **Zvillimi emocional**
- Imagjino se shumë forma të panjohura mund të jenë “përbindësh”;
  - E sheh veten e vetë si një person të tërë, duke përfshirë trupin mendjen dhe ndjenjat;
  - Shpesh nuk mund të dallojë mes imagjinatës dhe realitetit.

**Duhet të shqetësohesh nëse fëmija shfaq këto në vijim:**

- Nuk mund të hedhë topin me duar;
- Nuk mund të kërcejë në vend;
- Nuk mund të ngasë biçikletë me tre rrota;
- Nuk mund të kapë ngjyre dylli nëpërmjet gishtit të madh dhe gishtërinjve të tjerë;
- Has në vështirësi gjatë shkarravitjes;
- Nuk mund të rendisë katër kube;
- Nuk ndahet ose qanë kur largohen prindërit;
- Nuk tregon interesim në lojërat ndërvepruese;
- Injoron fëmijët tjerë;

- Nuk reagon me njerëzit jashtë familjes;
- Nuk përfshihet në lojërat imagjinare;
- Refuzon veshjen, gjumin dhe përdorimin e tualetit;
- Rrezohet pa pasur vetëkontroll gjatë zemërimit ose shqetësimit;
- Nuk mund të kopjojë një rreth;
- Nuk përdor fjali me më shumë se tre fjalë;
- Nuk e përdor fjalën “unë” dhe “ti” në mënyrë të rregullt.

## **Faza e zhvillimit 5-6 vjeçare (klasa e parë)**

### ➤ **Lëvizjet**

- Qëndron me një këmbë për 10 sekonda;
- Kërçen gjatë 4-5 metrash;
- Ec nëpër klasë dhe shkollë, duke shmangur përplasjen me objektet dhe njerëzit;
- Kërçen prej një rës këmbë në tjetrën për 5-10 herë ose më shumë;
- Luhatet dhe ngjitet me shkathhtësi;
- I aftë të ngase biçikletën pa ndihmesat (vajzat mund të jenë më të ngadalshme gjatë arritjes);
- Ecë duke e shutuar topin;
- Shkelmon topin në lëvizje me saktësi;
- Kërçen dhe e kap topin në madhësi të topit të tenisit;
- Hedh topin me saktësi;
- I aftë të kërceje me litar (djemtë mund të jenë më të ngadalshëm në këtë arritje).

### ➤ **Aftësitë e dorës dhe gishtërinjve**

- Pret/vizaton/nënvizon me saktësi dhe përpikëri;
- Përdor kube, rruaza, pjesë të enigmës për të kompletuar detyra të përshtatshme;
- Kopjon trekëndësh dhe forma tjera gjeometrike;
- Ngjyros me kujdes;
- Vizaton njeriun me gjithë trupin;
- Thekson disa shkronja;
- Vishet dhe zhvishet pa ndihmë;
- Përdor pirun, lugë dhe (disa herë) thikën.

### ➤ **Gjuha**

- Rikujton pjesët e tregimit;
- Flet fjali me më shumë se pesë fjalë;
- Përdor fjali në kohën e ardhëshme;
- Tregon tregime më të gjata;
- Thotë emrin dhe adresën.

➤ **Të njohurit**

- Njeh se cila është pjesa e djathtë dhe e majtë e trupit (nuk është i aftë vazhdimisht t'i emërtojë në mënyrë korrekte);
- Mund të numërojë dhjetë ose më shumë objekte;
- Mund të emërtojë në mënyrë korrekte katër ngjyra;
- Ka ndjeshmëri më të mirë për kohën;
- I din gjërat që përdoren çdo ditë në shtëpi (para, ushqim, pajisje).

➤ **Socializimi**

- Dëshiron t'i kënaq shokët;
- Dëshiron të jetë si shokët;
- Më lehtë pajtohet me rregullat;
- Dëshiron të këndoj, kërcëj dhe aktroj;
- Shfaq më shumë pavarësi dhe mundet vetë të shkojë ta vizitojë fqinun përballë;
- Zakonisht vetë kujdeset për nevojat e tualetit.

➤ **Zvillimi emocional**

- I vetëdijshëm ndaj seksualizmit;
- I aftë të dalloj realitetin nga imagjinata;
- Disa herë kërkues, disa herë me padurim bashkëpunues.

**Duhet të shqetësohesh nëse fëmija shfaq këto në vijim:**

- Shfaq sjellje jashtëzakonisht të frikshme dhe të turpshme;
- Shfaq sjellje jashtëzakonisht agresive;
- Është i paafte të ndahet nga prindërit dhe shfaq kundërshtim të madh;
- Lehtë shpërqendrohet dhe nuk mund të koncentrohet në asnjë aktivitet për më shumë se pesë minuta;
- Tregon interesim të dobët për të luajtur me fëmijët tjerë;
- Refuzon tu përgjigjet njerëzve tjerë, ose përgjigjet sipërfaqësisht;
- Rrallë e përdor imagjinatën ose imitimin gjatë lojës;
- Shumicën e kohës është i mërziur dhe i pikëlluar;
- Nuk angazhohet gjatë aktiviteteve të ndryshme;
- Shmang ose përmbahet gjatë kontaktit me fëmijët tjerë;
- Nuk shpreh një varg të gjerë emocionesh;
- Ka vështirësi gjatë ngrënies së ushqimit, fletjes ose përdorimit të tualetit;
- Nuk mund të dalloj imagjinatën dhe realitetin;
- Duket tepër pasiv;
- Nuk mund ta kuptoj urdhërin e përberë nga dy pjesë me parafjalë (“Vendos gotën mbi tavolinë”; “Merr topin nën divan”).
- Nuk mund të thotë në mënyrë korrekte emrin dhe mbiemrin e vet;
- Nuk flet për aktivitetet e përditshme dhe përvojat;
- Nuk mund të ndërtojë një kështjellë nga 6-8 kube.



- Nuk ndjehet rehat gjatë mbajtjes së ngjyrës së dyllit;
- Ka vështirësi gjatë zhveshjes së rrobave.
- Nuk mund t'i laje dhe thajë duart.

## **Faza e zhvillimit 6-7 vjeçare (klasa e dytë)**

Gjatë kësaj moshe fëmijët duhet t'i kenë fituar shumicën e fazave të zhvillimit.

- Duhet të vëzhgohen: aftësitë themelore të sistemit motorik, përmirësimi i shpejtësisë dhe aftësitë mbi zgjedhjen e detyrës;
- Të jetë i aftë të zotëroje aftësitë e lojës me top gjatë vrapimit në shpejtësi dhe ndërrimit të drejtimit;
- Saktësi gjatë hedhjes dhe gjuajtjes gjatë lëvizjes;
- I aftë të koordinojë aktivitetet me top;
- Aftësitë mund të inkorporohen në lojëra grupore;
- I aftë të kopjojë formën e diamantit dhe drejtkëndëshit;
- I aftë të lidhe një fjongo ose lidhësen e këpucës. Zotërimi i lidhjes së nyjave ndodh disa vite me vonë;
- Emocionalisht i sigurt dhe i pavarur nga të rriturit.

Nga fëmijët nuk pritët që të jenë të pagabueshëm gjatë identifikimit të djathtës dhe të majtës deri në moshën tetë vjeçare.

## Bibliography

- Addy, L. (2006). *Get Physical! An Inclusive Therapeutic PE Programme to Develop Motor Skills*. Cambridge: LDA.
- Addy, L. (2006). *Speed Up-A Kinaesthetic Programme to Develop Fluent Handwriting*. Wisbech: LDA.
- Ayres, A. J., Mailloux, Z. K., & Wendler, C. L. (1987). Developmental dyspraxia is it a unitary function? *Occupational Therapy Journal of Research*, 7,, 93-110.
- Ayres, J. (1979). *Sensory Integration and the Child: Understanding Hidden Sensory Challenges*. . Los Angeles, CA: Western Psychological Services.
- Ball, F. (2002). *Hints ans Tips for Activities of Daily Living*. London: Jessica Kingsley.
- Beales, G. (1996). *Oral Language Middle-Promoting Confidence in Speaking and Listening*. Coventry: Primary Education.
- Beery, K. (2004). *Developmental Test of Visual; Motor Integration, VMI*. New Jersey, USA: Modern Curriculum Press.
- Bhreathnach, E. (1995). *Your Child's Sensory Needs*. . Belfast: BTRS.
- Bisell, J., Fisher, J., Owens, C., & Polcyn, P. (1998). *Sensory Motor Handbook: a Guide for Implementing and Modifying Activities in the Classroom, 2nd edn*. . San Antonio, Texas: Therapy Skill Builders.
- Bissell, J. (1988). *Sensory Motor Handbook a Guide to Implementing and Modifying Activities in the Classroom*. San Antonio, Texas: Therapy Skill Builders.
- Chapman, G., Drew, S., Jenkinson, J., & Woollard, L. (2007). *Learn to Move, Move to Learn-How to Help Children with Coordination Difficulties*. Dorset County Council, West Dorset General Hospitals NHS Trust: Poole Hospital NHS Trust.
- Chu, S. (1999). *Assessment and Treatment of Children with Developmental Perceptual Dysfunction (course handbook, self-published)*. London, West London: Health Care Trust.
- Chu, S. (2003). *Occupational Therapy for Children with Developmental Coordination Disorder, 5th edn (course handbook, self-published)*. London: Ealing Primary Care Trust.
- Colby-Trott, M. (2002). *Oh Behave! Sensory Processing and Behavioural Strategies*. Tucson: AZ, Therapy Skill Builders.
- Cooper, P., & Tiknaz, Y. (2007). *Natyre Groups in School and at Home - Connecting with Children with Social, Emotional and Behavioural Difficulties*. London: Jessica Kingsley.

- Corbett, P. (2006a). *Speak Out! Great Ideas for Speaking and Listening. Ages 7-9*. London: A&C Black Publishers.
- Corbett, P. (2006b). *Speak Out! Great Ideas for Speaking and Listening. Ages 9-11*. London: A&C Black Publishers.
- Delamain, C., & Spring, J. (2003). *Developing Baseline Communication Skills*. Brackley: Speech Mark Publishing Ltd.
- Department for Education and Skills. (2005a). *Excellence and Enjoyment: Social and Emotional Aspects of Learning: Guidance: Primary National Strategy*. London: Department for Education and Skills, Crown.
- Department of Health. (2004). *Department of Health The National Service Framework for Children. Young People and Maternity Services*. London: Department of Health.
- Department for Education and Skills. (2004). *Promoting Emotional Health and Well-being: Through the National Healthy School Standard*. London: Department for Education and Skills/Department of Health.
- DfES, D. (2003). *Every Child Matters: Change for Children. Green Paper*. London: Department for Education and Skills.
- Dunn, W. (1997). The impact of sensory processing abilities on the daily lives of young children and their families: a conceptual model. *Infants and Young Children, 9* (4), , 23-35.
- Dunn, W. (1999). *Sensory Profile- User's Manual*. San Antonio, Texas: Psychological Corporation.
- Dunn, W. (2007). Supporting children to participate successfully in everyday life by using sensory processing knowledge. *Infants and Young Children, 20* (2), 84-101.
- Edwards, J. (1998). *Look! Listen! Thing!* Coventry: Primary Education.
- Erhardt, R. (1993). *Developmental Hand Dysfunction, Theory, Assessment and Treatment*. Oxford: Harcourt Assessment.
- Evamy, B. (2003). *Auditory and Visual Discrimination Exercises-a Teacher's Aid*. Bridlington, Yorkshire: BJE Publications.
- Fisher, A., Murray, E., & Bundi, A. (1991). *Sensory Integration Theory and Practice*. Philadelphia: F.A. Davis Company.
- Henderson, A., & Pehoski, C. (1995). *Hand Function in the Child-Foundations for Remediation*. St Louis, Missouri: Moseby.
- Hill, M., & Hill, K. (2006). *Fine Motor Skills. Photocopiable Activities to Improve Motor Control*. Cambridge, LDA.
- Holland, K. (1995a). Visual Skills for Learning in Topic. *Visual Factors and Occupational Therapy* (pp. Spring 1995, Issue 13). London: NFER-Nelson.

- Jeffries, J., & Jeffries, R. (2001). *Auditory Processing Activities: Materials for Clinicians and Teachers*. Perth, Western Australia: Unicom Publications.
- Jenkinson, J., Hyde, T., & Ahmad, S. (2002). *Occupational Therapy Approaches for Secondary Special Needs. Practical Classroom Strategies*. London: Whurr Publishers Ltd.
- Jenkinson, J., Hyde, T., & Ahmad, S. (2008). *Building Blocks for Learning: Occupational Therapy Approaches. Practical Strategies for the Inclusion of Special Needs in Primary School*. Chichester, United Kingdom: John Wiley & Sons Ltd.
- Kirby, A., & Drew, S. (2003). *Guide to Dyspraxia and Developmental Coordination Disorders*. London: Fulton.
- Kranowitz, C. (1998). *The Out of Sync Child - Recognising and Coping with Sensory Integration Dysfunction*. New York: Perigee.
- Levine, K. (1991). *Fine Motor Dysfunction, Therapeutic Strategies in the Classroom*. Tucson, AZ.: Therapy Skill Builders.
- Lougher, L. (2001). *Occupational Therapy for Child and Adolescent Mental Health*. London: Harcourt Publishers Limited.
- Miller, J. K., & Gilpin, M. D. (1994). *Hands at Work and Play. Developing Fine Motor Skills at Home and School*. Tucson: AZ, Therapy Skill Builders.
- Miller, L., Anzalone, M., Lane, S., Cermak, S., & Osten, E. (2007). Concept evolution in sensory integration: a proposed nosology for diagnosis. *American Journal of Occupational Therapy*, 61 (2), 135–140.
- Mosely, J. (2005). *Circle Time for Young Children*. London: Routledge.
- Nagler, J., & Pickering, E. (2003). *Helping Children Learn: Intervention Handouts for use in School and at Home*. Baltimore, MD: Brookes Publishing Co.
- Newton Inamura, K. (1998). *SI for Early Intervention: a Team Approach*. San Antonio, Texas: Therapy Skill Builders.
- Office of Public Sector Information. (1995). *Disability Discrimination Act*. London: Stationary Office.
- Parham, L. &. (2005). *Sensory integration*. In: J. Case-Smith (ed.), *Occupational Therapy for Children (5th edn)*. St Louis, MO, Mosby.
- Plummer, D. (2007). *Helping Children to Build Self-esteem*. London: Jessica Kingsley.
- Prodhomme, B. W., Mulligan, S., Merrill, K., & Wright, J. (2007). An examination of the relationships between motor and process skills and scores on the sensory profile. *American Journal of Occupational Therapy*, 61 (2), 154–160.
- Rae, T. (2003). *Dealing With Some More Feelings: an Emotional Literacy Curriculum*. Bristol: Lucky Duck Publishing.

- Schmutz Boyd, K., Schmutz Law, J., & Schmutz, C. (2003). *Kids on the Move: Creative Movement for Children of All Ages*. Flower Mound, TX: Creative Publishing.
- Stein, S., & Chowdhury, U. (2006). *Disorganised Children-a Guide for Parents and Professionals*. London: Jessica Kingsley Publishers.
- Stein, S., & Chowdhury, U. (2006). *Disorganised Children-a Guide for Parents and Professionals*. London: Jesica Kingsley Publishers.
- Tuper, L., & Miesner, K. (1995). *School Hardening: Sensory Integration Strategies for Class and Home*. San Antonio, Texas: Therapy Skill Builders.
- Wallace, B. (2001). *Teaching Thinking Skills Across the Primary Curriculum*. London: David Fulton Publishers.
- Warren, C. (2004). *Speaking and Listening Games: New Bright Ideas; Ages 5-11*. London: Scholastic.
- Weare, K. (2000). *Developing Mental, Emotional and Social Health Needs in Schools*. London: Routledge.
- Weare, K., & Gray, G. (2003). *What Works in Developing Children's Emotional and Social Competence and Well-being? DfES Research Report 456*. Southampton: The Health Education Unit, Research and Graduate School if Education, University of Southampton.
- Williams, M., & Shellenberger, S. (1996). *How Does Your Engine Run?, a Leaders Guide to the Alert Program for Self-regullation*. Albuquerque: Therapy Works Inc.